



Njohja dhe përdorimi i së drejtës Mjedisore nga aktorët lokal në Shqipëri

RAPORT VLERËSUES





Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri

RAPORT VLERËSUES

Njohja dhe përdorimi i së drejtës Mjedisore nga aktorët lokal në Shqipëri

PËRGATITUR NGA:

PhD. Arjan Gjini

PhD. Erinda Misho

PhD. Elton Qendro

PREGATITËN PËR PUBLIKIM:

PhD (c) Olsi Nika Msc.

Robert Shahini Msc.

Përgatitje grafike dhe faqosje:

Ermal Shenaj



FINANCUAR NGA:

**FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË**

"Ky botim u realizua me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e Fondacionit."

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE	8
LISTA E TABELAVE.....	8
LISTA E GRAFIKËVE	9
LISTA E SHKURTIMEVE	10
PËRMBLEDHJE	12
KAPITULLI I: SFONDI, METODOLOGJIA, STUDIMI	15
1.1 Sfondi i Studimit.....	15
1.2 Qëllimi dhe Metodologjia e studimit	16
1.3 Kufizimet e studimit.....	19
1.4 Gjetjet e studimit: Vlerësim i njohurive të aktorëve lokalë mbi të drejtën mjedisore në Shqipëri.....	19
KAPITULLI II: E DREJTA MJEDISORE NË SHQIPËRI.....	35
2.1 Historiku i së drejtës Mjedisore në Shqipëri	35
2.2 Kuadri ligjor mjedisor në Shqipëri (Kushtetuta, Legjisllacioni i brendshëm)	36
2.3 Legjisllacioni mjedisor Kombëtar.....	38
2.3.1 Ligji Nr. 146/2014 “Për informimin dhe konsultimin publik”	38
2.3.2 Ligji Nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar	40
2.3.3 Ligji 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar	43
2.3.4 Ligji Nr.10 463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar	44
2.3.5 Ligji Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”	47
2.3.6 Ligji Nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, i ndryshuar	47
2.3.7 Ligji Nr. 10006 datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”, i ndryshuar	48
2.3.8 Ligji Nr. 57/2020 “Për pyjet”	49
2.3.9 Ligji Nr. 9587/.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar	52
2.3.10Ligji Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”	54

KAPITULLI III: E DREJTA MJEDISORE NDËRKOMBËTARE	59
3.1 Drejtën Ndërkombëtare të Mjedisit	59
3.2 Evolucionit historik mbi të Drejtën Ndërkombëtare të Mjedisit.....	60
3.3 Ndikimet e të drejtës ndërkombëtare mjedisore dhe çështjet mjedisore	64
3.4 E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit dhe Shqipëria	65
3.5 Konventat ndërkombëtare.....	66
3.5.1 Konventa e Aarhus-it	67
3.5.2 Konventa e Espoo-s	73
3.5.3 Konventa e Helsinkit.....	76
3.5.4 Konventa e Bazelit.....	77
3.5.5 Konventa e Bernës.....	79
3.5.6 Mekanizmat e zbatueshmërisë së Konventave.....	80
3.5.7 Ndërveprimi i konventave.....	82
KAPITULLI IV: LEGJISLACIONI MJEDISOR I BE-SË.....	85
4.1 E Drejta Mjedisore e BE-së	85
4.1.1 Acquis Communautaire, Kapitulli 27 ``Mjedisi`` , Direktivat e Be-së dhe Shqipëria.....	85
4.2 Legjislacioni Horizontal i BE-së	87
4.2.1 Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor 2001/42/EC “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”	88
4.2.2 Direktivat e BE-s për VNM “Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuar publike ose private në mjedis”	88
4.3 Direktiva Kuadër Ujit.....	89
4.4 Direktivat e mbrojtjes së Natyrës.	91
4.4.1 Direktiva e Zogjve (2009/147 / EC)	91
4.4.2 Direktiva e Habitave (92/43 / EEC).....	93
4.5 Direktiva për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (IPPC) 2008/1 / EC	94
4.6 Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore	96
4.7 Direktivën 2008/99/EC për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal/ Direktiva e Krimit Mjedisor.....	96

KAPITULLI V: ASPEKTE PRAKTIKE TË SË DREJTËS MJEDIORE	99
5.1 Organizimi i rasteve studimore rreth shkeljes së të drejtës mjedisore në Shqipëri	99
5.2 Metoda e shtjellimit të një rasti studimor	100
5.3 RAST STUDIMOR 1: Ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël në lumin Cem/Cijevna, Mal i Zi.....	101
5.4 RAST STUDIMOR 2: Ndërtimi i hidrocentralit të Pocemit, ne Rrjedhën e Vjosës 2016, çështja e parë gjyqësore mjedisore me paditës Komunitetin drejtuar Gjykatës Administrative ...	104
5.5 Përfundime	110
5.6 Rekomandime.....	113
5.7 Referenca	113
KAPITULLI VI: SHTOJCAT.....	117
6.1 SHTOJCA 1: Formati i pyetësorit 1 për vlerësimin e njohurive, mbi paketën e së drejtës mjedisore.	117
6.2 SHTOJCA 2: Formati i pyetësorit II për vlerësimin e njohurive, të pjesëmarrjeve në trajnimet mbi rreth paketës së të drejtës mjedisore.....	122

■ LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Përmbledhje skematike e paketës të së drejtës mjedisore.....	10
Figura 2: Struktura e metodologjisë së zbatimit të studimit.....	11
Figura 3: Përmbledhja e numrit të mostrës së intervistuarve në 6 qarqe: A) Numri i të intervistuarve nga Pyetësi I; B) Numri i të intervistuarve nga Pyetësi II	12
Figura 4: Kuadri institucional, Konventa e Espoo-s	55
Figura 5: Paraqitja në formë skematike e legjislacionit mjedisore të BE-së: A) - Legjislacioni Horizontal, B) - Legjislacioni Vertikal.....	64

■ LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Mekanizmat e zbatueshmërisë së Konventave.....	60
Tabela 2: Paraqitja tabelare e ndërveprimit të konventave.....	61

■ LISTA E GRAFIKËVE

Grafik 1: Vlerësimi i njohurive të pjesëmarrësve mbi njohjen e të drejtës së mjedisit	14
Grafik 2: Përshkrimi i vlerësimit të pjesëmarrësve në studimin mbi : A) Gjendja e mjedisit; B) Rëndësia e njohjes së të drejtës së mjedisit	14
Grafik 3: Vlerësimit mbi efikasitetin e kuadrit ligjorë mjedisorë.	15
Grafik 4: Vlerësim i Njohurive për parametrat e matjes së cilësisë së Ujit, Ajrit dhe Tokës.....	16
Grafik 5: Njohja e traktateve ndërkombëtare.....	16
Grafik 6 : Vlerësim i njohurive të intervistuarve mbi Kapitullin 27 “Mjedi si dhe Ndryshimet Klimatike”	17
Grafik 7: Vlerësimi i njohurive në 5 shkallë krahasimore për direktivat mjedisore të BE-së, e shprehur në përqindje	18
Grafik 8: Vlerësimi i njohurive për Konventat (Helsinki, Bernës, Espoo-së, Aarhusit, Bazelit) në 6 qarqet e përfshira në studim	19
Grafik 9: Paraqitja në përqindje e të intervistuarve mbi zgjidhjen e konflikteve.	20
Grafik 10: A/1 Ekzistenca e konflikteve mjedisore në zonën tuaj. A/2; Llojet e konflikteve.....	20
Grafik 11: Vlerësimi i kërcënimeve ndaj mjedisit, sipas shkallës së prezencës.....	21
Grafik 12: Konsultimi me raportin e Gjendjes së mjedisit.....	22
Grafik 13: Rëndësia e përdorimit të së drejtës së mjedisit nga aktorët lokal pjesëmarrës në trajnim.....	23
Grafik 14: Njohuri të përftuara nga pjesëmarrja në trajnim për të drejtën	23
Grafik 15: Mekanizmi i zbatimit të legjislacionit në Shqipëri, duke përdorur shkallën nga 1 në 5 (1= minimumi; 5 = maksimumi)	24
Grafik 16: Mekanizmi i zbatimit të konventave në Shqipëri, duke përdorur	25
Grafik 17: Kuadri ligjor i BE-së (Direktivat), duke përdorur shkallën e vlerësimit nga.....	25
Grafik 18: Kontributi i përftuar, duke përdorur shkallën nga 1 në 5 (1= minimumi; 5 = maksimumi).....	26

LISTA E SHKURTIMEVE

AKM	Agjencisë Kombëtare të Mjedisit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BAT	Best Available Techniques
BE	Bashkimi Europian
CITES	Convention on International Trade in Endangered Species of Wild Fauna and Flora
IPPC	Integrated prevention Pollution Control
IUCN	International Union for Conservation of Nature
KM	Këshilli i Ministrave
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OJF	Organizatat jo Fitimprurëse
OJQ	Organizatat jo Qeveritare
OSFA	Open Society Foundation for Albania
PKIE	Plani Kombëtar i Integritetit Evropian
PKZMSA	Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
SAC	Zonë e veçantë për konservim
SCI	Zonë me rëndësi për komunitetin
SPA	Zonë e veçantë e mbrojtur
UNCED	United Nations Conference on Environment and Development
UNCHE	United Nations Conference on the Human Environment
UNCLOS	United Nations Convention on the Law of the Sea
UNECE	United Nations Economic Commission for Europe
UNEP	United Nations Environment Programme
UNFCCC	United Nations Framework Convention on Climate Change
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
WFD	Water Framework Directive/Direktiva Kuadër e Ujit
WEB	World Electarnic Brochure

PËRMbledhje

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Rritja e Përgjegjshmërisë përmes zbatimit të së Drejtës Mjedisore në Shqipëri”, zbatuar nga Qendra EcoAlbania dhe financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).

Objektivi i përgjithshëm është të ndihmojë aktorët lokalë në njohjen dhe kuptimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të drejtën e mjedisit. Studimi paraqet një vlerësim të aktorëve lokal në 6 qarqet (Kukës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, Vlorë) mbi njohurit që zotërojnë për paketën e së drejtës së mjedisit.

Gjetjet e siguruara dhe të paraqitura në studimin japin një informacion të detajuar nga realizimi i aktiviteteve nga projekti siç janë: shpërndarja e pyetësorëve mbi të cilën kanë ndihmuar në ndërtimin e bazës së të dhënave dhe analizimin e gjetjeve. Siç shihet në figurën 3, numri i përgjithshëm i pyetësorëve të shpërndarë në 6 qarqet ka qenë 96 pyetësorë dhe mostra e studimit arriti 53 intervistues. Aktorët lokal ju siguroa mbështetje nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve në 6 qarqet të përzgjedhurë në mënyrë rastësore. Trajnimet janë zhvilluar duke e trajtuar paketën e së drejtës mjedisore në 3 nivele: kuadri ligjor kombëtar, legjislacioni i BE-së marrëveshjet ndërkombëtare dhe konventat, me qëllim për të dhënë kontribut në përmirësimin e njohurive së tyre rreth së drejtës së mjedisit. Pjesëmarrja në trajnime ka qenë heterogjene, me përfaqësues nga institucionet lokale, gazetarë, ekspertë të mjedisit, OJF lokale, studentë dhe aktivistë.

Në të gjitha trajnimet aktorët lokal janë shprehur se në qarqet respektive të tyre ekzistojnë konflikte për burimet natyrore. Procesi i ndryshimit dhe përvetësimit të burimeve natyrore (kryesisht nga shoqëri konçensionare) iu ka hequr edhe të drejtën e përdorimit duke i kërcënuar deri edhe në shpërngulje të tyre.



Sipas të intervistuarve rastet të konflikteve ndërmjet palëve mbi keqpërdorimin e burimeve natyrore, rreth 70 % mendojnë që është shumë e rëndësishme njohja dhe përdorimi i së drejtës së mjedisit për zgjidhjen e konflikteve. Për më tepër, reagimi i komunitet lokal ndaj konflikteve është manifestuar dhe me konflikte fizike. Nga analizimi i të dhënave 57% e intervistuarve shprehen se kuadri ligjorë mjedisorë ekzistues është jo efikas. Megjithatë gjatë trajnimeve pranuan faktin që forcim dhe rritje të ndërgjegjësimit për përmirësimin e kuadrit ligjor kombëtarë duke e përafruar me ligjet ndërkombëtare.

Të intervistuarit gjatë plotësimit të pyetësorëve (Pyetësori I, Pyetësori II) dhe diskutimeve në trajnim janë shprehur, se duhet rritur vëmendja dhe informimi i aktorëve lokalë duke shërbyer si rritje e përgjegjshmërisë dhe njohjes ndaj të drejtës mjedisore.



KAPITULLI 1



KAPITULLI I: SFONDI, METODOLOGJIA, STUDIMI

1.1 Sfondi i Studimit

Shqipëria ka kaluar 30 vjet nga ndryshimi i sistemit, duke ndryshuar edhe modelin e zhvillimit ekonomik. Bazuar në studimet e mëparshme Shqipëria kishte potencial të lartë të pashfrytëzuar të burimeve natyrore. Shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore, u pa si mënyrë për të luftuar varfërinë. Në këtë situatë, Shqipëria u orientua drejt projekteve zhvillimore nëpërmjet marrëveshjeve konçensionare në mënyrë të përshpejtuar.

Bazuar në publikimet dhe raportimet mediatike, komunitet lokale shprehin kundërshtimin mbi mënyrën e shfrytëzimit të burimeve natyrore. Gjithashtu zbatimi i këtyre projekteve cënon edhe zona me rëndësi të lartë mjedisore, zona të mbrojtura natyrore dhe zona të banuara nga komunitet lokale të cilët aktivitetin jetësor të tyre e kanë të lidhur drejtpërdrejt me burimet natyrore. Kjo situatë ka shkaktuar debate, konflikte, protesta dhe padi për të shprehur kundërshtimin e ndërtimit të veprave që dëmtojnë mjedisin dhe iu heqin komuniteteve të drejtën e përdorimit të burimeve natyrore.¹

Ky raport shpreh mundësinë e njohjes dhe përdorimit të së drejtës mjedisore nga aktorët lokal, identifikimin e rasteve të konflikteve specifike mjedisore, keqpërdorimin e burimeve natyrore me pasoja të mëdha mjedisore dhe sociale. Faktet tregojnë se shumica e projekteve që shfrytëzojnë si lëndë të parë burime natyrore, kanë tendencën e zhvillimit jo në harmoni me pëlqimin e komuniteteve lokale, të cilat anashkalojnë mundësinë e ndikimit mbi pasojat pse jo dhe marrjen e kompensimit. Ndërveprimi i dobët në vendimarrje dhe mos njohja e të drejtave nga aktorët lokal shton rrezikun për lënie jashtë procesit të negocimit dhe vendimarrjes. Me qëllim rritjen e njohurive për këto raste, u ndërmor hartimi i këtij raporti duke mundësuar edhe shembuj dhe alternativa rreth përdorimit të së drejtës mjedisore.

1 https://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2017/04/Studim_konfliktet_ujore-2017.pdf




Figura 1: Përmbledhje skematike e paketës të së drejtës mjedisore

1.2 Qëllimi dhe Metodologjia e studimit

Ky raport është përgatitur nga 3 ekspertë të fushës së legjislacionit mjedisor në kuadër të projektit “Njohja e së drejtës mjedisore nga aktorët lokalë”, i cili zbatohet nga qendra EcoAlbania dhe financohet nga fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).

Qëllimi i përgjithshëm është të ndihmojë aktorët lokalë në njohjen dhe kuptimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi mjedisin duke përfshirë tre nivele: Legjislacionin kombëtar, legjislacionin e BE-së (*Acquis Communautaire*) dhe ndërkombëtar (konventat dhe marrëveshjet). Hartimi i pyetësorëve dhe shpërndarja pranë aktorëve lokalë është njëri prej aktiviteteve që ka kontribuar në mbledhjen e informacionit dhe përgatitjen e një baze të dhënash, e cila më pas ka shërbyer për të ndërtuar tematikat dhe prezantimet e trajnimeve nga ekspertet duke i përshtatur në nivel lokal.

Në përfundim gjetjet dhe evidentimi i rasteve ka shërbyer për ndërtimin e kapitujve dhe shembujve praktikë për të drejtën e mjedisit në Shqipëri.




Figura 2: Struktura e metodologjisë së zbatimit të studimit

Figura nr. 3 tregon një përmbledhje grafike të procesit të studimit të realizuar nëpërmjet pyetësorëve para dhe pas pjesëmarrjes në trajnim. Shpërndarja e pyetësorëve është bërë në dy faza: para zhvillimit të trajnimeve (pyetësori 1) dhe pas pjesëmarrjes në trajnim (pyetësori 2). Fokusi i studimit ishte njohja e nivelit të njohurive të aktorëve lokal mbi të drejtën e mjedisit duke ndjekur metodën e kërkimit sasior me atë intervistave rastësore të ndara sipas qarqeve. Përmbajtja e pyetësorëve u nda në disa seksione (pyetësori 1 në 5 seksione; pyetësori 2 në 3 seksione), të cilat përmbanin pyetje rreth paketës ligjore të së drejtës së mjedisit duke përfshirë legjislacionin Kombëtar, legjislacionin e BE-së (direktivat) dhe ndërkombëtare (konventat). Nga 90 pyetësorë të shpërndarë (15 persona për çdo qark), numri i mostrës së pyetësorëve të plotësuar arriti numrin 53 pyetësorë me një pjesëmarrje heterogjene: 29 femra dhe 24 meshkuj në 6 qarqet e vendit. Personat që janë bërë pjesë e procesit të plotësimit të pyetësorëve kanë qenë edhe pjesëmarrës aktiv në trajnime. Sa i përket institucionit dhe angazhimit profesional pjesëmarrësit e angazhuar përfaqësonin: OJF, aktivistë, gazetarë, specialistë të bashkive dhe agjencive rajonale. Referuar figurës 3, tregohen vlerat e nr. të intervistave të realizuara para dhe pas trajnimeve në 6 qarqet e vendit, përkatësisht (Kukës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, Vlorë), ndërsa numri i mostrës nga pyetësori i parë arriti në 53 pyetësorë të ndarë përkatësisht sipas qarqeve: Kukës 11, Shkodër 14, Korçë 7, Elbasan 7, Gjirokastrë 5, Vlorë 8. Ndërsa numri i mostrës së arritur nga plotësimi i pyetësorit të dytë ishte 55. Specifikisht të shpërndarë në vlera jo të barabarta në 6 qarqet, ku për Qarkun e Kukësit është 11, Shkodër 8, Korçë 5, Elbasan 4, Gjirokastrë 7, Vlorë 20.




Figura 3: Përmbledhja e numrit të mostrës së intervistuarve në 6 qarqe: A) Numri i të intervistuarve nga Pyetësori I; B) Numri i të intervistuarve nga Pyetësori II.



1.3 Kufizimet e studimit

Ky studim nuk pretendon paraqitjen e një panorame të detajuar rreth burimeve natyrore, por konsiston në trajtimin e disa koncepteve dhe analizimin e disa rasteve specifike, për rritjen e informimit të aktorëve lokalë mbi të drejtat dhe përdorimin e të drejtës mjedisore. Raporti mundëson një përmbledhje të së drejtës mjedisore në 3 nivele: kuadrin ligjor kombëtar, legjislacioni mjedisore i BE-së dhe konventat ndërkombëtare.

Si një faktor kufizues mund të specifikojmë procesin e zhvillimit të plotësisht të pyetësorve, i cili nuk ka qenë i mundur të bëhen fizikisht në terren për shkak kufizimeve. Megjithatë kjo pengesë është kapërcyer duke shfrytëzuar mjete dhe alternativa të tjera si platformat online. Në përfundim bazuar në gjykimin dhe analizimin më të mirë të mundshëm raporti mundëson një përmbledhje të përgjithshme të paketës të së drejtës mjedisore në Shqipëri. Duke përfshirë aspekte teorike dhe shembuj praktik të përdorimit të së drejtës mjedisore.

1.4 Gjetjet e studimit: Vlerësim i njohurive të aktorëve lokalë mbi të drejtën mjedisore në Shqipëri.

Prej dekadash Shqipëria ka njohur një zhvillim në shumë sektorë, shpesh herë në kurriz të burimeve natyrore, i cili është shoqëruar edhe me dëme jo të vogla në planin mjedisor, ekonomik dhe social. Megjithatë edhe pse kushtetuta e shtetit shqiptar parashikon një paketë ligjore për mjedisin, vërehet ekzistenca e problematikave dhe konflikteve mjedisore. Gjithashtu parashtrimi dhe procesi i realizimit të projekteve është shoqëruar edhe me shmangie të publikut, duke lënë pa dëgjuar edhe zërin e tyre.


Përfshirja e aktorëve lokal në procesin e marrjes së njohurive rreth paketës së të drejtës së mjedisit ishte një hap pozitiv në rritjen e njohurive në fushën e legjislacionit mjedisor. Ky proces nisi natyrshëm duke vazhduar radhazi zhvillimin e trajnimeve në 6 qarqe, përkatësisht: Kukës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë dhe Vlorë. Për të kuptuar më mirë panoramën e së drejtës mjedisore,

u analizuan konceptet teorike duke i gërshetuar me shembuj dhe aspekte të përdorimit praktik të paketës së të drejtës së mjedisit. Paraprakisht ekspertët ndërtuan dy pyetësorë model të cilët janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave.

Pyetësorët përmbajnë disa seksione duke përmbajtur pyetje pohuese rreth koncepteve dhe njohurive mbi të drejtën mjedisore. Shpërndarja e pyetësorëve është realizuar nëpërmjet platformës online. Analiza e seksioneve dhe ndërtimi i grafikëve të mëposhtëm bazohet nga të dhënat e gjeneruar nga dy pyetësorët. Në vijim të dhënat e përfutur nga pyetësorët, janë paraqitur në formën e grafikëve të cilët tregojnë dhe përshkojnë nivelin e njohurive mbi të drejtën e mjedisit për pjesëmarrësit në studim.

PJESA I: Vlerësimi i njohurive rreth problematikave mjedisore dhe të drejtës mjedisore


Referuar grafikut 2. vlerat numerike tregojnë nivelin e njohurive që kanë të intervistuarit mbi legjislacionin mjedisore, përkatësisht në total prej 53 personash, 25 prej tyre kanë njohuri dhe 28 nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi legjislacionin mjedisor. Ky rezultat shpjegon ekzistencën e shumë faktorëve të jashtëm, duke filluar nga mungesa e trajnimeve mbi fushën e legjislacionit mjedisor e deri tek boshllëqet ligjore mbi paketën e të drejtës mjedisore.



Grafik 1: Vlerësimi i njohurive të pjesëmarrësve mbi njohjen e të drejtës së mjedisit.




Nëpërmjet gërshetimit të dy komponentëve: gjendja e mjedisit dhe rëndësia e njohjes së të drejtës së mjedisit, vlerave numerike në grafikun 2. është arritur një tregues mbi situatën ekzistuese dhe gjendjen e mjedisit në 6 qarqet e përfshira në studim dhe njohja e së drejtës së mjedisit nga aktorët lokal. Rreth 30% e të intervistuarve janë shprehur që gjendja e mjedisit është e rrezikuar dhe se burimet natyrore në zonat përkatëse janë të rrezikuar nga keqshfrytëzimi i tyre. Njëkohësisht të intervistuarit shprehen që njohja e legjislacionit mjedisor është shumë i rëndësishëm ku 37 nga 53 në total vlerësojnë rëndësinë e njohjes së të drejtës mjedisore.




Grafik 2: Përshkrimi i vlerësimit të pjesëmarrësve në studimin mbi: A) Gjendja e mjedisit; B) Rëndësia e njohjes së të drejtës së mjedisit

Edhe pse Shqipëria si një vend në tranzicion ka kushtetutën e saj me një kuadër ligjor, gjatë 3 dekadave të fundit paketa ligjore mbi të drejtën e mjedisit ka qenë pjesë e ndryshimeve dhe rregullimeve ligjore. Lidhur me efikasitetin e kuadrit ligjor ekzistues për të drejtën e mjedisit në Shqipëri janë analizuar të dhënat e gjeneruar në grafikun 3, ku 57 % e të intervistuarve mendojnë që paketa e kuadrit ligjor është jo e plotë, 17 % shprehen janë shprehur që paketa ligjore është jo e efektive dhe 26 % mendojnë që është e dobët.



Grafik 3: Vlerësimi mbi efikasitetin e kuadrit ligjorë mjedisorë.

Në kategorinë e komponentëve mjedisor është analizuar grafiku 4 për matjen e parametrave të cilësisë për ujin, ajrin dhe Tokën4. Të intervistuarit shprehen së asnjë prej tyre nuk zotëron njohuri të avancuara mbi njohjen e parametrave të cilësisë, megjithatë në total 45 % e tyre kane njohuri të mjaftueshme mbi parametrat e matjes së cilësisë së ujit, Ajrit dhe Tokës.




Grafik 4: Vlerësim i Njohurive për parametrat e matjes së cilësisë së Ujit, Ajrit dhe Tokës.




Pjesa II: E drejta mjedisore në nivel ndërkombëtar

Aderimi dhe pjesëmarrja në shumë marrëveshje ka nxitur institucionet shqiptare në paketën ligjore të ndërmarrin nisma dhe veprime për përditësimin e kuadrit ligjor duke e përafruar me ligjet ndërkombëtare. Ekspertët e fushës hartuan një sesion të dedikuar në pyetësor mbi njohjen e të drejtës mjedisore ndërkombëtare. Kryesisht, përfshin çështje që lidhen me marrëveshjet, konventat dhe direktivat. Nga përpunimi i grafikut 5. U provua që 56 % e të intervistuarve kishin njohuri mbi të drejtën ndërkombëtare dhe 44% nuk ishin njohuri. Në këtë kontekst u përshtatën edhe natyra e pyetjeve dhe niveli i tematikave që iu përcollën pjesëmarrësve në trajnime.



Grafik 5: Njohja e traktateve ndërkombëtare


Për shkak të pozitës gjeografike që ka Shqipëria, e kufizuar me 4 shtete fqinj, kjo e bën akoma më të detyrueshëm përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit ndërkombëtar. Gjithashtu të qenit një vend që aspiron për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE), kërkohet një angazhim më i madh në njohjen dhe përafrimin me legjislacionin e BE. Në pyetjen e parashtruar mbi njohjen e procesit të stabilizim asociimit, rezultoi që 32 të intervistuar kishin njohuri minimale mbi kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike” një ndër kapitujt kryesor për mjedisin.



Grafik 6: Vlerësim i njohurive të intervistuarve mbi Kapitullin 27 "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike"

Gjithashtu organizmat legjislativë të Bashkimit Evropian, kanë hartuar një seri direktivash të cilat janë të aplikueshme për sektorin e mjedisit. Në këtë seksion janë përzgjedhur 6 direktivat kryesore të cilat gjejnë zbatim edhe në Shqipëri. Në grafikun 7 kemi një pasqyrë të përgjithshme të vlerësimit të njohurive të intervistuarve. Edhe pse pjesëmarrja në intervista ka qenë heterogjene, bazuar në vlerat e shkallës së parë dhe të dytë tregojnë për një mungesë informacioni mbi njohjen e direktivave.


DIREKTIVAT E BE-SË



Grafik 7: Vlerësimi i njohurive në 5 shkallë krahasimore për direktivat mjedisore të BE-së, e shprehur në përqindje.




Njohja dhe përdorimi i të drejtës ndërkombëtare përfshin një seri aktesh ligjore të cilat shumë shtete i përdorin për të zgjidhur problematika mes tyre. Pjesë e së drejtës ndërkombëtare janë edhe marrëveshjet dhe konventat, ndërmjet shteteve. Në studim janë përzgjedhur 5 konventat kryesore (Bazelit, Aarhusit, Helsinkit, Espo-s, Bernë-s). Mbështetur në grafikun 8 përfundimet e rezultateve janë shprehur në vlera numerike. Të intervistuarit janë shprehur mbi njohurit që zotërojnë mbi konventat, në një shkallë vlerësimi të ndarë në 5 nivele duke filluar, me 5- njohuri të avancuara dhe deri tek shkalla më e ulët 1 nuk kanë njohuri. Në totalin e përmbledhur: Shkalla e vlerësimit 5 për njohuri të veçuara kemi një vlerësim minimal, pastaj në shkallën e 4 kemi një rritje të numrit të intervistuesve që kanë shumë njohuri, dhe në dy shkallët e fundit të vlerësimit kemi shifrat më të larta. Niveli i njohurive të pjesëmarrësve në intervista tregon se mbizotëron shkalla e ulët e vlerësimit me rreth 20 intervistues në secilën konventë që kanë njohuri të dobëta. E përkthyer në përqindje kemi rreth 40% intervistuesve për secilin vlerësim të personalizuar të konventës të cilët kanë njohuri minimale.



Grafik 8: Vlerësimi i njohurive për Konventat(Helsinkit, Bernës, Espoo-së, Aarhusit, Bazelit) në 6 qarqet e përfshira në studim

PJESA III: Konfliktet mjedisore

Nevoja për zhvillim ka imponuar nevojën për shfrytëzimin e burimeve natyrore, në shumë raste janë ndjekur strategji dhe veprime në shkelje ligjore. Kjo ka çuar edhe në lindjen e konflikteve mjedisore ndërmjet palëve. Në këtë pohim grafiku 9 gërsheton përfshirjen në konflikt dhe zgjidhjen e tyre. Përfundimi tregon që 66% e të intervistuarve shprehen që rastet konfliktuale ndërmjet palëve nuk trajtohen në mënyre të duhur.




Grafik 9: Paraqitja në përqindje e të intervistuarve mbi zgjidhjen e konflikteve.

Analiza dhe studimet e kryera edhe nga ekspertë që operojnë në fushën e mjedisit janë pozicionuar duke u shprehur që mjedisi kontribuon në mirëqenien e shoqërisë. Por vitet e fundit ndërgjegjësimi ndaj mjedisit ka ndryshuar edhe pse vërehen mungesa në njohjen dhe përdorimin e të drejtës mjedisore nga aktorët lokal. Në grafikun 10 pasqyrohet një vlerësim në përgjithshëm mbi ekzistencën dhe natyrën e konflikteve në nivel qarku. Rreth 91% janë shprehur që ekzistojnë konflikte mjedisore në qarkun e tyre, sipas shkallës së vlerësimit, konfliktet mbi burimet ujore mbulojnë pjesën më të madhe të konflikteve ndërmjet palëve.


Nëpërmjet plotësimit të intervistave janë përzgjedhur 9 problematika mjedisore të cilat janë të pranishme në 6 qarqet e vendit. Bazuar në grafikun



11 por edhe në trajnimet që janë zhvilluar me aktorët lokal theksohet që menaxhimi i mbetjeve dhe keqpërdorimi i burimeve ujore janë problematika ekzistuese në të gjitha zonat e tyre. Vlen të theksohet që duke u bazuar në vlerat e grafikut, kemi një prezencë të kërcënimeve të cilat janë potencial për lindjen e konflikteve ndërmjet palëve.




Grafik 10: A/1 Ekzistenca e konflikteve mjedisore në zonën tuaj. A/2; Ilojet e konflikteve



Grafik 11: Vlerësimi i kërcënimeve ndaj mjedisit, sipas shkallës së prezencës.

Në grafikun 12 është analizuar marrëdhëniet e aktorëve lokalë të përfshirë në studim sa i përket konsultimit me raportin e gjendjes së mjedisit, ndër ta

vetëm 3 të intervistuar nga 53 në total ndjekin rregullisht raportin e gjendjes së mjedisit. Pjesa më e madhe prej 17 të intervistuarish konsultohen shumë pak me raportin e gjendjes së mjedisit.



Grafik 12: Konsultimi me raportin e Gjendjes së mjedisit

PJESA IV: Vlerësim i njohurive të fituara nga trajnimet mbi të drejtën e mjedisit.


Gjenerimi i të dhënave paraprahe ka mundësuar zhvillimin e trajnimeve të përqendruara për njohjen dhe përdorimin e së drejtës së mjedisit nga aktorët lokal në 6 qarët (Kukës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë)². Trajnimet u zhvilluan në kuadrin e përditësimit dhe përdorimit të njohurive tek aktorët lokal, duke kontribuar në përftimin e shumë koncepteve dhe çështjeve mjedisore. Në fund të çdo trajnimi është shfrytëzuar metoda e intervistimit më pyetësorë më qëllim vlerësimin e kontributit tek aktorët lokal. Ekspertët tanë të fushës së mjedisit hartuan një model pyetësori të ndarë në seksione³

² Figura 5: Përmbledhja e numrit të mostrës së intervistuarve në 6 qarqe: A) Numri i të intervistuar nga Pyetësori I; B) Numri i të intervistuar nga Pyetësori II.

³ Shtojca 2: Formati i pyetësorit II për vlerësimin e njohurive, të pjesëmarrjeve në trajnimet mbi rreth paketës së të drejtës mjedisore.




Në grafikun 13 është prezantuar rëndësia e njohjes dhe përdorimit të të drejtës mjedisore nga pjesëmarrja në trajnim. Në bazë të shkallëve krahasimore një vlerë minimale ku 2 % e pjesëmarrësve nuk e shikojnë si një kontribut për funksionimin në vazhdimësi të organizatës që përfaqësonin dhe 67 % janë shprehur që njohuritë e përfituara do të shërbejnë si kontribut në rritjen profesionale për funksionimin më efikas brenda organizatës që përfaqësojnë.



Grafik 13: Rëndësia e përdorimit të së drejtës së mjedisit nga aktorët lokal pjesëmarrës në trajnim

Në grafikun 14 kemi një vlerësim të njohurive mbi angazhimin në ndjekjen e sesioneve të trajnimit për kuadrin ligjor kombëtar. Sipas shkallës krahasimore vlera minimale është: 2% e të intervistuarve janë shprehur që njohuritë e prezantuara nuk janë shumë efikase për pozicionin që përfaqësojnë. Kjo shpjegohet me pjesëmarrjen në trajnim të grupeve heterogjene, ndërsa 47% e kanë vlerësuar me shkallën maksimale njohuritë e marra mbi kuadrin ligjor të brendshëm për të drejtën e mjedisit në Shqipëri.


Si i vlerësoni njohuritë e marra në të drejtën mjedisore dhe kushtetuese në Shqipëri?



Grafik 14: Njohuri të përfutuara nga pjesëmarrja në trajnim për të drejtën mjedisore në Shqipëri

Kuadri ligjor në rrjedhën e funksionimit dhe aplikimit bazohet në funksionimin e mekanizmave ligjorë. Ndaj në grafikun 15 prej 55 intervistave, 38 % e tyre janë shprehur me vlerësimin maksimal. Megjithatë kemi dhe 6% të intervistuesve që janë shprehur me vlerësim minimal lidhur me mekanizmat e zbatueshmërisë së legjislacionit. Kjo tregon që edhe pse përpjekjet institucionale janë imponuese në zbatimin e ligjit, ende ka boshllëqe që çojnë në pengimin dhe funksionimin e mekanizmave ligjor.

Sa të dobishëm e gjetët prezantimin për mekanizmat e zbatueshmërisë së legjislacionit në Shqipëri?




Grafik 15: Mekanizmi i zbatimit të legjislacionit në Shqipëri, duke përdorur shkallën nga 1 në 5 (1= minimumi; 5 = maksimumi)



Konventat funksionojnë me marrëveshje dhe janë mekanizma të cilat rregullojnë dhe zgjidhin konflikte ndërmjet shteteve. Një sesion të rëndësishëm kishin përfshirë në pyetësor mbi njohjen dhe përdorimin e konventave. Në vlerësimin e shprehur, rreth 48% të intervistuarit kanë vlerësuar maksimalisht marrjen e njohurive mbi zbatimin e konventave në Shqipëri. Kjo vlere shpjegohet që rreth 80% e aktorëve lokal në punën e tyre bien në kontakt me paketën ligjore mbi përdorimin e konventave. Praktikisht Shqipëria është në një proces të vazhdueshëm aderimi edhe në shumë institucione ndërkombëtare kjo ka nxitur njohjen dhe përshtatjen ndaj të drejtës ndërkombëtare.


Sa të dobishme e gjetët prezantimin për mekanizmat e zbatueshmërisë së konventave në Shqipëri ?



Grafik 16: Mekanizmi i zbatimit të konventave në Shqipëri, duke përdorur shkallën nga 1 në 5 (1= minimumi; 5= maksimumi)

Në sesionin e përgatitur për Direktivat e BE-së, rreth 51% e të intervistuarve janë shprehur maksimalisht pas trajnimeve mbi rëndësinë e përafrimit dhe përdorimit të kuadrit ligjor të BE-së në Shqipëri. Edhe pse Shqipëria nuk është përfshirë me kushte të barabarta në Bashkimin Evropian, janë ngritur ura bashkëpunimi sa i përket edhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë Evropian.

A ndiheni më të përgatitur mbi rëndësinë e përafrimit të Direktivave të BE për Shqipërinë?




Grafik 17: Kuadri ligjor i BE-së (Direktivat), duke përdorur shkallën e vlerësimit nga 1 në 5 (1 = minimumi; 5 = maksimumi)

Të dhënat e gjeneruara dhe analiza e grafikëve janë zhvilluar në vlerësimet e intervistave nga pyetësorët. Në grafikun 18 është vlerësuar në terma gjithëpërfshirës kontributi në përmirësimin e performancës profesionale me bazë kompetenca në punë dhe 45% kanë vlerësuar maksimalisht kontributin e zhvillimit të trajnimit në njohjen dhe përdorimin e së drejtës së mjedisit.

Sidoqoftë aktorët lokal kanë shprehur që studimet dhe trajnimet në këtë drejtim duhet të jenë të vazhdueshme duke kontribuar në përmirësimin e njohurive dhe përdorimit të paketës të së drejtës mjedisore.



Mendoni se informacioni dhe njohuritë e përfituara do t'ju ndihmojë të përmirësoni kompetencën në punën tuaj?



Grafik 18: Kontributi i përftuar, duke përdorur shkallën nga 1 në 5 (1= minimumi; 5 = maksimumi)



KAPITULLI 2



KAPITULLI II: E DREJTA MJEDISORE NË SHQIPËRI

2.1 Historiku i së drejtës Mjedisore në Shqipëri

Procesi i Evolimi i legjislacionit mjedisor në Shqipëri, pas viteve '90 është i ndarë në tre faza: e para 1990-2000, e dyta 2000 - 2011 dhe e treta 2011 deri më sot. Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit pas komunizmit është Ligji nr.7664 datë 21.01.1993 “Mbrojtja e mjedisit”. Ky ligj hodhi bazat e para për një mbrojtje të qëndrueshme të mjedisit krahas zhvillimit të shoqërisë. U njohën parimet ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit, u përcaktuan organet kompetente për mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit si dhe u rregullua mënyra e kontrollit dhe dhënia e informacionit mjedisor. Gjatë kësaj periudhe, legjislacioni u pasurua me ligje të tjera sektoriale që ndihmuan në menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Për rrjedhojë, mbrojtja e mjedisit është pasqyruar edhe në normat penale të miratuara në Kodin Penal të vitit 1995, ku është përfshirë një kapitull për krimet mjedisore.

Me miratimin e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në vitin 1998, e drejta e individit për tu informuar në lidhje me gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, u kthye në një të drejtë të njohur dhe mbrojtur drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta. Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin në vitin 2001 i dha legjislacionit mjedisor një hov të rëndësishëm. Ky plan ishte pikënisja për hartimin e një pakete ligjore gjithëpërfshirëse për mjedisin. Për më tepër, me njohjen e Shqipërisë si vend kandidat potencial nga Bashkimi Europian (BE) në vitin 2000 dhe me miratimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit në vitin 2006, mbrojtja e mjedisit u vendos si një kërkesë e vazhdueshme e procesit për integrimin në BE. Në kushte të tilla, plotësimi i legjislacionit mjedisor dhe përafrimi i tij me direktivat e Bashkimit Evropian mori përparësi si rrjedhojë e përmbushjes së detyrimeve që ka Shqipëria për integrimin në BE.

Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” hodhi themelet për një legjislacion mjedisor bashkohor. Në krahasim me ligjin nr. 7664/1993 “Mbrojtja e mjedisit”, ky akt ligjor plotësonte kërkesat kushtetuese për të

drejtën e qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm, përdorimit racional të pasurisë natyrore si dhe parandalimin dhe kontrollin e ndotjes.

Me krijimin e Ministrisë së Mjedisit, si një institucion qendror i dedikuar për mbrojtjen e mjedisit, aspekti institucional i organeve mjedisore mori dimensione të reja. Në përbërje të strukturave të saj u ngritën drejtori, sektorë e organizma vartës që i shërbejnë drejtpërdrejt realizimit të detyrimeve që ka kjo ministri për mbrojtjen e mjedisit.

Mbrojtja e mjedisit aktualisht rregullohet nga një seri ligjesh dhe aktesh nënligjore të dala në zbatim të tyre. Ligjet kryesore që përbejnë korpusin ligjor të së drejtës mjedisore në Shqipëri janë Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” Ligji nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave” etj, ligje të përafuar me direktivat e BE. Kjo bazë ligjore ka për qëllim garantimin e standardeve më të larta të mbrojtjes së mjedisit. Ligjet sektoriale dhe aktet normative paraqesin një panoramë komplekse dhe të mirë rregulluar të fushës së mbrojtjes së mjedisit. Legjislacioni mjedisor i përgjigjet zhvillimeve aktuale dhe ofron zgjidhje të qëndrueshme për problematikat në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

2.2 Kuadri ligjor mjedisor në Shqipëri (Kushtetuta, Legjislacioni i brendshëm)

E drejta mjedisore është tërësia e normave ligjore që rregullon marrëdhënien e njeriut me mjedisin. Kësaj marrëdhënie po i jepet çdo herë e më tepër rëndësi me synimin e një mjedisi të shëndetshëm. Si një e drejtë themelore, e drejta e qytetarëve për tu informuar mbi gjendjen e mjedisit dhe detyrimi për mbrojtjen e tij garantohen drejt për së drejti nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si akti ligjor më i lartë në hierarkinë e normave. Të drejtat mjedisore përfshihen në kategorinë e të drejtave ku institucionet shtetërore kanë detyrimin të veprojnë për të garantuar një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Autoritetet



publike marrin shpesh vendime që mund të kenë efekte të rëndësishme në mjedis si dhe në shëndetin publik dhe mirëqenien e qytetarëve, prandaj duhet të kenë gjithmonë në konsideratë detyrimin kushtetues për një mjedis të shëndetshëm.

Kushtetuta

Në nenin 56 Kushtetuta sanksionon të drejtën e qytetarëve për të marrë informacion mbi gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij nga institucionet shtetërore. Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore u mundëson qytetarëve të shprehen dhe vendimmarrësve të konsiderojnë opinionet dhe shqetësimet të cilat janë të rëndësishme për vendimmarrjen. Kjo e drejtë rrit cilësinë, përgjegjshmërinë dhe transparencën e procesit të vendimmarrjes dhe kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit publik në çështjet mjedisore.




Figura 2: Paraqitja skematike e legjislacionit mjedisorë Kombëtarë

2.3 Legjislacioni mjedisor Kombëtar

2.3.1 Ligji Nr. 146/2014 “Për informimin dhe konsultimin publik”

Ashtu sikur u konstatua në ligjet e mësipërme projektligjet, projekt dokumentet e strategjive kombëtare, planet, politikat me interes të lartë publik i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Ndryshe nga ligjet e tjerë që parashikojnë parimisht detyrimin e autoriteteve për të zhvilluar konsultimin publik, ky ligj parashikon rregullat dhe procedurën e zhvillimit të konsultimit publik dhe pjesëmarrjes së publikut në proceset politikëbërës dhe vendimmarrëse.

Ky ligj garanton të drejtën e publikut për tu informuar, konsultuar, për tu përfshirë në vendimmarrje duke bashkëpunuar me organet publike në mënyrë që ndikimi i publikut në vendimmarrje të jetë sa më i lartë.

Këto të drejta përbëjnë detyrim për organet publike, të cilat duhet të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje bazuar në:

- a) parimet e transparencës, duke mundësuar përhapje të gjerë të informacionit që i nënshtrohen njoftimit dhe konsultimit me mjetet më efektive;
- b) parimin e efektshmërisë, duke krijuar mekanizma që lehtësojnë pjesëmarrjen e publikut si dhe marrjen parasysh të rekomandimeve të tyre;
- c) parimin e përgjegjësisë lidhur me pasojat që mund të vijnë nga shkelja e detyrimeve ligjore.

Fillimisht organet publiku duhet të marrin të gjitha masat që të bëjnë publike të gjitha aktet që i nënshtrohen njoftimit dhe konsultimit publik me anë të publikimit në regjistrin elektronik të projekt akteve, në programin e transparencës. Organizimi i takimeve publike përbën një të drejtë që lihet në diskrecion të organit publik. Nëse nuk organizohet një takim publik, konsultimi publik organizohet në mënyrë shkresore me anë të dorëzimit të rekomandimeve/opinioneve në institucionin publik ose elektronikisht,



brenda afatit të përcaktuar.

Në rastet kur organi publik e sheh të nevojshme mund të publikojë një njoftim paraprak për aktin që do të hartojë për të siguruar informacion nga palët e interesuara. Në mënyrë që kontributi i palëve të interesuara të jetë sa më efektiv, duhet të pajisen me gjithë informacionin e nevojshëm. Në rast mospajtimi të gjithë informacionit nga organi publik, palët e interesuara kanë të drejtë të bëjnë kërkesë kryesish. Komentet dhe rekomandimet duhet të jepen brenda 20 ditëve nga data e njoftimit ose 40 ditëve për akte komplekse.

Për një pjesëmarrje sa me efektive, në rastin e një procedure që zhvillohet me anë të takimeve publike, për shkak të rëndësisë së projektaktit dhe interesit të lartë të publikut, ky i fundit informohet jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit së bashku me kopje të projektatit.

Gjatë takimit mbahen procesverbale ku pasqyrohen komentet dhe rekomandimet e dhëna nga pjesëmarrësit. Shqyrtimi i tyre bëhet nga organi publik përgjegjës për hartimin e projektaktit, i cili vendos për pranimin ose refuzimin e arsyetuar të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara të konsultuara, duke i bërë ato publike.

Në rast se palëve të interesuara u janë cenuar të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ato kanë të drejtë të bëjnë ankim administrativ tek titullari i institucionit që ka hartuar aktin, kur projektakti nuk është miratuar ende dhe në rast miratimi tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 30 ditëve nga miratimi. Kur titullari konstaton shkelje nga organi publik përgjegjës, njofton palën dhe mundëson reflektimin e vërejtjeve të paraqitura nga ankuesi duke i dhënë mundësinë të paraqesi rekomandime, kurse Komisioneri pas shqyrtimit të qëndrimit të organit publik dhe të ankesës së palës së interesuar, nëse konstaton shkelje i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës.

2.3.2 Ligji Nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

Ky ligj përbën bazën e legjislacionit mjedisor, duke përcaktuar parimet dhe kushtet e përgjithëshme të mbrojtjes së mjedisit. Qëllimi i ligjit është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i mjedisit dhe si rrjedhojë edhe i cilësisë së jetës. Parashikimet ligjore janë hartuar të tilla që të garantojnë zhvillim të qëndrueshëm. Në themel të këtij ligji qëndrojnë parimet mbi bazë të së cilave ngrihen të gjitha përcaktimet e tjera ligjore si kërkesat, përgjegjësit, rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e mjedisit.

Ligji parashikon se përbërësit e mjedisit: ajri, uji, toka dhe natyra duhet të mbrohen nga ndotja me anë të masave përkatëse si dhe të përmirësohet cilësia e tyre. Me qëllim mbrojtjen e mjedisit autoritetet publike hartojnë dhe zbatojnë strategji dhe plane kombëtare dhe vendore efektive në mënyrë periodike. Në rastin e planeve dhe programeve në fusha të përcaktuara në ligj, planeve dhe programeve në zona të mbrojtura dhe dokumenteve të planifikimit strategjik kryhet vlerësim strategjik mjedisor.

Me qëllim parandalimin e efekteve negative në mjedis, projektet e zhvillimit i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ky vlerësim duhet të kryhet nga zhvilluesi duke përcaktuar efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

Ligji përcakton konceptet bazë të cilësisë së mjedisit kurse përcaktimi i normave dhe standardeve specifike i janë deleguar Këshillit të Ministrave, i cili duhet të bëjë parashikimet me anë të akteve nënligjore lidhur me kufijtë e lejuar të një ndotësi. Veprimtaritë që mund të kenë ndikim në mjedis, kanë detyrimin të pajisen paraprakisht me lejen përkatëse të mjedisit, ku përcaktohen kushtet e nevojshme për të garantuar se veprimtaria/instalimi do të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi. Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej tri kriteresh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe në mundësinë që ka ajo



veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut.

Me qëllim parandalimin dhe reduktimin e efekteve negative në mjedis bëhet menaxhim i integruar i mbetjeve, kjo veprimtari rregullohet me ligj të posaçëm. Lidhur me mbrojtjen nga efektet e dëmshme që vijnë prej kimikateve, rregullat për përdorimin e substancave ozon holluese, kontrolli për përdorimin e kimikateve dhe pesticideve, masat për mbrojtjen nga zhurmat dhe erërat e pakëndshme parashikohen me ligj të veçantë ose akteve nënligjore.

Monitorimi i gjendjes së mjedisit përbën një nga mekanizmat kryesor të mbrojtjes së mjedisit. Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit është mekanizmi i krijuar nga ligji për monitorimin e mjedisit nën udhëheqjen e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Ky organ administron sistemin e informacionit mjedisor, i cili mundëson mbrojtjen dhe menaxhimin e integruar të mjedisit dhe përbërësve të tij, monitorimin e zbatimit të politikave mjedisore, raportimeve të ndërsjella, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimit të informimit të publikut.

Ligji i ka dhënë një rëndësi të madhe të drejtës për informim duke e ndarë në dy momente:

- 1) E drejta e publikut për të kërkuar informacion mjedisor dhe detyrimi i autoriteteve për ta dhënë këtë informacion në kohë;
- 2) Detyrimi i autoriteteve publike për të garantuar që publiku ka të gjitha mundësitë për t'u informuar pa bërë një kërkesë paraprakisht, në mënyrë që të ketë mundësi të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Në Kreun VII të ligjit parashikohet qëllimi, funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor dhe mënyra e dhënies së informacionit. Krijimi i sistemit të informacionit mjedisor shërben për mbrojtjen dhe menaxhimin e integruar të mjedisit dhe përbërësve të tij, për monitorimin e zbatimit

të politikave mjedisore, raportimeve të ndërsjella, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe sigurimit të informimit të publikut. Ky sistem administrohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Të dhënat që përmban sistemi i informacionit mjedisor garantojnë nga informacioni i grumbulluar prej autoriteteve publike të cilat kanë detyrimin t'i dorëzojnë periodikisht pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Përveç rasteve kur përben vepër penale, ky ligj parashikon mjetin ligjor administrative dhe gjyqësore ndaj çdokujt që dëmton mjedisin si dhe të drejtën e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje duke i dhënë mundësinë publikut të ketë rol aktiv në mbrojtjen e mjedisit.

Ashtu sikurse të gjithë kanë të drejtë për një mjedis të shëndetshëm, në të njëjtën kohë secili mban përgjegjësi për veprimet në dëm të mjedisit, mbështetur në parimin “Ndotësi paguan” me qëllim parandalimi dhe zhdëmtimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet mjedisit dhe rehabilitimi i mjedisit;

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është organ i krijuar me ligj dhe ka për kompetencë hartimin dhe implementimin e politikave të mjedisit, monitorimin e zbatimit të legjislacionit mjedisorë dhe licensimin e veprimtarive dhe aktiviteteve që mund të kenë ndikim në mjedis si dhe kompetenca të tjera të ngarkuara me ligjë ose akte nënligjore. Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit. Inspektorati ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim që në bazë të këtij ligji, që mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit si dhe me kërkesat e përcaktuara në dispozitat e legjislacionit specifik. Në rast se një veprimtari përbën rrezik të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit, inspektorati ka të drejtë të vendos pezullimin e asaj veprimtarie.



2.3.3 Ligji 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar

Me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga projektet e propozuara publike ose private të cilat mund të shkaktojnë efekte të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta para miratimit të tyre ky ligj parashikon rregullat dhe procedurat për parandalimin, minimizimin dhe kompensimin e dëmeve në mjedis.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Projektet të cilat i nënshtrohen procesit paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis janë të mirë përcaktuara në shtojcat të cilat i bashkëlidhen këtij ligji, ndërkohë që për projektet që i nënshtrohen procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, përveç atyre të listuar në shtojcën 1, i nënshtrohen edhe ato projekte të shtojcës II për të cilat AKM-ja e vlerëson të nevojshme. Për projektet që i nënshtrohen procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ministri në përfundim të procedurës lëshon deklaratën mjedisore në bazë të secilës vendos:

- a) Miratimin e lejes;
- b) Miratimin e lejes me plotësimin e disa kushteve
- c) Refuzimin e kërkesës për leje në rastin e ndikimeve negative në mjedis me pasoja afatgjata.

Pjesë e procedurës janë edhe njësitë e qeverisjes vendore dhe ministritë e linjës të cilat pasi marrin në dorëzim dokumentacionin japin mendim sipas funksioneve dhe përgjegjësi përkatëse. Një rol të rëndësishëm luan edhe publiku i prekur nga projekti i propozuar dhe organizatat jofitimprurëse. Zhvilluesi i projektit që i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së ka detyrimin ti informojë dhe të konsultohet me ta, pasi përbënë pjesë te dokumentacionit të nevojshëm që dorëzohet për deklaratën mjedisore.

Ndërkohë dëgjesën me publikun dhe OJF-të e zhvillon AKM-ja në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore dhe zhvilluesin e projektit. Mendimet e tyre janë të domosdoshme për vendimmarrjen e VNM-së.

Autoritetet të cilat kanë për detyrë të lëshojnë leje ose liçensa për veprimtari të caktuara janë të detyruara të marrin në konsideratë deklaratën për VNM-n ose Lejen Mjedisore. Në rast se merr një vendim në kundërshtim me deklaratën duhet të jap argumentet përkatëse. Nëse veprimtaria apo projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës apo vendimi për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Ky ligj aplikohet edhe për projekte të propozuara të cilat veçmas apo së bashku me projekte të tjera të realizuara ose propozuara kanë efekt negative të rëndësishëm mbi integritetin e një zone veçanërisht të mbrojtur. Në këtë rast autoriteti përgjegjës nuk lejon zhvillimin përveç kur nuk ka zgjidhje tjetër ose kur prevalojnë interesa madhorë të publikut si siguria e publikut apo shëndeti i njeriut apo me efekte pozitive të rëndësishme për publikun.

Në rastin e një projekti me efekt ndërkufitar, AKM-ja me marrjen e raportit të VNM-së nga një shtet tjetër informon ministrinë për të filluar bisedimet ose në rast se merr dijeni kryesisht, kërkon informacion në lidhje me projektin. Në këtë rast ndiqen procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis ndërkufitar të cilat rregullohen me ligjë dhe akte nënligjore dhe nga marrëveshje ose konventa ndërkombëtare.

2.3.4 Ligji Nr.10 463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet:

- Parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve;



- Përmirësimit të efçencës së përdorimit të tyre;
- Pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Me “menaxhim të integruar të mbetjeve” kuptohet grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi ose riciklimin mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit. Menaxhimi i integruar i mbetjeve duhet bërë duke mbajtur në konsideratë sigurinë e shëndetit të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit.

Për të garantuar menaxhimin e duhur të mbetjeve duhet të merren masa për parandalimin dhe minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative gjatë procesit të asgjësimit ose riciklimit.

Efektiviteti i menaxhimit të integruar të mbetjeve arrihet duke mbajtur në konsideratë këtë hierarki:

- a) parandalimin e mbetjeve
- b) përgatitjen për ripërdorim
- c) riciklimin
- d) rikuperime të tjera
- e) asgjësimin

Ky ligj përcakton rastet kur një mbetje pushon së qeni mbetje me plotësimin e kushteve të caktuara dhe në bazë të kritere specifike.

Ligji parashikon ripërdorimin e produkteve, grumbullimin e diferencuar në letër, metal, plastikë dhe qelq duke ndihmuar në këtë mënyrë riciklimin dhe rikuperimin e tyre si dhe asgjësimin e atyre mbetjeve që nuk rikuperohen.

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve si dokumenti më gjithëpërfshirës i dalë në zbatim të ligjit, hartohet nga ministria përmban masat e detajuara që do të merren për të arritur objektivat e vendosur për çdo veprimtari që lidhet për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ambalazheve,

mbetjeve të biodegradueshme si dhe çdo parashikim tjetër ligjor.

Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve mbulon kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe kryen trajtimin e tyre vet ose me ndihmën e një tregtari që kryen operacione trajtimi të mbetjeve.

Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen nga subjektet të autorizuara vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, në përputhje me këtë ligj. Këto kushte përfshijnë masat që sigurojnë gjurmueshmërinë e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar të tyre, si dhe kontrollin e mbetjeve të rrezikshme, me qëllim plotësimin e kërkesave të këtij ligji.

Për shkak të pasojave të rënda në mjedis dhe në shëndetin e njeriut krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhet në kushte të mirpërcaktuara në ligj që nga krijimi deri në destinacioni përfundimtar. Personat fizikë a juridikë, që synojnë të kryejnë operacione për trajtimin e mbetjeve, pajisen me leje mjedisi.

Mbetjet të cilat cohen në lëndfill duhet ti jenë nënshtruar trajtimit. Lëndfillet klasifikohen në tri kategori:

- a) lëndfille për mbetjet e rrezikshme;
- b) lëndfille për mbetjet jo të rrezikshme;
- c) lëndfille për mbetjet inerte.

Ky ligj ndalon në mënyrë taksative importimi apo kalimin transit ndërkufitar të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë. Me autorizim të ministrit mund të kalojnë transit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë mbetjet jo të rrezikshme apo mbetjet inerte si dhe mund të bëhet eksporti i mbetjeve.



2.3.5 Ligji Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

Mbrojtja e cilësisë së ajrit përbën domosdoshmëri për mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Ky ligj përcakton kufijtë dhe normat e lejuara të ndotjes si dhe vendos detyrimin për monitorimin e parametrave të cilësisë së ajrit në të gjithë teritorin. Përcaktohen metodat dhe kriteret në bazë të së cilave duhet të bëhet vlerësimi i cilësisë së ajrit për secilin ndotës të përcaktuar me VKM. Në bazë të rezultateve të këtyre ndotësve në ajër, kur kalohen vlerat kufi përgatitet plani i cilësisë së ajrit.

Plani i cilësisë së ajrit hartohet me qëllim përcaktimin e masave të nevojshme për arritjen e sa më shpejt të jetë e mundur të vlerave kufi duke u bazuar edhe në planet e veprimit afatshkurtër. Planet e veprimit afatshkurtër vihen në veprim në rastet kur nivelet e ndotjes e tejkalojnë ose kanë rrezik të tejkalojnë prapun e alarmit duke marrë të gjitha masat e nevojshme për pakësimin e rrezikut ose të nivelit të tejkaluar, përfshirë këtu edhe pezullimin e veprimtarive që kontribuojnë në kapërcimin e vlerave kufi, vlerave të synuara apo të pragut të alarmit përkatës.

Autoritetet kompetente që kontribuojnë në zbatimin e këtij ligji janë: ministria, AKM-ja, njësitë e qeverisjes vendore dhe ministrinë e linjës. Secili prej këtyre organeve kanë përgjegjësi të mirë përcaktuara në ligj me qëllimin përfundimtar ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Këto organe kanë detyrimin të bëjnë të disponueshëm për publikun dhe organizatat e interesuara draft planet për cilësinë e ajrit, planet afatshkurtër dhe çdo informacion tjetër që disponojnë sipas kompetencave përkatëse lidhur me cilësinë e ajrit në Republikën e Shqipërisë.

2.3.6 Ligji Nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, i ndryshuar.

Mbrojtja e mjedisit detar është detyrë e të gjitha organeve shtetërore qendrore dhe vendore të cilët e kanë nën administrim, organizatat shoqërore dhe personat

fizikë apo juridikë privat ose shtetëror që e përdorin ose shfrytëzojnë atë.

Mjedisi detar përdoret dhe shfrytëzohet për veprimtari ekonomike, tregtare, shkencore, shoqërore, sportive, turistike e ushtarake.

Kontrolli i mjedisit detar dhe i veprimtarive që zhvillohen në të ushtrohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Mjedisit, nga kapitaneritë e porteve, nga organet shtetërore që kanë veprimtari të liçencuara, si dhe nga organe të tjera të përcaktuara me ligj. Çdo person që vëren ndotje të mjedisit detar është i detyruar të njoftojë kapitanerinë e portit ose organin shtetëror më të afërt. Përdoruesit e mjedisit detar që kanë shkaktuar ndotjen e mjedisit detar, detyrohen të pastrojnë zonën e ndotur, ta sjellin atë në gjendjen e mëparshme, si dhe të shpërblejnë demet. Kur kemi raste shkarkimesh të lëndëve që shkaktajnë ndotje në shkallë të lartë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë përben vepër penale.

2.3.7 Ligji Nr. 10006 datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”, i ndryshuar

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e faunës së egër, me synim për të ruajtur llojet, popullatat, habitatet ku ato jetojnë, rrugët e shtegtimit, si dhe për të siguruar kërkesat e tyre për ushqim, strehim dhe shumim.

Fauna e egër në territorin e Republikës së Shqipërisë është pasuri kombëtare, që administrohet dhe mbrohet me ligj, në përputhje edhe me konventat përkatëse ndërkombëtarë, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Mbrojtja e faunës do të quhet e përshtatshme sipas këtij ligji nëse do të bëhet sipas llojit, gjendjes dhe habitatit ku jeton. Ky ligj garanton mbrojtjen në përgjithësi të florës dhe faunës por duke e diferencuar shkallën e mbrojtjes për lloji të veçantë. Llojet e kërcënuara dhe endemike gëzojnë mbrojtje të veçantë sa i përket planeve të shumimit, monitorimit të vazhdueshëm, ndalimin ose kufizimin e veprimtarive që shkatërrojnë këto llojeve.



Ky ligj parashikon mbrojtje të habitateve nga veprimtaritë ekonomike me pasoja negative, të faunës së egër nga ndryshimet klimatike me efekte negativ, lëndët dhe mbetjet e rrezikshme, lënde të tjera të dëmshme apo çdo lloj tjetër veprimtarie njerëzore që sjell pasoja, duke parashikuar masat që duhen marrë për të shmangur këto pasoja.

Përrjashtimi aplikohet vetëm për interes publik, shëndetësor, kërkime shkencore dhe edukative. Një sërë aktorësh si strukturat menaxhuese, organet e qeverisjes vendore, universitetet e qendrat kërkimore-shkencore dhe OJF-të kanë detyrimin ose të drejtën të hartojnë dhe zbatojnë programe përkujdesjeje për faunën e egër në rastin e fatkeqësive natyrore.

Fauna e egër mbrohet nga një sërë veprimesh të dëmshme ndërkohë që lejohet të përdoret veç për qëllime shkencore, edukimi kulturor, koleksione zoologjike dhe për përfitime produktesh jetësore. Në periudha të caktuara mund të ndalohet përdorimi i tyre, ndërkohë që përdorimi i faunës së egër të mbrojtur është e lejuar vetëm për arsye shkencore, kulturore, edukimi.

Me qëllim monitorim të faunës së egër hartohet programi i biomonitorimit i cili përmban të dhëna të dorëzuara nga persona fizikë e juridikë, publik dhe privatë. Këto të dhëna duhen publikuar me qëllim informimin e publikut.

Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër është organi konsultativ që ndihmon në lehtësimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, kurse policia Pyjore dhe Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit janë organe të specializuara për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, të akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të konventave përkatëse, ku Republika e Shqipërisë është pale.

2.3.8 Ligji Nr. 57/2020 “Për pyjet”

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës,

ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ligji kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve, që mundëson një jetë më të mirë për shoqërinë sot dhe brezat e së ardhmes, duke rregulluar marrëdhëniet në sektorin e pyjeve, që kanë ndikim thelbësor në cilësinë e mjedisit natyror, në zhvillimin e bujqësisë, të energjisë dhe të turizmit, në uljen e varfërisë, zhvendosjen e popullsisë, zbutjen e konflikteve dhe të pabarazive me bazë sociale, gjinore, si dhe në sigurinë e vendit.

Ky ligj synon ruajtjen, shtimin e sipërfaqes dhe rritjen e volumit të përgjithshëm të fondit pyjor kombëtar, rregullimin e marrëdhënieve dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare, organizimin funksional në të gjitha nivelet e qeverisjes për shfrytëzimin dhe përdorimin e qëndrueshëm e të balancuar të burimeve pyjore përkundrejt mundësisë që pyjet kanë, pa cenuar vazhdueshmërinë e jetës dhe ciklin e pyllit. Po kështu, ligji siguron garantimin e shërbimeve cilësore duke synuar mbrojtjen e duhur, përmirësimin dhe rigjenerimin e hapësirës pyjore.

Rëndësia e veçantë konsiston në mbrojtjen e klimës, tokës, kontributit në ruajtjen e ekuilibrave të mjedisit natyror apo biodiversitetit duke mundësuar një jetë më të mirë për njerëzimin.

Mbrojtja, përmirësimi dhe rigjenerimi i hapësirës pyjore është një nga qëllimet e vendosura nga ky ligj.

Parashikimet ligjore bëhen mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ligji parashikon kategoritë e pyjeve, përbërjen e fondit pyjor, përjashtimet dhe llojet e fondit pyjor. Me qëllim përmbledhjen e gjithë informacionit lidhur me fondin pyjor është krijuar Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor.

Plani Kombëtar i Pyjeve pasqyron politikat e qeverisjes dhe aktivitetet konkrete për realizmin e tyre. Ligji parashikon parimet kryesore mbi bazën



e të cilave hartohet qeverisja e sektorit të pyjeve. Në funksion të zhvillimit të sektorit të pyjeve operojnë edhe grupet e interesit dhe Këshilli i Pyjeve.

Organizimi strukturor institucional i sektorit të pyjeve ndahet në institucione qëndrore dhe vendore sipas kompetencave të përcaktuara në ligj. Institucionet qëndrore janë Ministria dhe Agjencia Shtetërore Përgjegjëse për Pyjet, kurse ato vendore janë struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki, struktura Komunitare në fshat, inspektorët. Këto struktura ashtu sikurse subjektet private e subjektet që kryejnë veprimtari në fondin pyjor kanë detyrim të përhershëm të mbrojnë fondin pyjor kombëtar duke zbatuar masat parandaluese, vëzhguar, evidentuar apo sinjalizuar dëmet, ndihmuar në rikuperimin e dëmeve dhe rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara si pasojë e faktorëve dhe fenomeneve që cenojnë dhe dëmtojnë fondin pyjor kombëtar.

Ligji lejon që fondi pyjor kombëtar të shfrytëzohet dhe të merren këto përfitime:

- a) përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve në ekosistem që pylli mundëson.
- b) përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari të ndryshme, që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar.
- c) përfitimet nga prodhimi, shfrytëzimi dhe shitja e prodhimeve jodrusore nga pylli.
- d) përfitimet nga prodhimi, shfrytëzimi dhe shitja e materialit drusor.

Në dhënien e të drejtave për të përfituar nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar mbahet në konsideratë rëndësia dhe interesi publik për pyjet si pasuri kombëtare, që prevalon mbi çdo interes tjetër që mund të ndërthuret me fondin pyjor kombëtar.

Kontrolli i veprimtarisë në fondin pyjor si një nga hallkat më të rëndësishme për realizimin e objektivave të vendosura në ligj ushtrohet nga tre struktura:

- a) struktura përgjegjëse në agjenci.
- b) struktura përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki.

c) struktura përgjegjëse në zonat e mbrojtura.

Si rezultat i proceseve të kontrollit, strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe procesin e inspektimit në pyje, nëse konstatojnë shkelje ndërmarrin masa parandaluese dhe sanksione administrative.

Përveç përgjegjësive të tjera personi fizik apo juridik i cili ka shkaktuar ndotjen dhe/ose dëmtimin e fondit pyjor kombëtar mban edhe përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për fondin pyjor kombëtar, mbështetur në parimin “dëmtuesi paguan”.

2.3.9 Ligji Nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar

Ky ligj synon:

Të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik.

Të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritimit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Të sigurojë ngritjen e rrjetit për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të përcaktojë masa për të mbajtur ose rivendosur në një status të favorshëm ruajtjeje habitatet natyrore dhe llojet e faunës së egër të Shqipërisë dhe me interes për Komunitetin European.

Të sigurojë që masat e ndërmarra, në zbatim të këtij ligji, të marrin në konsideratë kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe karakteristikat rajonal

Në kuadër të këtyre qëllimeve të përcaktuara nga ligji duhet të veprojnë të gjitha institucionet përgjegjëse sipas kompetencave përkatëse. Institucionet bazohen në strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit të miratuar nga



Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit. Si burim informacioni përdoret edhe rrjeti i inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit.

Ruajtja e ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve, që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, përfshin:

- a) ekosistemet, habitatet dhe peizazhet e mbrojtura.
- b) ekosistemet, habitatet dhe peizazhet veçanërisht të mbrojtura.
- c) ekosistemet, habitatet dhe peizazhet e degraduara.

Ministria merr masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të shmangur dëmtimin dhe/ose shqetësimin për secilën nga llojet, kurse KM miraton listën përbërëse të llojeve.

Veprimtaritë që përdorin dhe shfrytëzojnë elemente të diversitetit biologjik dhe të përbërësve të tij do të pajisen me leje mjedisore në rastet kur:

- a) veprimtaria kërkimore është në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
- b) janë siguruar informacione për personat juridikë dhe fizikë, që do të kryejnë kërkime, për përdorimin e mëvonshëm të materialeve kërkimore, objekt studimi, si dhe informacione të tjera shoqëruese;
- c) parashikohet se veprimtaria kërkimore do të ketë ndikim negativ në diversitetin biologjik.

Organet shtetërore nxisin dhe mbështesin institucionet kërkimore-shkencore. Ky ligj i jep rëndësi dijeve, risive dhe praktikave të mira për ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij me qëllim që ato të respektohen, ruhen dhe promovohen.

Organet shtetërore kanë detyrimin të informojnë publikun për diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij me qëllim që publiku të kontribuoj në ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm si dhe të përfshihet në vendimarrje.

Kontrolli për zbatimin e parashikimeve ligjore bëhet nga:

- a) inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit
- b) Policia e Shtetit
- c) Policia Pyjore
- d) Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit
- e) Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së bimëve
- f) Shërbimi i Zooteknisë
- g) Inspektoratet e tjera.

Çdo organ shtetëror, organizatë shoqërore, person juridik ose fizik, që dëmton ose kërcënon biodiversitetin, përgjigjet për dëmtimet dhe përballon koston e ripërtëritjes e të rehabilitimit të përbërësve të prekur të biodiversitetit.

2.3.10 Ligji Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to, nëpërmjet shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore, me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit;

- Zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, pasurive kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit, si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm;
- Lehtësimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e vlerësimit e shërbimeve të ekosistemeve (mjedisore);
- Informimin dhe edukimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura mjedisore.

Zonat e mbrojtura mjedisore dhe burimet e tyre natyrore e biologjike shpallen, ruhen, administrohen dhe menaxhohen, në bazë të parimit të zhvillimit të



qëndrueshëm.

Funksionet mjedisore, ekonomike, sociale e kulturore të zonave të mbrojtura realizohen, nëpërmjet:

- a) Evidentimit, përcaktimit dhe shtimit të zonave të mbrojtura mjedisore ose zgjerimit të atyre ekzistuese;
- b) Sigurimit, ruajtjes, rehabilitimit dhe ripërtëritjes së ekosistemeve të habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore brenda zonave të mbrojtura mjedisore;
- c) Përdorimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore, duke integruar elementë të tij në strategjitë, planet, programet dhe vendimarrjet e të gjitha niveleve

Ligji ka parashikuar mjetet ligjore për ruajtjen e zonave të mbrojtura duke shpallur zonat e mbrojtura me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre, zhvillimin e tyre duke përcaktuar kushte lehtësuese dhe informimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë.

Objektivat ligjor arrihen duke u bazuar në:

- a) Parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në mënyrë që burimet e tokës të planifikohen dhe menaxhohen me kujdes;
- b) Parimin e integritetit të politikave mjedisore me ato ekonomike;
- c) Parimin “ndotësi paguan” ku përgjegjësi paguan për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar
- d) Parimin e parandalimit të ardhjes së pasojave.

Zonat e mbrojtura mjedisore, sipas llojit të interesit për të cilin ka marrë statusin e mbrojtjes, janë:

- a) Zona të mbrojtura me interes kombëtar;
- b) Zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar ku bëjnë pjesë:
 - i. zonat “Ramsar”;

- ii. zonat me interes për Komunitetin Europian (SACs), ku bëjnë pjesë zonat e veçanta të ruajtjes të habitateve dhe të shpendëve (SCI dhe SPAs);
- iii. zonat me interes të veçantë ruajtjeje (zonat e rrjetit Emerald);
- iv. zonat “Rezervë të biosferës”;
- v. zonat e trashëgimisë natyrore.

Zonat e mbrojtura mund të jenë shtetërore ose private kurse administrimi i tyre bëhet në 4 forma: shtetërore, private, bashkiake dhe të kombinuara.

Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore përgatit planin e shpalljes së zonave të mbrojtura në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse duke marrë parasysh rrjetin ekzistues të zonave të mbrojtura. Shpallja e zonave të mbrojtura ose ndryshimi apo heqja e statusit mund të bëhet edhe me kërkesë të çdo institucioni shtetëror, organizate jofitimprurëse ose komunitet. Plani publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse në mënyrë që çdo person i interesuar brenda 1 muaji të bëjë sugjerim ose vërejtje. Pas hartimit të propozimit ministri propozon projektvendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonës.

Këto institucione së bashku me grupet e interesit në drejtim të AKZM-së hartojnë planin e menaxhimit të zonave të mbrojtura. Plani i menaxhimit të zonave të mbrojtura është akti juridik i cili përmban parashikime të detajuara për realizimin e objektivave, politikave, planeve dhe programeve sektoriale. Zbatimi i planeve të menaxhimit monitorohet nga komiteti.

Kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore janë:

- a) Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I)
- b) Park kombëtar (kategoria II)
- c) Monument natyror (kategoria III)
- d) Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV)
- e) Peizazh i mbrojtur (kategoria V)



- f) Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (kategoria VI)
- g) Park natyror bashkiak (kategoria IV)
- h) Kurorë e gjelbër (kategoria V)

Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore është institucioni qendror politikëbërës për mbrojtjen dhe administrimin e zonave të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura, në varësi të ministrit dhe ka për detyrë administrimin e kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKZM funksionon në nivel qendror dhe vendor në bazë qarku të ashtuquajtura administrata rajonale e zonave të mbrojtura. Ligji parashikon detyrat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni në funksion të mbrojtjes së zonave të mbrojtura. Në funksion të kompetencave menaxhuese bashkitë e realizojnë këtë detyrë në bashkëpunim me administratën rajonale të zonave të mbrojtura dhe me administratën e zonave përkatëse duke krijuar njësinë e mbrojtjes së mjedisit. Për të ndjekur zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura ngrihen komitetet e menaxhimit, me përbërje nga bashkia/bashkitë, brenda territorit administrativ të të cilit/cilave ndodhet zona e mbrojtur, AKZM-ja, nga institucionet vendore që kanë lidhje direkte me to, si të bujqësisë, të turizmit, të infrastrukturës, shoqërisë civile, përfaqësues nga pronarët e pyjeve e kullotave që gjenden në zonat e mbrojtura dhe drejtohen nga prefekti.

Publiku përveç të drejtës për të dhënë kontributin në hartimin e planeve të menaxhimit dhe të shpalljes së zonave të mbrojtura ka edhe detyrimin që të respektojë rregullat dhe kufizimet e vendosura nga administrata e ruajtjes së zonës.

Kontrolli i zonave të mbrojtura bëhet nga Inspektorati i Policisë Pyjore dhe administrata e zonës së mbrojtur. Kushdo që dëmton mjedisin e zonave të mbrojtura përgjigjet për dëmtimet, si dhe përballon kostot e riparimit të dëmit e të rehabilitimit të zonës e të kthimit të saj në gjendjen e mëparshme.



KAPITULLI 3



KAPITULLI III: E DREJTA MJEDISORE NDËRKOMBËTARE

3.1 Drejtën Ndërkombëtare të Mjedisit

E drejta ndërkombëtare e mjedisit është një pjesë së drejtës ndërkombëtare që ka për objekt mbrojtjen e mjedisit, kryesisht përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare e mjedisit rrjedh kryesisht nga tre burime: e drejta zakonore ndërkombëtare; traktatet ndërkombëtare; dhe vendimet gjyqësore të gjykatave ndërkombëtare. E drejta zakonore ndërkombëtare i referohet një sërë ligjesh të pashkruara që kanë lindur nga zakonet dhe përdorimi i përhapur midis kombeve. Shembuj të së drejtës zakonore ndërkombëtare mjedisore përfshijnë paralajmërimin e një kombi fqinj për një aksident të madh që mund të ndikojë në mjedisin e tij. Vendimet e gjykatave ndërkombëtare ose arbitrave, të tilla si Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ose Gjykata Ndërkombëtare për Ligjin e Detit, gjithashtu formësojnë ligjin ndërkombëtar të mjedisit. E drejta ndërkombëtare e mjedisit u zhvillua si një nëngrup i së drejtës ndërkombëtare në mesin e shekullit XX. Megjithëse lëvizjet e mbrojtjes së mjedisit u zhvilluan në shumë kombe në shekullin XIX, këto lëvizje zakonisht adresuan vetëm shqetësimet mjedisore brenda një kombi të vetëm. Rritje e provave shkencore mjedisore nga vitet 1950 dhe 1960, megjithatë, ilustroi problematikat mjedisore globale, së bashku me nevojën për një zgjidhje shumëkombëshe për çështjet mjedisore. Hulumtimet shkencore vërtetuan se ndotja e ajrit dhe ujit, peshkimi pa masë dhe çështje të tjera mjedisore shpesh kanë efekte që arrijnë përtej kufijve të ndonjë kombi të veçantë. Nga fundi i viteve 1960, komuniteti ndërkombëtar kuptoi se kërkohej një qasje ndërkombëtare ndaj çështjeve mjedisore. E drejta mjedisore në dimensionin ndërkombëtar dhe kombëtar tashmë përbën një pjesë të rëndësishme të të drejtave themelore të njeriut. Të drejtat mjedisore nënkuptojnë çdo shpallje të një të drejte njerëzore për kushte mjedisore të një cilësie të specifikuar.⁴ Të drejtat e njeriut dhe mjedisi janë të ndërthurura; të drejtat e njeriut nuk mund të gëzohen pa një mjedis të sigurt, të pastër dhe të

4 UNEP. <https://www.unenvironment.org/explore-topics/environmental-rights-and-governance/what-we-do/advancing-environmental-rights-what>

shëndetshëm; dhe qeverisja e qëndrueshme mjedisore nuk mund të ekzistojë pa vendosjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

3.2 Evolucionit historik mbi të Drejtën Ndërkombëtare të Mjedisit

E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit përkufizohet në tre epoka duke filluar me “Epokën tradicionale” deri në vitin 1970, e cila nganjëherë ndahet para vitit 1945 dhe një periudhe pas 1945; nga eksperte të ndryshëm, vazhdon me “Epokën moderne” e cila fillon nga zhvillimi i Konferencës së Kombeve të Bashkuara në Stokholm në vitin 1972 deri me Samitin e Rios me 1992 dhe Mjedisit dhe “Epoka postmoderne” nga Samiti i Rios dhe në ditët tona.

Çështja e Arbitrazhit të Shkrirjes së Trailëve të vitit 1938 dhe 1941, një nga çështjet më të hershme të ligjit ndërkombëtar të mjedisit, përfshiu një mosmarrëveshje midis Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë rreth ndotjes së ajrit nga një fabrikë kanadeze e shkrirjes. Ndotja shpërtheu përtej kufirit Amerikano-Kanadez dhe shkatërroi të korrat në shtetin e Uashingtonit. Pas 15 vitesh, një panel ndërkombëtar i arbitrazhit krijoi “parimin ndotësi paguan”, një themel themelor i ligjit ndërkombëtar të mjedisit. Parimi ndotësi paguan thotë se nëse ndotja nga një komb shkakton dëm në një komb tjetër, atëherë kombi ndotës duhet të paguajë për të korrigjuar dëmin. Traktatet ndërkombëtare janë burimi më i fundit dhe më efektiv i ligjit ndërkombëtar të mjedisit. Sovraniteti i kombeve vazhdon si pengesa kryesore për të gjitha format e së drejtës ndërkombëtare. Parimi i sovranitetit thotë se çdo komb ka kontroll të plotë mbi aktivitetet brenda kufijve të tij, përveç nëse ai komb bie dakord të heqë dorë nga një kontroll. Kombet zakonisht abrogojnë (eliminajnë) një pjesë të sovranitetit të tyre përmes traktateve dypalëshe ose multilaterale ndërkombëtare. Shkatërrimi i ekosistemeve dhe shfrytëzimi i florës dhe faunës së egër ishin çështjet e para mjedisore që morën vëmendje të gjerë ndërkombëtare.

Në 1963, Unioni Botëror i Konservimit (IUCN), një organizatë joqeveritare (OJQ) kushtuar ruajtjes së mjedisit, u bëri thirrje të gjitha kombeve të



ndërmarrin hapa për të mbrojtur speciet e rrezikuara. Pas një konference mbi këtë çështje, 80 kombe shpallën Konventën mbi Tregtinë Ndërkombëtare në Speciet e Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër (CITES). CITES është një marrëveshje ndërkombëtare e krijuar për të mbrojtur bimët dhe kafshët e rrezikuara duke rregulluar tregtinë e specieve ose produkteve të rrezikuara që rrjedhin prej tyre. Që kur hyri në fuqi në 1975, CITES ka zhvilluar një mbështetje të gjere ndërkombëtare. Aktualisht, 172 kombe janë palë në kongres. Që nga vitet 1970, Kombet e Bashkuara kanë bërë presion për rritjen e traktateve mjedisore multilaterale ndërkombëtare. Në 1968, shkencëtarët dhe përfaqësuesit nga 60 kombe u takuan në Konferencën e Biosferës së Kombeve të Bashkuara në Paris për të diskutuar ndotjen, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe shkatërrimin e ligatinave. Konferenca e Biosferës nuk prodhoi ndonjë traktat zyrtar ndërkombëtar. Konferenca e Biosferës hodhi bazat për konferencat dhe traktatet e ardhshme ndërkombëtare mjedisore duke shprehur dëshirën për një ekuilibër midis shfrytëzimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore.

Epoka e re e të Drejtës Ndërkombëtare fillon kur Kombet e Bashkuara mblodhën konferencën e parë të ndërkombëtare mbi mjedisin, Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor (UNCHE), në Stokholm, Suedi, në 1972. Përveç çështjeve mjedisore, UNCHE ose Konferenca e Stokholmit, gjithashtu adresoi çështja e zhvillimit të qëndrueshëm. Konferenca e Stokholmit prodhoi dy konventa në lidhje me këto çështje: Deklarata e Konferencës për Mjedisin Njerëzor dhe plani i veprimt. Deklarata e Konferencës vuri në dukje se shumë faktorë të ndryshëm kontribuojnë në degradimin e mjedisit, duke përfshirë rritjen e popullsisë, zhvillimin ekonomik, industrializimin dhe përparimet teknologjike. Deklarata e Konferencës deklaroi se çdo njeri ka të drejtë për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Deklarata u bëri thirrje gjithashtu njerëzve për të menaxhuar jetën e egër dhe ekosistemet e tyre për të siguruar ekzistencën e tyre të vazhdueshme, duke përfshirë një ulje të ndotjes. Ai gjithashtu rekomandoi që kombet e industrializuara të sigurojnë mbështetje financiare dhe teknologjike për vendet në zhvillim në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë ekonomitë e tyre në një mënyrë të përgjegjshme për mjedisin.

Plani i veprimit i Konferencës së Stokholmit përmbante 109 rekomandime specifike për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe ruajtjes së mjedisit. Kombet e Bashkuara krijuan Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) për të zbatuar rekomandimet e planit të veprimit dhe për të koordinuar ndihmën për ekonomitë në zhvillim. Në 1982, Kombet e Bashkuara hapën Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit (UNCLOS) për nënshkrime. UNCLOS është marrëveshja kryesore ndërkombëtare në lidhje me përdorimin dhe mbrojtjen e oqeanëve. Nevoja për marrëveshje ndërkombëtare mbi përdorimin e oqeanëve ishte bërë e dukshme nga mesi i shekullit XX. Përparimet teknologjike rritën përdorimin dhe shfrytëzimin e oqeanit dhe burimeve të tij në një nivel të paparë. Popullatat e peshqve ranë me shpejtësi, dhe rritja e ndotjes detare shkatërroi ekosistemet bregdetare dhe ato me ujë të hapur. Përfaqësues nga 160 kombe u takuan në Konferencën e Tretë të Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit për të adresuar vendosjen e rregullave ndërkombëtare detare dhe rregulloreve të mbrojtjes së mjedisit. Pas nëntë vjet negociatash, konferenca kaloi UNCLOS. UNCLOS adresoi kufijtë territorialë detarë, të drejtat ekonomike mbi burimet detare dhe të drejtat e tranzitit të anijeve. UNCLOS adresoi gjithashtu ndotjen dhe shqetësime të tjera mjedisore. Neni 192 i UNCLOS thotë se të gjitha kombet kanë një detyrim të përgjithshëm “për të mbrojtur dhe ruajtur mjedisin”. UNCLOS hyri në fuqi në 1994; që nga viti 2008, 155 kombe kanë nënshkruar UNCLOS. Në 1983, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara thirri Komisionin Botëror të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (WCED), ose Komisionin Brundtland. Në 1987, Komisioni Brundtland lëshoi gjetjet dhe propozimet e tij përfundimtare në Të Ardhmen Tonë të Përbashkët. Raporti pohoi se zhvillimi i qëndrueshëm duhet të jetë në zemër të çdo propozimi ndërkombëtar mjedisor.

E Ardhmja jonë e Përbashkët përcaktoi zhvillimin e qëndrueshëm si “zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre”. Përfaqësues nga 172 kombe u takuan në Rio de Janeiro, Brazil, në Qershor 1992 për Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (UNCED), e quajtur gjithashtu



Samiti i Tokës 1992. Samiti prodhoi Deklaratën e Rio për Mjedisin dhe Zhvillimin, Agjenda 21, dhe Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës (UNFCCC). Këto dokumente vazhdojnë të formojnë veprimin ndërkombëtar për çështje mjedisore. Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e kombeve në fushat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Deklarata e Rios thotë se kombet kanë të drejtë të përdorin burime natyrore brenda kufijve të tyre për sa kohë që veprimet e tyre nuk dëmtojnë mjedisin në vendet e tjera. Deklarata e Rio gjithashtu kërkon që qeveritë të zhvillojnë dhe zbatojnë plane mjedisore që ruajnë dhe mbrojnë burimet natyrore për brezat e ardhshëm. UNFCCC lufton ndryshimet globale të klimës kryesisht duke rregulluar emetimet e gazeve serrë. UNFCCC prodhoi Protokollin e Kiotos, një nga traktatet më me ndikim ndërkombëtar për të adresuar ndryshimet globale të klimës. Protokollin e Kiotos është një traktat ndërkombëtar që angazhon vendet për qëllime specifike të emetimit të gazrave serrë në mënyrë që të stabilizojnë emisione të tilla. Konferenca e Tretë e Palëve në UNFCCC miratoi Protokollin e Kiotos në 1997 dhe traktati hyri në fuqi në Shkurt 2005. Protokollin e Kiotos kërkon që vendet pjesëmarrëse të industrializuara të ulin emetimet e tyre të gazeve serë në 5% nën nivelet e 1990 deri në 2012. Në 2002, Kombet e Bashkuara zhvilluan Samitin Botëror të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm, i quajtur ndryshe Samiti i Tokës 2002, në Johannesburg, Afrika e Jugut. Samiti i Tokës 2002 u përqendrua në zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e mjedisit. Konferenca prodhoi Deklaratën e Johannesburgut për Zhvillimin e Qëndrueshëm, një marrëveshje ndërkombëtare mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Deklarata e Johannesburgut bën jehonë të propozimeve nga Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin dhe Agjendën 21.

Deklarata e Johannesburgut përmban objektiva dhe afate kohore të modifikuara për arritjen e qëllimeve të Axhendës 21. Përfaqësues të shumtë të konferencës dhe organizata mjedisore kanë kritikuar Samitin e Tokës 2002 për dështimin për të arritur suksesin e Samitit të Tokës 1992

Deklarata e Johannesburgut përmban objektiva dhe orare të modifikuara për

arritjen e qëllimeve të Axhendës 21. Përfaqësues të shumtë të konferencës dhe organizata mjedisore kanë kritikuar Samitin e Tokës 2002 për dështimin për të arritur suksesin e Samitit të Tokës 1992.

3.3 Ndikimet e të drejtës ndërkombëtare mjedisore dhe çështjet mjedisore

Shumë traktate ndërkombëtare të së drejtës mjedisore, veçanërisht ato të zhvilluara nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, flasin për ligjin mjedisor si një çështje e të drejtave të njeriut. Deklarata e Konferencës (Stokholmit), për shembull, thotë se çdo njeri ka të drejtën për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Megjithatë, pak kombe kanë një kornizë ligjore që trajton ligjin mjedisor si çështje të të drejtave të njeriut. Traktatet mjedisore shumëpalëshe, pra, marrin një qasje më praktike, rregullatorë ndaj ligjit mjedisor. Ligji mjedisor ndërkombëtar gjithashtu duhet të merret me pabarazinë ekonomike që ekziston midis kombeve.

Deklarata e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor ishte dokumenti i parë i madh ndërkombëtar që pranoi se problemet mjedisore vijnë nga ekonomitë në zhvillim dhe ato të zhvilluara. Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin dhe çdo konferencë pasuese e Kombeve të Bashkuara për mjedisin janë përpjekur të adresojnë këto burime në dukje kontradiktore të degradimit të mjedisit. Deklarata e Konferencës (Stokholm) vuri në dukje se shumica e problemeve mjedisore në ekonomitë në zhvillim ndodhin për shkak të mos zhvillimit. Varfëria në këto kombe çon në shëndet të dobët, kanalizime dhe pastrim toksik, të cilat vendosin produkte kimike të dëmshëm për njerëzit dhe kafshët në mjedis. Qeveritë me ekonomi në zhvillim gjithashtu shpesh kërkojnë avancimin e ekonomisë duke marrë parasysh pak rregullimin e mjedisit. Kombet e industrializuara kontribuojnë në problemet mjedisore përmes përparimeve teknologjike dhe mbiprodhimit industrial. Shumica e traktateve ndërkombëtare mjedisore, përfshirë Agjendën 21 dhe Protokollin e Kiotos, u bëjnë thirrje kombeve të industrializuara të mbajnë një barrë më të madhe financiare të zbatimit të kostot e mentacionit. Kjo barrë e shtuar



financiare vjen përmes mbështetjes monetare dhe teknologjike për ekonomitë në zhvillim. Në të kundërt, ekonomitë në zhvillim shpesh argumentojnë se traktatet ndërkombëtare të mjedisit kufizojnë zhvillimin e tyre ekonomik. Këto kombe vërejnë se industritë e tyre nuk lejohen të zhvillohen në të njëjtën rrugë të ndjekur nga kombet e zhvilluara.

3.4 E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit dhe Shqipëria

Në të drejtën e brendshme, parimet e përgjithshme ndërkombëtare në mbrojtje të mjedisit sanksionohen zakonisht në kushtetutë, si ligji themelor i vendit. Mbi bazën e këtyre parimeve ngrihet i gjithë kuadri ligjor i detyrueshëm për t'u zbatuar në vend. Raporti midis të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme shqiptare është përcaktuar në disa prej neneve të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Referuar nenit 5 të saj parashikon se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.” si dhe referuar nenit 122 të Kushtetutës, do të thotë që R.SH njeh dhe zbaton marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara prej saj dhe të botuara në Fletoren Zyrtare, pasi në këtë mënyrë ato bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik të vendit tonë. Traktatet në të cilat Republika e Shqipërisë është bërë palë, përfshirë ato mjedisore, janë bërë pjesë e rendit të brendshëm juridik shqiptar nëpërmjet miratimit të ligjeve prej Kuvendit të Shqipërisë. Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër një sërë detyrimesh në kuadër të traktateve të ndryshme mjedisore, duke i bërë dispozitat e tyre të detyrueshme për zbatim në territorin e saj nëpërmjet ratifikimit të tyre me ligj. Kështu p.sh, ligji nr. 8216, datë 13.5.1997, realizoi aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”; ligji nr. 8294, datë 2.3.1998, bëri ratifikimin e Konventës së Bernës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës”; ligji nr. 8556, datë 22.12.1999, realizoi aderimin në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësira serioze dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë”; ligji nr. 8672, datë 26.10.2000, bëri ratifikimin e Konventës së

Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”; ligji nr. 9021, datë 6.3.2003, realizoi aderimin në Konventën “Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”; ligji nr. 10277, datë 13.5.2010, realizoi aderimin në Konventën e Roterdamit “Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare”, etj.

3.5 Konventat ndërkombëtare

Instrumentet ndërkombëtare mjedisore gjithashtu theksojnë rëndësinë e ofrimit të informacionit mjedisor për publikun. Shembujt përfshijnë:

Parimi 10 i Deklaratës së Rios thotë: “Në nivelin kombëtar, çdo individ do të ketë aksesin e duhur në informacionin në lidhje me mjedisin që mbahet nga autoritetet publike, përfshirë informacionin mbi materialet e rrezikshme dhe aktivitetet në komunitetet e tyre Shtetet do të lehtësojnë dhe inkurajojnë publikun ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja duke e bërë informacionin gjerësisht të disponueshëm.”⁵

Parimi 17 i Deklaratës së Rios thotë: “vlerësimi i ndikimit në mjedis, si një instrument kombëtar, do të ndërmerret për aktivitetet e propozuara që ka të ngjarë të kenë një ndikim të dukshëm të kundërt në mjedis dhe i nënshtrohen një vendimi të një autoriteti kombëtar kompetent.”

Konventa e Aarhus-it për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi për Çështjet Mjedisore, e cila ka shumë palë midis vendeve në Evropë dhe Azinë Qendrore, përfshin detyrime të hollësishme për sigurimin e aksesit në informacionin mjedisor.⁶

Shumë traktate të tjera shumëpalëshe mjedisore gjithashtu parashikojnë që informacioni mjedisor brenda fushës së tyre të sigurohet për publikun.

5 **UNEP Rio Principle 10;** <https://www.unep.org/civil-society-engagement/partnerships/principle-10>
6 <https://www.jus.uio.no/im/environmental.development.rio.declaration.1992/17.html>



Për efekt të këtij studimi në do të marrim në shqyrtim vetëm pesë konventa ndërkombëtare, kryesisht të lidhura ngushtë me të drejtën e publikut për një mjedis të shëndetshëm dhe ngushtësisht të lidhur me realitetin shqiptar.

3.5.1 Konventa e Aarhus-it

Konventa e Aarhus-it ka qenë në ballë në promovimin e të drejtave të Parimit 10 të Rio-s. Konventa mbetet inovative në lidhjen e saj mes të të drejtave mjedisore dhe të njeriut, detyrimi i saj për gjeneratat e ardhshme, dhe fokusi i saj në qeverisje dhe procese. U miratua më 25 qershor 1998 në Aarhus, Danimarkë dhe hyri në fuqi më 30 tetor 2001. Shqipëria e ka ratifikuar në 2000.⁷ Konteksti dhe objektivi i Konventës së Aarhus-it janë paraqitur në preambulë dhe nenet 1-3. Në veçanti, preambula thekson lidhjen midis të drejtave mjedisore dhe të njeriut dhe rëndësinë e këtyre të drejtave për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të shëndoshë mjedisor.⁸ Neni 1 përcakton objektivin e Konventës; përkatësisht, “të kontribuojnë në sigurimin e të drejtës së çdo personi të brezave të tanishëm dhe të ardhshëm për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij”, duke siguruar që Palët të garantojnë të drejtat e hyrjes. Nenet 2 dhe 3 përcaktojnë disa nga termat kryesore, siç janë “informacioni mjedisor”, “publiku” dhe “publiku i interesuar”, dhe përcaktojnë dispozitat e përgjithshme se si funksionon Konventa.

Aksesi në informacion

Aksesi në informacion qëndron si shtylla e parë. Është me vend që ajo të jetë e para në Konventë, pasi pjesëmarrja efektive e publikut në vendimmarrje varet nga informacioni gjithëpërfshirës, i saktë, i azhurnuar. Sidoqoftë, është po aq e rëndësishme në të drejtën e vet, në kuptimin që publiku mund të kërkojë qasje në informacion për ndonjë qëllim tjetër, jo vetëm për të marrë pjesë. Shtylla e aksesit në informacion është e ndarë në **qasje pasive dhe aktive**. E para ka

7 UNECE Aarhus Convention; <https://unece.org/environment-policy/public-participation/aarhus-convention/meeting-of-the-parties-introductory-page>

8 Aarhus Implementation Guide: www.unece.org/aarhus

të bëjë me të drejtën e publikut për të kërkuar informacion nga autoritetet publike dhe detyrimin e autoriteteve publike për të siguruar informacion në përgjigje të një kërkesë. Ky lloj i qasjes në informacion konsiderohet “**pasiv**”, dhe mbulohet nga neni 4. Pjesa e dytë e shtyllës së informacionit ka të bëjë me të drejtën e publikut për të marrë informacion, dhe detyrimin e autoriteteve për të mbledhur dhe shpërndajné informacione me interes publik pa pasur nevojë për një kërkesë specifike. Kjo është një qasje “**aktive**” në informacion, dhe mbulohet nga neni 5.⁹

Konventa inkurajoi palët që në mënyrë progresive të krijojnë inventarë ose regjistra të ndotjes në nenet 5 (9) dhe 10 (2) (i). Kjo është lehtësuar nga miratimi i një Protokolli në 2003.

Pjesëmarrja Publike

Shtylla e dytë e Konventës së Aarhusit është shtylla e pjesëmarrjes publike. Ajo mbështetet në dy shtyllat e tjera për efektivitetin e saj - shtylla e informacionit për të siguruar që publiku të ketë qasje në të gjitha informacionet përkatëse për të marrë pjesë në kohë dhe kuptimplotë, dhe qasja në shtyllën e drejtësisë për të siguruar që nëse të drejtat e publikut për të marrë pjesë mohohen, ata duhet të kenë qasje në procedurën e rishikimit. Konventa përcakton kërkesat minimale për pjesëmarrjen e publikut në kategori të ndryshme të vendimmarrjes në lidhje me çështjet mjedisore: në lidhje me projekte ose aktivitete specifike (neni 6 dhe shtojca I); programet, planet dhe politikat (neni 7); dhe rregulloret ekzekutive dhe rregullat e zbatueshme ligjërishit përgjithësisht të zbatueshme (neni 8).¹⁰

Kategoria e parë ka të bëjë me pjesëmarrjen nga anëtarët e publikut që mund të preken nga, ose interesohen ndryshe, nga vendimmarrja për një aktivitet specifik dhe mbulohet nga neni 6. Neni 6 detajon kërkesat për pjesëmarrjen e publikut në vendimet për të lejuar ndonjë të aktiviteteve të renditura në Shtojcën I të Konventës. Përveç aktiviteteve specifike të renditura në Shtojcë, ai gjithashtu përfshin çdo aktivitet që i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në

⁹ *Implementation Guide*, p. 75-117.

¹⁰ *Ibid.* fq.119-185



mjedis me pjesëmarrjen e publikut sipas ligjit kombëtar.

Neni 6 gjithashtu kërkon që detyrimet e tij të pjesëmarrjes publike të zbatohen, kur është e përshtatshme, kur kushtet e funksionimit për një aktivitet të Aneksit i rishikohen ose azhurnohen ose kur një ndryshim ose zgjerim i një aktiviteti të Aneksit i plotëson pragjet e asaj aneksi. Përfundimisht, neni 6 parashikon që Palët mund të vendosin vetë të zbatojnë dispozitat e tij për vendimet për aktivitete të tjera që nuk renditen në aneksin 1, të cilat mund të kenë një efekt të rëndësishëm në mjedis. Neni 6 imponon detyrime të qarta hap pas hapi për Palët se si të kryejnë një procedurë efektive të pjesëmarrjes publike (shih më poshtë modelin e pjesëmarrjes publike).

Pjesëmarrja e publikut ndahet në tre pjesë:

- a. vendimmarrja për një aktivitet specifik (neni 6);
- b. zhvillimin e planeve, programeve dhe politikave (neni 7);
- c. dhe përgatitjen e ligjeve, rregullave, dhe normat ligjërish të detyrueshme (neni 8).

Kërkesat minimale për pjesëmarrje sipas Konventës janë përmbledhur në “shtatë” hapa të njohur gjerësisht si një pikë referimi ndërkombëtare.

Modeli me shtatë hapa liston:

1. Njoftim
2. Pjesëmarrja e hershme
3. Qasja në informacionin e nevojshëm
4. Mundësi për të komentuar
5. Llogarinë e duhur të pjesëmarrjes
6. Njoftimi i shpejtë për vendimin e marrë
7. Përsërit sa herë të jetë e nevojshme

Takimi i Palëve miratoi një sërë udhëzimesh (Udhëzimet Lucca) dhe një ndryshim (OMGJ ose Almaty) ende jo në fuqi) për t’u marrë me zbatimin e

Konventës për OMGJ-të.

Rekomandimet e Mastrihtit janë përgatitur nga Task Forca për Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje për të siguruar udhëzime praktike për zbatimin e shtyllës së pjesëmarrjes.¹¹ Rekomandimet e Mastrihtit mbi Nxjitjen e Pjesëmarrjes Efektive Publike në Vendimmarrjen në Çështjet Mjedisore (Rekomandimet e Mastrihtit) bazohen në praktikën e mirë ekzistuese dhe synojnë si një mjet praktik për të ndihmuar zyrtarët publikë në baza ditore kur hartojnë dhe kryejnë procedurat e pjesëmarrjes publike për vendimmarrjen në lidhje me çështjet mjedisore në lidhje me projektet, politikat, planet, programet dhe legjislacionin në lidhje me një gamë të gjerë aktiviteteve që mund të kenë ndikim në mjedis, shëndetin e njeriut dhe mirëqenien. Rekomandimet mund të jenë me vlerë për anëtarët e publikut, përfshirë OJQ-të dhe sektorin privat, të përfshirë në vendimmarrje për çështjet mjedisore.

Akseset në drejtësi

Shtylla e tretë e Konventës së Aarhusit është akseset në drejtësi, i paraqitur në Nenin 9. Akseset në drejtësi ndihmon në zbatimin e shtyllës së informacionit (veçanërisht Nenin 4 në lidhje me kërkesat e informacionit) dhe shtyllën e pjesëmarrjes së publikut (veçanërisht Nenin 6 mbi pjesëmarrjen e publikut në vendime mbi aktivitetet specifike) në sistemet e brendshme ligjore, si dhe çdo dispozitë tjetër e Konventës që Palët specifikojnë në ligjin e tyre të brendshëm për t'u zbatuar në këtë mënyrë. Qasja në shtyllën e drejtësisë gjithashtu siguron një mekanizëm për publikun për të zbatuar drejtpërdrejt ligjin mjedisor.¹²

Konventa siguron të drejtën për të kundërshtuar:

- (a) refuzimin ose përgjigjet joadekuate për kërkesat informacion
- (b) ligjshmërinë e një aktiviteti specifik
- (c) veprime ose mosveprime që kundërshtojnë ligjet vendase mjedisore

Procedurat duhet të jenë të drejta, të barabarta, në kohë dhe të përballueshme.

11 Maastricht Recommendations (UNECE, 2015). 39 Quick Guide.

12 *Implementation Guide*, p. 187-207.



Aksesi në procedurat e drejtësisë duhet të jetë i drejtë, i drejtë dhe me kohë. Mjetet juridike të ofruara duhet të jenë adekuate dhe efektive dhe duhet të ketë qasje në lehtësim të detyrueshëm kur është e përshtatshme. Së fundmi, dhe më e rëndësishmja, procedurat administrative dhe gjyqësore nuk duhet të jenë aq të shtrenjta sa t'i pengojnë njerëzit të kërkojnë qasje në drejtësi.

Sinjalizuesit/mbrojtësit mjedisorë

Neni 3 (8) përcakton që Palët do të sigurojnë që personat që ushtrojnë të drejtat e tyre sipas Konventës “nuk do të penalizohen, persekutohen ose ngacmohen në asnjë mënyrë për përfshirjen e tyre”. 3 (9) Palët kanë njohur rëndësinë e krijimit të një ambienti të sigurt dhe të mundshëm për mbrojtësit e mjedisit, duke përfshirë mbrojtjen thelbësore të sinjalizueseve. Kjo u riafirmua nga Deklaratat e Mastrihtit dhe Budvës.¹³

Kuadri Institucional

Konventa e Aarhusit, në nenet 10 dhe 12, dhe përmes punës së vazhdueshme të Takimit të Palëve (MoP), ka krijuar një numër institucionesh dhe mekanizmash për t'i lejuar Palët të bëjnë bisedime dhe të punojnë së bashku për zbatimin.

Takimi i Palëve (TP) është institucioni kryesor i Konventës që mbledhet çdo tre vjet me pjesëmarrjen e gjithë palëve të konventës. Konventa e Aarhus ka 47 Palë nga të cilët edhe Bashkimi Evropian i cili e ratifikoi konventën në 17.2.2005. Në takimet e tij, nënshkruesit e tjerë dhe shtetet e tjera, si dhe organizatat ndërqeveritare dhe jo-qeveritare marrin pjesë si vëzhgues. Mandati i Takimit të Palëve është të mbajë nën shqyrtim të vazhdueshëm zbatimin e Konventës dhe të marrë masat e nevojshme të nevojshme për të arritur qëllimet e Konventës.

Sekretariati: Siç përcaktohet në Nenin 12, funksionet e Sekretariatit kryhen nga Sekretari Ekzekutiv i UNECE. Këto përfshijnë thirrjen dhe përgatitjen e

¹³ http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/mop6/HLS/ECE_MP.PP_2017_16_Add.1-ECE_MP.PRTR_2017_2_Add.1_E.pdf

TP-ve; transmetimin te Palët e raporteve dhe informacioneve të tjera të marra në përputhje me dispozitat e Konventës; dhe funksione të tjera të tilla siç përcaktohen nga Palët.

Grupi Punues i Palëve: Krijuar nga Takimi i Palëve në seancën e tij të parë, ndër të tjera, Grupi i Punës mbikëqyr zbatimin e programit të punës dhe përgatit TP; mbikëqyr dhe drejton veprimtaritë e organeve ndihmëse të krijuara nga TP-ve; mban nën shqyrtim nevojën për të ndryshuar Konventën; dhe i bën propozime dhe rekomandime TP-ve që i konsideron të nevojshme për të arritur qëllimet e Konventës.

Mekanizmi i pajtueshmërisë: Konventa ka një mekanizëm inovativ të rishikimit të pajtueshmërisë i cili lejon anëtarët e publikut, si dhe palët, të sjellin çështje në lidhje me pajtueshmërinë e një pale përpara një komiteti të veçantë të pajtueshmërisë të përbërë nga ekspertë të pavarur. Komiteti i Pajtueshmërisë, i themeluar në 2002, punon në një mënyrë jo-konfrontuese, jogjyqësore dhe konsultative, dhe siguron një ndërlidhje thelbësore midis publikut dhe Palëve. Që nga themelimi i tij, Komiteti i Përputhshmërisë ka arritur një numër gjetjesh domethënëse dhe ka qenë i dobishëm për të ndihmuar që Palët të përmbushin detyrimet e tyre dhe, kur është e nevojshme, të ndryshojnë sistemet e tyre ligjore dhe administrative.

Mekanizmi i raportimit: Konventa ka një mekanizëm unik të raportimit që parashikon një rol të fortë për publikun në përgatitjen e raporteve kombëtare mbi zbatimin e Konventës. Palët do të përgatisin raporte të tilla rregullisht për secilën sesion të Takimit të Palëve

Task Forcat: Konventa ka tre task forca të dedikuara - për aksesin në informacion, për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe për qasjen në drejtësi - të cilat punojnë posaçërisht për të përmirësuar zbatimin e secilës nga shtyllat e Konventës. Ekspertët nga qeveritë, OJQ-të, organizatat e tjera ndërkombëtare, sektori privat dhe academia të gjithë luajnë një rol aktiv në punën e task forcave. Puna e tyre drejtohet nga programet e punës të miratuara nga Ministria e Mbrotjtjes në secilën prej seancave të saj



Qendrat Aarhus: Qendrat Aarhus, të mbështetura nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), kanë qenë shumë aktive në promovimin e Konventës së Aarhusit në nivelet kombëtare dhe lokale në shumë vende, duke siguruar informacion dhe mbështetje për njerëzit për t'i ndihmuar ata kuptojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre të aksesit.¹⁴

PRTR Protokoll

Protokolli i Konventës mbi Regjistrat e Lirimit dhe Transferimit të Ndotësve (PRTR) u miratua në Konferencën e Pestë Ministrore të Mjedisit për Evropën në Kiev, Ukrainë, në maj 2003 dhe hyri në fuqi në tetor 2009.¹⁵ Objektivi i tij është të rrisë aksesin e publikut në informacion përmes institucionit të regjistrave koherentë, të shpërndarjes dhe transferimit të ndotësve në të gjithë vendin (PRTR).¹⁶ PRTR janë inventarë të ndotjes nga vendet industriale dhe burime të tjera. Protokolli është instrumenti i parë ndërkombëtarisht i detyrueshëm ligjërish për këtë temë, që angazhon Palët e tij të krijojnë PRTR që janë të arritshme për publikun dhe të mirëmbahen përmes raportimit të detyrueshëm të një game të gjerë ndotjesh nga aktivitete të caktuara me rëndësi mjedisore. Megjithatë është një Protokoll i Konventës së Aarhusit dhe vazhdon më tej qëllimin e Konventës për të promovuar aksesin e publikut në informacionin mjedisor, Protokolli është një traktat i pavarur. Ai ka organin e tij drejtues dhe është i hapur për të gjithë Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara, përfshirë ato që nuk janë anëtare të UNECE ose Palëve të Konventës së Aarhusit.

3.5.2 Konventa e Espoo-s

Konventa për vlerësimin e ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkufitar (Espoo, 1991) - Konventa 'Espoo (VNM) përcakton detyrimet e Palëve për të vlerësuar ndikimin mjedisor të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme

¹⁴ Shiko <https://aarhusclearinghouse.unece.org/national-reports>

¹⁵ UNECE PRTR Protocol; accessed on <https://prtr.unece.org>

¹⁶ UNECE PRTR Protocol; accessed on <https://prtr.unece.org>

të planifikimit.¹⁷ Ajo përcakton gjithashtu detyrimin e përgjithshëm të shteteve për të njoftuar dhe konsultuar njëri-tjetrin për të gjitha projektet kryesore në shqyrtim që ka të ngjarë të kenë një ndikim të dukshëm të pafavorshëm mjedisor përtej kufijve.¹⁸20 nene dhe 7 Shtojca Pjesëmarrja Publike

Neni 3 (8) I konventës shprehet se palët e interesuara do të sigurojnë që publiku i Palës së prekur në zonat që mund të preken të informohet dhe t'u sigurohet mundësia për të bërë komente ose kundërshtime mbi aktivitetin e propozuar dhe për transmetimin e këtyre komenteve ose kundërshtimeve ndaj autoritetit kompetent të Palës së origjinës, ose drejtpërdrejt te ky autoritet ose, kur është e përshtatshme, përmes Palës së origjinës. Organizatat publike dhe joqeveritare (OJQ-të) kanë një rol jetësor për të luajtur në zhvillimin, zbatimin dhe mbështetjen e Konventës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në një Kontekst Ndërkufitar (Konventa e VNM) dhe Protokollit të saj mbi Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (Protokolli i VSM-së).

Publiku dhe OJQ-të mund të përfshihen përmes:

- Pjesëmarrja në vlerësimin mjedisor të projekteve që kanë ndikime ndërkufitare, sipas Konventës së VNM
- Pjesëmarrja në vlerësimin mjedisor të planeve dhe programeve (dhe ndoshta politikave dhe legjislacionit), sipas Protokollit të VSM-së
- Inkurajimi i qeverisë së tyre për të ratifikuar dhe zbatuar plotësisht Konventën dhe Protokollin

Kuadri institucional




Figura 4: Kuadri institucional, Konventa e Espoo-s

17 UNECE Espoo Convention Secretariat; <https://unece.org/more-0>

18 UNECE Espoo Convention, *ibid*



Takimi i Palëve. Neni 11 i Konventës specifikon:

1. Palët do të takohen, aq sa është e mundur, në lidhje me sesionet vjetore të Këshilltarëve të Lartë të Qeverive të ECE për Problemet e Mjedisit dhe Ujit. Takimi i parë i palëve do të thirret jo më vonë se një vit nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Pas kësaj, takimet e Palëve do të mbahen në raste të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme nga një takim i Palëve, ose me kërkesë me shkrim të ndonjë Pale, me kusht që, brenda gjashtë muajve nga kërkesa që t'u komunikohet atyre nga sekretariati, ajo mbështetet nga të paktën një e treta e Palëve.

2. Palët do të mbajnë nën shqyrtim të vazhdueshëm zbatimin e kësaj Konvente dhe, duke pasur parasysh këtë qëllim, do të:

- a) Rishikojnë politikat dhe qasjet metodologjike të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga Palët me synimin për të përmirësuar më tej procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkuftar.
- b) Shkëmbimi i informacionit në lidhje me përvojën e fituar në lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale ose rregullime të tjera në lidhje me përdorimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkuftar në të cilin një ose më shumë palë janë palë.
- c) Të kërkojë, kur është e përshtatshme, shërbimet e organeve kompetente ndërkombëtare dhe komiteteve shkencore në aspektet metodologjike dhe teknike që kanë të bëjnë me arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente.
- d) Në takimin e tyre të parë, merrni parasysh dhe miratoni me konsensus rregullat e procedurës për takimet e tyre.
- e) Merr në konsideratë dhe, kur është e nevojshme, miraton propozime për ndryshime në këtë Konventë.
- f) Merrni parasysh dhe ndërmerrni çdo veprim shtesë që mund të kërkojë për arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente.

Komiteti i Zbatimit: u krijua nga Takimi i Palëve në Shkurt 2001. Qëllimi i Komitetit është të rishikojë pajtueshmërinë e Palëve me detyrimet e tyre sipas

Konventës, me qëllim që t'i ndihmojë plotësisht për të përmbushur zotimet e tyre. Komiteti u krijua nga Takimi i Palëve në Shkurt 2001 (vendimi II / 4 i Takimit të dytë të Palëve, i rishikuar si vendimi III / 2, i cili siguron strukturën dhe funksionet e Komitetit të Zbatimit dhe procedurat për rishikimin e pajtueshmërisë). Komiteti përbëhet nga tetë anëtarë, të emëruar nga Palët që, nga ana tjetër, zgjidhen nga Takimi i Palëve. Alternuesit zgjidhen për çështjet e Protokollit.¹⁹

Komisioni hetimor: Neni 3 dhe Shtojca IV e Konventës Espoo-së sigurojnë një procedurë hetimi. Gjithashtu e rëndësishme është paragrafi 15 i shtojcës së vendimit III / 2 ("Kur një çështje është duke u shqyrtuar nën një procedurë hetimi sipas Nenit 3, paragrafi 7, i Konventës, ajo çështje nuk mund të jetë subjekt i një paraqitje sipas këtij vendimi. ").

Zbatimi dhe përputhshmëria

Komiteti hap një çështje në 2 raste:

- Nëse një shtet hap një çështje për mos-përputhshmëri të palës tjetër
- Merr një nismë vetë kur njoftohet për raste mos-pajtueshmërie

Rasti I dytë aplikohet për OJQ/publikun dhe mund të dërgohet një ankimim (që në fakt quhet informim) sipas një modeli të gatshëm që gjindet në faqen e Konventës.

3.5.3 Konventa e Helsinkit

Qëllimi i Konventës

Konventa e Helsinkit është nënshkruar në Helsinki në 1992 dhe ka hyrë në fuqi në 1996. Në vitin 2003 janë bërë amendamente që kanë mundësuar aksesimin e gjithë anëtarëve të Shteteve të Kombeve të Bashkuara dhe nga 2006 është hapur për aksesim nga gjitha shtetet e UN.

¹⁹ <https://unece.org/environment-policy/environmental-assessment/procedures>



Konventa numëron 41 Palë ose vende anëtare. “Ujërat ndërkufitare” (neni 1 (1)) - Ujërat sipërfaqësorë ose nëntokësorë që shënojnë, kalojnë ose ndodhen në kufij midis dy ose më shumë shtetesh (neni 1 (1). Zhvillimi i politikave, programeve dhe strategjive të harmonizuara që mbulojnë zonat përkatëse të pellgut ujëmbledhës (neni 2 (6))

Komiteti i Zbatueshmërisë

Themeluar në 2012 për parandalimin e mosmarrëveshjeve dhe ndihmë praktike të orientuar nga çështjet. 9 anëtarë në aftësi personale, avokatë dhe profesionistë të shquar të ujit, të zgjedhur nga Takimi i Palëve midis kandidatëve. Takohet dy herë në vit në mënyrë të hapur, publike dhe transparente. Procedurat (procedura këshilluese, iniciativa e Komitetit dhe të tjera). Masat (plani kombëtar i zbatimit, marrëveshja ndërkufitare e ujit, ndërtimi i kapaciteteve, lehtësimi i ndihmës teknike), mund të rekomandojnë masa më të forta për Takimin e Palëve.

3.5.4 Konventa e Bazelit

Përmbledhje e përgjithshme

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme ka qenë në programin ndërkombëtar të mjedisit nga fillimi i viteve 1980, kur u përfshi si një nga tre zonat me përparësi në Programin e parë të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) Montevideo për Ligjin Mjedisor në 1981.

Konventa e Bazelit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre (më tej referuar si “Konventa e Bazelit”) u miratua në 1989 pasi u negociua në fund të viteve 1980. Konventa hyri në fuqi në 1992. Objektivi kryesor i Konventës së Bazelit është të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga efektet e pafavorshme të mbetjeve të rrezikshme.

Mbetjet e rrezikshme nuk mund të eksportohen në Antarktidë, në një shtet jo-palë në Konventën e Bazelit, ose në një palë që ka ndaluar importin e

mbetjeje të rrezikshme. Sidoqoftë, palët mund të hyjnë në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe për administrimin e mbetjeje të rrezikshme me palë të tjera ose me jo-palë, me kusht që marrëveshje të tilla të jenë “jo më pak të shëndetshme për mjedisin” sesa Konventa e Bazelit. Kur lëvizja ndërkufitare, në parim, nuk është e ndaluar, ajo mund të ndodhë vetëm nëse përfaqëson një zgjidhje të shëndoshë për mjedisin, nëse respektohen parimet e menaxhimit të shëndoshë mjedisor dhe mosdiskriminimi dhe nëse kryhet në përputhje me sistemin rregullator të Konventës .

Mekanizmi i Zbatimit

Komiteti i Zbatueshmërisë dhe Përputhshmërisë

- Krijuar në 2002
- Qëllimi është të ndihmojë Palët të respektojnë detyrimet e tyre sipas Konventës, dhe të lehtësojë, promovojë, monitorojë dhe sigurojë zbatimin dhe përputhshmërinë me detyrimet sipas Konventës.

Ka një mandat të dyfishtë:

- Rishikim të çështjeve të përgjithshme të zbatimit P.sh. Raportimi, kuadri ligjor
- Aplikime specifike të palëve që hasin vështirësi në zbatim dhe përputhshmëri

Komiteti ka 15 anëtarë të emëruar nga palët me përfaqësim të pashuar sipas 5 rajoneve Gjeografike të UN.

- Zgjidhen deri në 2 mandate me nga 5 vjet
- Vendimarrja 2/3 pra 8 anëtarë
- Nëse s’ka konsensus atëherë gjithë mendimet e anëtarëve reflektohen në vendim



Pjesëmarrja e Publikut

Pjesëmarrja e OJQ ose rrjeteve të tjera pranë Konventës është vetëm në formën e vëzhguesit. Nevojitet dorëzimi i aplikimit si vëzhgues dhe informacion për profilin dhe ekspertizën në objektin e Konventës.

Shqipëria iu bashkua Konventës në 1999 përmes Ligjit nr. 8216, datë 13.5.1997 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit. Importi i çdo lloj mbetje vazhdon të jetë i ndaluar sipas Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Nr. 10463/2011. Një ndryshim i Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Nr. 10463/2011, i cili do të lejonte importin e mbeturinave për qëllime riciklimi ka pritur për shqyrtim të duhur nga parlamenti gjatë dy viteve të fundit.

3.5.5 Konventa e Bernës

Qëllimi dhe përmbledhje

Konventa e Bernës është i vetmi Traktat për ruajtjen e natyrës në Evropë. është themeluar nga Këshilli i Evropës në 1979 dhe është nënshkruar nga Bashkimi Evropian dhe 50 vende që janë të angazhuara për të mbrojtur jetën e egër, si speciet ashtu edhe habitatet e tyre.

Institucionet e Konventës së Bernës

Komiteti i Përhershëm. Ai përfshin të gjitha Palët Kontraktuese, si dhe shtetet dhe organizatat vëzhguese, qeveritare dhe jo-qeveritare, në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Takohet çdo vit në mjediset e Këshillit të Evropës në Strasburg. Komiteti i Përhershëm miraton rekomandime në lidhje me masat që duhet të merren për të arritur objektivat e Konventës dhe për të përmirësuar efektivitetin e saj. Ajo gjithashtu monitoron zbatimin e Konventës dhe ofron udhëzime për zhvillimin e mëtejshëm të saj.

Byroja. Byroja e Komitetit të Përhershëm merr vendime administrative dhe

organizative ndërmjet mbledhjeve të Komitetit të Përhershëm. Ai përfshin Kryesuesin e Komitetit të Përhershëm, Zëvendëskryetarin, Kryesuesin e mëparshëm dhe dy anëtarë shtesë të Byrosë, dhe ndihmohet nga Sekretariati. Raportet e takimeve të Byrosë u vihen në dispozicion Palëve dhe vëzhguesve.

Sekretariati i Konventës së Bernës sigurohet nga Këshilli i Evropës dhe siguron shërbime administrative dhe të tjera që mund të kërkojnë nga Komiteti i Përhershëm. Sekretariati është gjithashtu përgjegjës për thirrjen e takimeve dhe përgatitjen dhe qarkullimin e të gjitha dokumenteve dhe raporteve që duhet të shqyrtohen nga Komiteti i Përhershëm dhe Byroja e tij, si dhe nga Grupet e Ekspertëve dhe grupet e punës ad hoc të krijuara sipas Konventës.

Zbatueshmëria dhe rastet a ankimimeve

Sistemi i shkresave të çështjeve, që daton që nga viti 1984, është një mjet unik monitorimi i bazuar në ankesa për shkelje të mundshme të Konventës që mund të paraqiten nga OJQ-të apo edhe qytetarë privatë. Ankesat e marra në këtë mënyrë përpunohen nga Sekretariati, Byroja dhe, kur është veçanërisht e rëndësishme, gjithashtu nga Komiteti i Përhershëm, në përputhje me meritat e tyre dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Kur Komiteti i Përhershëm ose Byroja e tij vlerëson se nevojiten informacione të mëtejshme, ata mund të rregullojnë vizitat në vend nga ekspertë të pavarur, të cilët raportojnë tek Komiteti i Përhershëm. Komiteti i Përhershëm mund të rishikojë zbatimin e Konventës në një palë kontraktuese duke analizuar raportet ligjore dhe të politikave të përgatitura nga ekspertë të pavarur.

3.5.6 Mekanizmat e zbatueshmërisë së Konventave

Efektiviteti i zbatueshmërisë së konventave (MEA -ve) mund të kuptohet dhe matet në mënyra të ndryshme. Në përgjithësi, mund të bëhet dallimi midis efektivitetit juridik, politik dhe zgjidhjes së problemeve të mjedisit. Efektiviteti ligjor natyrisht i referohet pajtueshmërisë ligjore me detyrimet e prezantuara nga një MEA, dhe shoqërohet me efektivitetin e sjelljes në përmbushjen e



këtyre detyrimeve. Efektiviteti politik i MEA -ve matet nga pranimi dhe pjesëmarrja e shtetit në angazhimet ligjore. Megjithatë, efektiviteti politik ka të bëjë kryesisht me gjerësinë e bashkëpunimit të mjedisit ndërkombëtar midis shteteve, por jo thellësinë e atij bashkëpunimi. Koncepti i efektivitetit mjedisor kërkon, pjesërisht, t'i përgjigjet kësaj të fundit duke u përqendruar në fuqinë e angazhimeve shtetërore dhe aftësinë e tyre për të zbutur problemin mjedisor në fjalë.

Ky aspekt shoqërohet më pas me nivelet e pjesëmarrjes së shtetit në pajtueshmërinë me MEA -të përkatëse. Duhet të theksohet se ka edhe qasje më të reja për të kuptuar efektivitetin e ligjit mjedisor ndërkombëtar, dhe MEA -ve më konkretisht. Qasje të tilla fokusohen, ndër të tjera, në natyrën dhe problemet që trajtojnë angazhimet juridike ndërkombëtare, mbi rolin e faktorëve ekzogjene (siç është politika e fuqisë) në përcaktimin e efektivitetit të tyre, ose në ndikimet e infrastrukturës së mjedisit rregullator brenda këtij konteksti.

Ndërsa në përgjithësi mund të përmblihet se sa më shumë që shtetet përpiqen me mirëbesim të respektojnë angazhimet e tyre ndërkombëtare, gjithnjë ka arsye që shtetet të mos respektojnë detyrimet e veçanta. Si përgjigje, ekzistojnë dy qasje themelore ligjore për të përmirësuar pajtueshmërinë me të drejtën ndërkombëtare (mjedisore): ato që janë lehtësuese/menaxheriale dhe ato që kanë më shumë natyrë ndëshkimore/zbatuese.

E para e konsideron mos pajtueshmërinë si rezultat kryesisht nga kufizimet e kapaciteteve nga ana e shteteve, ndërsa kjo e fundit i sheh problemet e pajtueshmërisë si rezultat i një analize kosto-përfitim ku *kostot e pajtueshmërisë kanë tejkaluar përfitimet e tyre. Rrjedhimisht, qasja fokusohet në inkurajimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit duke hequr barrierat për bashkëpunim efektiv përmes asistencës dhe menaxhimit të planeve të pajtueshmërisë. Në të kundërt, qasja e zbatimit thekson detyrimet ligjore, detyruese, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe (kërcënimin) e sanksioneve. Në praktikë, të dyja qasjet janë mbështetur nga shumë regjime mjedisore shumëpalëshe. Nëse qasja e (mos) pajtueshmërisë është më shumë në natyrë politike ose juridike, lehtësuese*

ose kundërshtuese, varet nga Palët, nga kuadri ligjor dhe institucional për bashkëpunimin e shteteve, dhe nga mekanizmat specifike të pajtueshmërisë që janë krijuar sipas një regjim traktati ose konvente.

Arsyet e mos përputhshmërisë së shteteve	Shkolla e forcimit	Shkolla Menaxheriale	Legjitimiteti
	Kostot i kalojnë përfitimet Mungesa e sanksioneve	Mungesë kapaciteti Kohë e pakët Ambiguitet i normave	Normat konsiderohen ambige ose të padrejta

Tabela 1: Arsyet e mos-zbatueshmërisë së konventave nga shtetet

3.5.7 Ndërveprimi i konventave

Sipas UNEP ekzistojnë një numër shumë i lartë marrëveshjes ndërkombëtare mjedisore (është vlerësuar se ka 700 ose më shumë marrëveshje ndërkombëtare mjedisore) që merren me aspekte të ndryshme të mjedisit. Dhe ndërkohë, të tjera janë duke u negociuar në nivelet dypalëshe, rajonale dhe globale.

Ndërsa këto marrëveshje të shumta mjedisore janë në fuqi, bota vazhdon të dëshmojë nivele të larta të degradimit të biodiversitetit, kërcënimeve të zhdukjes së specieve të egra në natyrë, shfrytëzimit ilegal dhe tregtisë së kafshëve të egra dhe produkteve të kafshëve të egra, ndryshimi i klimës dhe ndotja e mjedisit. Është e qartë se shpejtësia me të cilën marrëveshjet mjedisore po zhvillohen nuk përputhet ende me shpejtësinë e tyre në trajtimin e problemeve gjithnjë e në rritje mjedisore për të cilat ato janë krijuar. Pavarësisht përpjekjeve që po bëhen, dhe zhvillimit të jashtëzakonshëm të marrëveshjeve mjedisore dhe ndikimit me vlerë të tyre, zbatimi mbetet një sfidë e madhe për bashkësinë ndërkombëtare, dhe është kërcënim për të përmbushur nevojat e brezave të tanishëm dhe për të kënaqur shpresat e brezave të ardhshëm. Në këtë kontekst,



ndërveprimi i konventave mes tyre është thelbësor pasi ndihmon në zbatimin dhe plotësimin e njëra tjetrës.

Në kuadër të studimit të ndërmarrë nga EcoAlbania ndërveprimi mes pesë konventave (Aarhus, Espoo, Helsinki, Bazeli-it dhe Bernës) është i domosdoshëm në rolin që ato i japin pjesëmarrjes publike dhe garantimit të demokracisë mjedisore. (Shih tabelën 2 më sipër). Të gjitha konventat në fjalë kanë mekanizmat e zbatueshmërisë ku Aarhus dhe Espoo janë jo detyruese ndërsa Helsinki, Bazeli-i dhe Berna kanë mekanizma detyruese. Por, Konventa e Aarhusit dhe Espoo-s mund të shikohen së shumti si konventa horizontale të cilat mundësojnë zbatimin e konventave të tjera përmes rolit të fortë të pjesëmarrjes publike, aksesit në drejtësi.

KONVENTAT	ARHUS	ESPOO	HELSINKI	BASEL	BERN
Aksesi në informacion	Neni 4,5	Neni 3	Neni 13,16	Neni3,5,13	Neni 14
Pjesmarrije Publike	Neni 6, 7	Neni 3,4,5,6	Neni 10	-	-
Aksesi në Drejtsi	Neni 9	-	-	-	-
Ankimuesit	Shtetet, OJQ,Qytetarë	Shtetet, OJQ	Shtetet	Shtetet	Shtetet, OJQ,Qytetarë
Forcimi i zbatimit	Komiteti i Zbatueshmërisë	Komiteti i zbatimit	-	Komiteti i Zbatueshmërisë	Sistemi i ankimimit të rasteve
Institucioni	Komiteti i Zbatueshmërisë	Komisioni i Hetimit	Thjeshtë jo konfrontues, transparent mbështetës dhe bahkëpunues	Komiteti i Zbatueshmërisë	Bureau, Sekretariati, Komiteti i përherëshëm
	Jo detyruese	Jo detyruese	Detyruese	Detyruese	Detyruese

Tabela 2: Paraqitja tabelare e ndërveprimit të konventave



KAPITULLI 4





KAPITULLI IV: LEGJISLACIONI MJEDISOR I BE-SË

4.1 E Drejta Mjedisore e BE-së

4.1.1 Acquis Communautaire, Kapitulli 27 ``Mjedisi``, Direktivat e Be-së dhe Shqipëria

Në kuadër të së drejtës së BE, çështjet e mjedisit hyjnë në kompetencat e përbashkëta ndërmjet BE dhe shteteve anëtare, ku janë shtetet anëtare ato të cilat do t'i ushtrojnë kompetencat e tyre nëse ato nuk ushtrohen prej vetë BE. Këtu hyjnë ndër të tjera: mjedisi, bujqësia dhe peshkimi, me përjashtim të ruajtjes së burimeve biologjike detare, energjisë, etj. Për herë të parë, mjedisi u përfshi ndër çështjet e kompetencës së BE në Aktin Unik Evropian. Traktati i Mastroiit (1993) e zyrtarizoi mjedisin një fushë prioritare të BE-së, të ndërlidhur me zhvillimi politik dhe social.

“**Acquis Communautaire**” përfshin të gjitha traktatet, të gjithë legjislacionin e BE-së të vlefshme sot, të gjitha vendimet e Gjykatës së BE-së, të gjitha llojet e vendimeve që dalin nga dispozitat e Marrëveshjeve të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë, Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme të Traktateve, si dhe të ashtuquajturit ligj i butë. Të gjitha shtetet anëtare dhe qytetarët e tyre duhet t'i binden Acquis dhe të gjitha vendet kandidate duhet të pranojnë Acquis të plotë për t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian. Trupi i plotë i Acquis-it të BE-së përbëhet nga më shumë se 108,000 dokumente. Acquis i plotë është i vështirë për t'u definuar/ përkufizuar. Ajo mund të përshkruhet si korpusi i përgjithshëm i së drejtës së Bashkimit Evropian i zbatueshëm në BE. Acquis përfshin aktet e BE-së si Direktiva e BE-së, Vendimet dhe Rregulloret.

Direktivat e BE-së janë një formë e legjislacionit që “drejtohet” për Shtetet Anëtare. Direktiva përcakton objektivin ose politikën që duhet të arrihet, por u lihet autoriteteve kombëtare zgjedhjen e formës dhe metodave të kontrollit. Direktivat shërbejnë për t'u afruar dhe jo për një përafrim të plotë të së drejtës së brendshme të shteteve anëtare.

Rregulloret - akte të zbatimit të përgjithshëm që janë plotësisht të detyrueshme dhe të zbatueshme drejtpërsëdrejti në shtetet anëtare - për të unifikuar ligjin e shteteve anëtare. Rregulloret nuk janë të inkorporuar në ligjin kombëtar, por ato zbatohen drejtpërdrejtë si rregulla evropiane bazuar në botimin e saj në Gazetën Zyrtare të BE-së. Rregulloret zëvendësojnë normat ligjore kombëtare, shteteve u kërkohet të heqin normat ekzistuese të sistemit të saj ligjor që bien ndesh me rregulloret. Objektivi kryesor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në BE dhe në funksion të të gjithë procesit të integritimit evropian, i njëjti raport duhet të ekzistojë edhe midis *Acquis Communautaire* dhe të drejtës së brendshme shqiptare. Aktualisht, Republika e Shqipërisë ka statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, e në këtë stad të integritimit, një dokument themelor është Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA), e nënshkruar në 12 qershor 2006 dhe që ka hyrë në fuqi në 1 prill 2009. Hartimi i një plani për përafrimin e “acquis” ka nisur në shtator 2007, me miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) është një dokument i qeverisë shqiptare, i cili përgatitet në kuadër të procesit të integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Aii përfshin aktet ligjore të parashikuara për t’u miratuar nga institucionet shqiptare për një periudhë 3-vjeçare. Këto akte përafrojnë direktiva dhe rregullore të BE-së si dhe standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Aktet ligjore të parashikuara për përafrim janë të ndara në 33 kapituj të “acquis”, ku secili kapitull trajton një fushë të caktuar të politikës së BE-së. Politikat e BE-së për mjedisin kanë si qëllim që të promovojnë ndërmarrjen e veprimeve më të forta ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe mbrojtjes së mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen mbi integritimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së, veprimet parandaluese, parimin ndotësi paguan, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim dhe ndarjen e përgjegjëseve. Legjislacioni mjedisor i BE-së përfshin dispozita që trajtojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndryshimet klimatike, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, organizmat e modifikuara gjenetikut,



kimikatat, zhurmat dhe pyjet dhe janë pjese e Kapitullit 27.

Direktivat e BE-së.




Figura 5: Paraqitja në formë skematike e legjislacionit mjedisore të BE-së: A) - Legjislacioni Horizontal, B) - Legjislacioni Vertikal

4.2 Legjislacioni Horizontal i BE-së

Legjislacioni horizontal është një kuadër ligjor që përfshin tre direktivat të BE, Direktiva e Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM), (2011/92 / BE), Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) (2001/42 / EC) dhe Direktiva e Informacionit Mjedisor (2003/4 / EC).

Direktiva 2001/42/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”, Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 197, datë 21.7.2001, është përafuar plotësisht me Ligjin shqiptar “**Ligj Nr. 91/2013 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor** ” Procesi i VSM, në vendim-marrje ndërmerret shumë më herët se sa VNM, dhe si e tillë është parë si mjeti kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm.

4.2.1 Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor 2001/42/EC “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”

Qëllimi i kësaj Direktive është që të siguroj që pasojat mjedisore të planeve dhe programeve të cilat pritet të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin janë identifikuar dhe vlerësuar gjatë përgatitjes së tyre dhe para aprovimit. Publiku dhe autoritetet mjedisore mund të japin mendimin e tyre dhe të gjitha rezultatet të integrohet dhe të merren në konsideratë gjatë procedurës së planifikimit. Pas aprovimit të planit dhe programit publiku duhet të informohet me vendimin dhe mënyrën se si ai është sjellë. Në raste të ndikimeve ndërkufitare, shteti anëtar i prekur dhe publiku i tij informohen dhe kanë mundësinë e bërjes së komenteve të cilat gjithashtu integrohen në procesin e vendimmarrjes. VSM kontribuon në planifikimin më transparent duke involvuar publikun dhe integruar konsideratat mjedisore, që është një nga synimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Direktiva ka 15 nene dhe 2 shtojca: Shtojca I- përmban informacionet e kërkuara sipas nenit 5 respektivisht në Raportin Mjedisor. Shtojca II- që përcakton kriteret për përcaktimin e domethënies së mundshme të efekteve të parashikuara në neni 3 pika 5. Kjo direktive zbatohet për një sërë planesh programeve publike si bujqësinë, pyjet, peshkimin, energjinë, industrinë, industrinë minerare, transportin, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionin turizmin.

4.2.2 Direktivat e BE-s për VNM “Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuar publike ose private në mjedis”

Komisioni Evropian, çështjen e adresimit të VNM e ka ngritur në Programin e dytë të Veprimit Mjedisor në vitin 1977. Edhe pse e iniciuar mjaft herët, pati kundërshtime të shumta. Komisioni kështu ndërmjet viteve 1977-1980 prodhoi rreth 20 drafte interne para se formalisht ta propozoj Direktivën me 1980. 11.1. Direktiva 85/337/EEC Direktiva 85/337/EEC16 mbi vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuar publike ose private në mjedis është sjellë me 1985 dhe ndryshuar me 1997. Direktiva mishëron qasjen parandaluese të



mbrojtjes së mjedisit duke kërkuar që para se organi qeveritar të jep pëlqimin në projekt, të bëhet një identifikim dhe vlerësim i efekteve potenciale të atij projekti në mjedis.

VNM do të identifikojë, përshkruajë dhe vlerësojë në mënyrën e duhur, në kuadrin e çdo rasti individual, dhe në përputhje me nenet 4 dhe 11, efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të një projekti mbi bazën e faktorëve të mëposhtëm:

- Qeniet njerëzore, fauna dhe flora
- Toka, uji, ajri, klima dhe terreni
- Asetet materiale dhe trashëgimia kulturore
- Ndërthurjen ndërmjet faktorëve që përmenden në pikën 1,2 dhe 3

Direktiva definon kategoritë e projekteve që janë subjekt i VNM-s, cilat procedura duhet ndjekur dhe përmbajtjen e vlerësimit. Kjo direktive u amendua nga Direktiva 97/11/EC Direktiva e re vendosi disa ndryshime procedurale si: - zhvilluesi i projektit mund të kërkoj autoriteti kompetent këshilla formale lidhur me fushën e informacionit që duhet mbuluar me raportin mjedisor; - autoriteti kompetent duhet bërë publik vendimin e tij nëse duhet ose jo VNM duke u bazuar në mendimin e përzgjedhjes; - në raportin e VNM duhet përfshirë plani i alternativave kryesore të studiara nga zhvilluesi dhe një indikacion për zgjedhjen e zhvilluesit. Direktiva gjithashtu vendos kriteret e përzgjedhjes për marrjen e vendimit: - karakteristikat e projektit (madhësia, shfrytëzimin i resurseve natyrore, ndotja dhe bezdisja); - lokacioni i projektit (shfrytëzimi i tokës, kapacitetet rigjeneruese, dendësia e zonës etj.) - karakteristikat e ndikimeve potenciale (zgjatja, frekuenca, reversibiliteti).

4.3 Direktiva Kuadër Ujit

Direktivën 2000/60/KE - të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2000, “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën

e politikës së ujërave”. Direktiva Kuadër e Ujërave (2000/60 / EC), bazuar në parimet e menaxhimit të integruar të basenit ujore dhe pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes është marrëveshja kryesore ligjore që synon të mbrojë dhe përmirësojë cilësinë si dhe sasinë e të gjitha trupave ujorë në Basene. Kjo Direktivë është implementuar në legjislacionin brendshëm nëpërmjet Ligjit Nr11/2012.Për menaxhimin e integruar te burimeve ujore. Për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme, mbrojtjes së ujit i është kushtuar një pjesë e posaçme e *Acquis Communautaire*. Që në vitin 1979 u miratua Direktiva e Këshillit 80/68s/EEC, për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore nga ndotja prej substancave të rrezikshme, ndërsa në vitet 1992 dhe 1995 Këshilli shtroi nevojën e një programi veprimi për këtë qëllim. Më tej, në vitin 1996 Komisioni i paraqiti një propozim Parlamentit dhe Këshillit për mbrojtjen dhe administrimin e integruar të ujërave sipërfaqësore. Një ndër aktet ligjorë më të rëndësishëm të BE për mbrojtjen dhe administrimin e ujërave është Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për “Krijimin e një Kuadri Veprimi të Komunitetit në Fushën e Politikës së Ujit”, e quajtur ndryshe si Direktiva Kuadër për Ujin. Kjo direktivë ka marrë këtë emërtim për shkak se krijoi një kuadër të përgjithshëm për mbrojtjen e ujit, duke mos u kufizuar vetëm në parashikimin e masave për parandalimin e ndotjes së burimeve të ujërave apo rrjedhave të tyre, por shkoi më tej, duke hedhur bazat për një administrim të integruar të krejt baseneve ujëmbledhës, me qëllim arritjen e objektivave ekologjikë. Mbrojtja e baseneve ujëmbledhës në BE ka një rëndësi të veçantë, pasi në shtetet anëtare basenet ujëmbledhës të lumenjve, përfshirë edhe deltat e tyre pranë brigjeve të deteve, ndodhen në 110 zona të tilla, 40 prej të cilave janë të një karakteri ndërkombëtar, duke mbuluar kështu rreth 60% të territorit të BE. Këtu futen rajonet e Danubit, Baltikut, Mesdheut, Detit të Zi, etj. Direktiva Kuadër i referohet nenit 174 të Traktatit, mbi politikat e Komunitetit për mjedisin, që kanë për qëllim arritjen e objektivave për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si edhe përdorimin me efikasitet dhe në mënyrë racionale të burimeve natyrore, bazuar në parimet e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake, të ndreqjes së dëmit në vend parimin ndotësi paguan Për vendet në Bashkimin



Evropian (BE), kjo direktivë synon të mbrojë dhe përmirësojë cilësinë e ujit. Shtetet anëtare të BE mbajnë përgjegjësinë për të siguruar transpozimin e ligjit Direktivës kuadër të Ujit (WFD) në ligjin kombëtar, ku vendet anëtare raportojnë zyrtarisht dhe në mënyrë korrekte. Vendet e BE u detyruan ta përfshijnë atë në ligjin kombëtar deri në 22 dhjetor 2003. Belgjika, Franca, Italia, e vende të tjera Anëtare të Be e transpozuan në 2003 kurse vendet si Bulgaria dhe Rumania 2007. Qëllimet kryesore të Direktivës Kuadër të Ujit janë zgjerimi i fushën së mbrojtjes së ujit, ujërat sipërfaqësorë dhe ujërat nëntokësorë, monitorimi i përcaktimit të statusit të cilësisë “i mirë” për të gjitha ujërat brenda një afati të caktuar, menaxhimi i ujit bazuar në pellgjet e baseneve të lumenjve, “qasje e kombinuar” e vlerave kufitare të emetimit dhe standardeve të cilësisë, caktimi i çmimit të duhur mbi Ujin, përfshirja e qytetarit nga afër mbi çështjet kritike të cilësisë së Ujit të pijshëm dhe aktivitetet që shfrytëzojnë ujin si dhe modernizimin e legjislacionit mjedisor në mbështetje të teknologjisë inovative mbi çështjet e Ujit.

4.4 Direktivat e mbrojtjes së Natyrës.

4.4.1 Direktiva e Zogjve (2009/147 / EC) dhe Direktiva e Habitaveve (92/43 / EEC)

Në dekadat e fundit, BE ka krijuar një hapësirë gjigande prej 26.000 zonash të mbrojtura, që përfshijnë mbi 750.000 km², rreth 18% e të gjithë masës tokësore të BE, i njohur me emërtimin “Natura 2000”. Duke qenë rrjeti më i madh në botë i zonave të mbrojtura, çka tregon edhe vetë rëndësinë që BE i kushton ruajtjes së biodiversitetit. Në përputhje me këto udhëzime, duhet të identifikohen zonat e mbrojtura - veçanërisht zonat e “Natura 2000”, dhe duhet të zbatohen masat për mbrojtje për të arritur deri në krijimin e rrjetit “ Natura 2000 “. BE ka kaluar nëpër një rrugë të gjatë të krijimit të legjislacionit për mbrojtjen e natyrës në mënyrë graduale, duke patur si bazë ligjore Direktivën e Shpendëve dhe Direktivën e Habitaveve, të cilat krijuan bazën ligjore për zbatimin e politikave të BE për mbrojtjen e biodiversitetit. Si gur themeli konsiderohet Direktiva e Këshillit 79/409/EEC, datë, 2.4.1979,

e quajtur Direktiva e Shpendëve. Si shkas për miratimin e kësaj directive shërbeu fakti që të dhënat tregonin se numri i shpendëve në Evropë po pakësohej me shpejtësi, duke përbërë kështu një kërcënim serioz për ruajtjen e mjedisit natyror dhe të balancave biologjike, në kushtet kur shumica e llojeve të shpendëve në Evropë janë kryesisht shtegtarë, duke qenë trashëgimi e përbashkët dhe mbrojtja e tyre përfshin aspekte të përgjegjësisë së përbashkët dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror. Direktiva e Shpendëve gjen zbatim ndaj të gjitha llojeve të shpendëve të egër që gjenden në territoret e shteteve anëtare të BE dhe vendos detyrime ndaj tyre në lidhje me mbrojtjen, administrimin, dhe kontrollin e specieve të shpendëve dhe shfrytëzimin e tyre, të foleve dhe të habitateve të tyre. Neni 2 i direktivës kërkon prej palëve që të marrin masat e duhura për të ruajtur numrat e specieve të shpendëve në një nivel të tillë që përputhet me kërkesat ekologjike, shkencore dhe kulturore të mjedisit, duke mbajtur parasysh edhe aspektet ekonomike dhe kërkesat për aktivitete argëtuese. Në mënyrë që të përmbushen këto kërkesa, shteteve anëtare u kërkohet që të marrin masat e duhura për ruajtjen e diversitetit nëpër habitatet e shpendëve, duke krijuar zona të mbrojtura, administrimin e kujdesshëm të tyre, në përputhje me nevojat ekologjike të habitateve si brenda, ashtu edhe jashtë zonave të mbrojtura. Direktivës i bashkëlidhen edhe 5 shtojca, në të cilat renditen speciet e shpendëve që duhen vendosur nën mbrojtje, llojet e kurtheve dhe armatimeve përdorimi i të cilëve është i ndaluar, si edhe kërkesat për hartimin e listave kombëtare të shpendëve që kërcënohen nga zhdukja, duke mbajtur parasysh edhe shpërndarjen e tyre gjeografike, të specieve shtegtare dhe rrugët e tyre të shtegtitimit, së bashku me zonat ku ata ngrenë fole të për dimërim, vlerësimin e ndikimit të metodave të kapjes dhe gjuetisë së shpendëve, masat që duhen marrë për të pakësuar dëmet prej shpendëve, përcaktimin e rolit të specieve të veçanta, si tregues të ndotjes, si edhe studimin e efekteve negative të ndotjes prej kimikateve në numrin e specieve të shpendëve. Ajo ndalon shitjen, transportimin apo mbajtjen me qëllim shitjen e shpendëve që u përkasin specieve që janë listuar si të rrezikuara, si edhe vendosjen e rregullave strikte për gjuetinë e shpendëve dhe ndalimin gjatë periudhave të shumëzimit, veçanërisht të



shpendëve shtegtarë, në mënyrë që të mos kërcënohen apo rrezikohen nga zhdukja prej një aktiviteti të tillë. Të gjitha shtetet anëtare kanë detyrimin të informojnë Komisionin për të dhënat dhe masat e ndryshme, në mënyrë që t'i mundësojnë atij ndërmarrjen e iniciativave për koordinimin e veprimtarive të tyre dhe hartimin e rekomandimeve përkatëse.

4.4.2 Direktiva e Habitaveve

Pas Direktivës së Shpendëve, si guri i dytë i themelit për mbrojtjen e biodiversitetit në BE ka shërbyer Direktiva e Këshillit 92/43/EEC, datë 21.5.1992, e quajtur Direktiva e Habitaveve, e cila është amenduar në vitet 1997, 2003 dhe 2006. Synimi i saj ishte krijimi i një rrjeti ekologjik evropian zonash të veçanta të ruajtjes së biodiversitetit, duke ruajtur habitatet natyrore të florës dhe faunës, të quajtura Natura 2000, në funksion të realizimit të një prej objektivave themelorë të BE, siç përcaktohej në nenin 130r të Traktatit të BE. Sipas nenit 4 të direktivës, procesi i përcaktimit të zonave pjesë e rrjetit Natura 2000 kalon nëpër 4 faza. Në fazën e parë, shtetet anëtare hartojnë një listë të zonave të tyre, ku ndodhen habitatet e listuar në Shtojcën I dhe speciet e listuara në Shtojcën II, që ndodhen në këto zona, duke ia përcjellë këto Komisionit Evropian brenda 3 vjetëve. Prej këtej, në fazën e dytë, Komisioni, në marrëveshje me shtetet palë, harton një listë paraprake me zonat që i konsideron si të rëndësishme për Komunitetin, e cila shëndërohet në listë përfundimtare prej Komisionit. Faza 4 vazhdon me përcaktimin sa më shpejt prej shteteve anëtare të zonave të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit, e në çdo rast, brenda jo më shumë se 6 vjetëve. Kjo bëhet duke caktuar prioritetet sipas rëndësisë së këtyre zonave për ruajtjen apo rigjallërimin e habitaveve natyrore dhe duke mbajtur parasysh kërcënimet për degradimin apo shkatërrimin e zonave që janë të ekspozuara ndaj rreziqeve. Për të ruajtur larminë biologjike në Evropës, neni 6 i direktivës parashikon edhe një skemë mbrojtëse të zonave të veçanta të ruajtjes, duke kërkuar prej shteteve marrjen e masave aktive ruajtëse në rastet e problematikave që ka gjasa të shkaktojnë pasoja negative në këto zona. Si rregull, masa të tilla duhet të autorizohen

vetëm për të ruajtur integritetin e rrjetit Natura 2000. Neni 6§3 parashikon që çdo plan apo projekt që nuk është drejtpërdrejt i lidhur me një prej zonave të rrjetit, por që ka gjasa të ketë një ndikim në të, duhet të bëhet objekt i një vlerësimi të këtij ndikimi në mjedis, me synim mbrojtjen e kësaj zone. Në varësi të rezultateve të vlerësimit, autoritetet kombëtare kompetente mund ta miratojnë planin ose projektin vetëm pasi të jenë siguruar që ai nuk cenon integritetin e zonës dhe kur është rasti edhe pas marrjes së mendimit të publikut. Vetëm në raste përjashtimore të një interesi publik madhor, përfshirë ato të një natyre ekonomike apo sociale, mund të miratohen plane ose projekte që kanë ndikim në këto zona kur nuk ka asnjë alternativë tjetër. Në këto raste, shtetet duhet të marrin masa kompensuese, për të siguruar ruajtjen e integritetit të rrjetit Natura 2000.

4.5 Direktiva për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (IPPC) 2008/1 / EC

Direktiva për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (IPPC) 2008/1 / EC rregullon çështjet mbi sistemin e integruar të lejeve, parandalimin e ndotjes gjatë fazës së prodhimit (përzgjedhja e lëndëve të para, prodhimi i pastër), menaxhimi i ndotjes së shkaktuar nga procesi i prodhimit, teknikat më të mira në dispozicion (BAT)/TMD dhe pjesëmarrja e publikut. Qëllimi i kësaj Direktive është parandalimi , ulja dhe eliminimi i ndotjes aq sa është e mundur, që vjen nga veprimtaritë industriale në përputhje me parimin “ndotësi paguan” dhe me parimin e parandalimit të ndotjes. Është e nevojshme të vendoset një kuadër i përgjithshëm për kontrollin e veprimtarive kryesore industriale, duke i dhënë përparësi ndërhyrjes në burim, garantimit të menaxhimit të kujdesshëm të burimeve natyrore, dhe duke marrë parasysh, kur është e nevojshme, situatën ekonomike dhe karakteristikat specifike të vendit ku kryhet veprimtaria ose aktiviteti industrial. Kjo Direktive është amenduar në vitin 2010 dhe quhet EID Directive 2010/75 datë 24 prill 2010 ``Mbi shkarkimet industriale``. Çdo instalim duhet të funksionojë vetëm nëse ka leje. Shtetet anëtare duhet të përcaktojnë qasjen për caktimin e përgjegjësisë për operatorët e instalimeve, me kusht që të



garantohet përputhshmëria me këtë direktivë. Shtetet anëtare mund të zgjedhin që t'i japin leje një operatori përgjegjës për çdo instalim, apo të specifikojnë përgjegjësitë mes operatorëve të ndryshëm të pjesëve të ndryshme të një instalimi. Kur sistemi ligjor aktual parashikon vetëm një operator përgjegjës për çdo instalim, një shtet anëtar mund të vendosë të mbajë këtë sistem. Për të lehtësuar dhënien e lejeve, shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të vendosin kërkesa në formën e rregullave të përgjithshme detyruese për disa kategori të caktuara instalimesh. Është e rëndësishme që të parandalohen aksidentet dhe incidentet dhe të kufizohen pasojat e tyre. Përgjegjësia në lidhje me pasojat mjedisore të aksidenteve dhe incidenteve është një çështje e legjislacionit përkatës kombëtar dhe sipas rastit edhe e ligjeve të tjera përkatëse të Bashkimit Evropian. Operatorët duhet të dërgojnë aplikimet për leje që përmbajnë informacionin e nevojshëm në mënyrë që autoritetet kompetente të vendosin kushtet e lejes. Në momentin e paraqitjes së aplikimit, operatorët duhet të jenë në gjendje të përdorin informacionin që rezulton nga zbatimi i Direktivës së Këshillit 85/337/KEE, datë 27 qershor 1985, “Për vlerësimin e ndikimeve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin”¹³ dhe i Direktivës së Këshillit 96/82/KE, datë 9 dhjetor 1996, “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme. Sigurimi i një niveli të lartë mbrojtjeje të mjedisit dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, nuk mund të arrihen mjaftueshëm kur shtetet anëtare veprojnë të vetme, dhe si rrjedhojë, për shkak të natyrës ndërkuftare të ndotjes nga veprimtaritë industriale, mund të arrihen më mirë në nivel Bashkimi Evropian. Bashkimi Evropian mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit²⁰, siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit për Bashkimin Evropian. Kjo direktivë respekton të drejtat themelore dhe parimet e njohura veçanërisht nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian. Në veçanti, kjo direktivë kërkon të nxisë zbatimin e nenit 37 të Kartës. Detyrimi për transpozimin e kësaj direktive në të drejtën e brendshme duhet të kufizohet në ato dispozita që përfaqësojnë një ndryshim thelbësor krahasuar me direktiva të mëparshme. Detyrimi për transpozimin e dispozitave të pandryshuara lind nga direktivat e mëparshme.

20 Subsidiariteti - është një parim i organizimit shoqëror që thotë se çështjet sociale dhe politike duhet të trajtohen në nivelin më të menjëhershëm (ose lokal) që është në përputhje me zgjidhjen e tyre.

4.6 Direktiva e Përgjegjësiave Mjedisore

Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalim dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin”. Ligji Themeltar Kombëtar “Për Mbrojtjen e Mjedisit” përafruar me Direktivën 2004/35/KE .Ligjin nr. 53/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar”. Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore hyri në fuqi në 30 Prill 2004. Shtetet Anëtare të BE kishin tre vjet për të transpozuar Direktivën në ligjin e brendshëm. Transpozimi i Direktivës, përfundoi deri në korrik 2010. Qëllimi i kësaj Direktive është të krijojë një kornizë të përgjegjësisë mjedisore bazuar në parimin “ndotësi pagan”, për të parandaluar dhe rehabilituar dëmet mjedisore. Direktiva synon të sigurojë që pasojat financiare të llojeve të caktuara të dëmit të shkaktuar në mjedis do të mbartet nga operatori ekonomik i cili e ka shkaktuar këtë dëm. Direktiva përcakton “dëm mjedisor” dëmtimin e specieve të mbrojtura dhe habitateve natyrore, Ndotjen e ujit, Ndotjen e tokës. Gjithmonë kërkohet vendosja e një lidhjeje shkakësore midis aktivitetit dhe dëmit. Personat fizikë ose juridikë të prekur dhe OJQ-të mjedisore kanë të drejtë të kërkojnë nga autoriteti kompetent të vendosë për masat përmirësuese në mjedis. Aktivitetet njerëzore mund të shkaktojnë dëme të mëdha në mjedis. Për shembull, në vitin 1998, një digë që përmbante mbeturina toksike nga një minierë shpërtheu në jug të Spanjës, duke lëshuar një valë masive llumi toksik që përfundimisht arriti në Parkun Natyror Donana. Helmoi tokën dhe ujin dhe vrau jetën e egër që ra në kontakt me të. Autoritetet Spanjolle shpenzuan më shumë se 250 milion € në operacione pastrimi, për një periudhë të gjatë kohore.

4.7 Direktivën 2008/99/EC për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal/ Direktiva e Krimit Mjedisor

Direktiva e Krimit Mjedisor ka si qëllim të kontribuojë në një mbrojtje më efektive të mjedisit dhe në zbatimin e plotë të legjislacionit ekzistues mjedisor të BE përmes ligjit penal, për të siguruar një fushë të barabartë të gjykitimit,



sanksione parandaluese dhe të forcojë sisteme të përgjithshme sanksionuese dhe efektive për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Direktiva, vendos një grup të përbashkët veprash penale që Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë në Kodin Penal që personat juridikë të marrin përgjegjësi. Kërkon që Shtetet Anëtare të nxitin përgjegjësinë penale mbi shkeljet mjedisore, përafron sanksionet penale dhe kërkon sanksione më të rrepta penale duke u kërkuar të gjitha Shteteve Anëtare të sigurojnë ndëshkime penale efektive, proporcionale dhe dekurajuese për krimet mjedisore, ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materiale në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara, transporti i mbetjeve etj.



KAPITULLI 5





KAPITULLI V: ASPEKTE PRAKTIKE TË SË DREJTËS MJEDIORE

5.1 Organizimi i rasteve studimore rreth shkeljes së të drejtës mjedisore në Shqipëri

Njerëzit shpesh kanë vlera dhe përparësi të ndryshme në lidhje me menaxhimin dhe përdorimin e një burimi natyror. Mosmarrëveshjet mbi burimet natyrore janë të zakonshme. Konfliktet të tilla ekzistojnë në një farë mase në çdo shoqëri, pavarësisht nëse pranohen publikisht ose jo. Ekzistenca e konflikteve mbi burimet natyrore nuk është domosdoshmërisht negative. Konfliktet të tilla mund të jenë të dobishme në përcaktimin e nevojave konkurruese për burime brenda komuniteteve dhe shoqërisë.

Forma dhe intensiteti i konflikteve të burimeve natyrore ndryshojnë shumë nga vendi dhe me kalimin e kohës brenda çdo vendi. Mënyrat në të cilat komunitetet dhe anëtarët e tyre reagojnë në konflikt gjithashtu ndryshojnë. Shpesh reflektojnë larminë lokale në drejtim të pasurisë materiale, statusit shoqëror dhe fuqisë. Ndonjëherë njerëzit mund të vendosin të mos e adresojnë një ankesë publikisht për shkak të frikës, mosbesimit, presionit të kolegëve, kufizimeve financiare, përjashtimit nga disa procedura të zgjidhjes së konfliktit ose për arsye strategjike.

Mungesa e mosmarrëveshjeve publike nuk do të thotë se nuk ka konflikt. Konfliktet e zhytura mund të jenë gati të shpërthejnë në çdo kohë. Në mënyrë të ngjashme, mospajtimet e “zgjidhura” mund të rishfaqen shumë kohë pas “zgjidhjes” së tyre, sepse konfliktet themelore mbeten.

Të gjitha komunitetet posedojnë mënyra për zgjidhjen ose menaxhimin e konflikteve të burimeve natyrore. Këto mjete mund të jenë të dhunshme ose paqësore, formale ose joformale, pjesëmarrëse ose kufizuese, të barabarta ose jo. Ndërsa mekanizmat specifikë mund të ndryshojnë, njerëzit zakonisht mbështeten në të njëjtat mënyra themelore procedurale për të trajtuar konfliktet si Të gjithë këta mekanizma përdoren në të paktën një ose më shumë nga rastet studimore. Në këtë kontekst, EcoAlbania zgjodhi të paraqesë disa raste studimore për të trajtuar konfliktet e burimeve natyrore në zona dhe çështje të ndryshme.




Figure 1: Përmbledhje skematike e mekanizmave për trajtimin e konfliktit.

5.2 Metoda e shtjellimit të një rasti studimor

Një rast studimi është një mjet trajnimi për të zhvilluar aftësi analitike duke nxjerrë shembuj nga jeta reale. Në rastet studimore është e rëndësishme të kuptojmë më shumë sesa thjesht çfarë ndodhi ose si ndodhi në secilin rast.

- Duhet të merrni parasysh pse ndodhi?
- Çfarë i shtyu njerëzit të zgjidhnin opsione të veçanta?
- Çfarë i motivoi ata?
- Çfarë kufizimesh perceptuan ose hasën?

Gjithsesi çdo rast studimi përqendrohet në gjashtë fushat e mëposhtme: Çështjet kryesore; Konteksti; Historiku i konfliktit; Proceset e menaxhimit të zgjidhjes së konfliktit; Rezultatet e menaxhimit; Mësimet e nxjerra.



5.3 RAST STUDIMOR 1: Ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël në lumin Cem/Cijevna, Mali i Zi.

- **Çështjet kryesore**

Çështja në fjalë lidhet me zbatimin e Konventës Espoo – për vlerësimin e ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkuftar.

Specifikisht zbatimi i nenit 2 të Konventës:

Neni 2 (2). Secila Palë do të marrë masat e nevojshme ligjore, administrative ose masa të tjera për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente. përfshirë, në lidhje me aktivitetet e propozuara të renditura në Shtojcën I që ka të ngjarë të shkaktojnë ndikime të konsiderueshme të pafavorshme ndërkuftare, vendosja e një procedure të vlerësimit të ndikimit në mjedis që lejon pjesëmarrjen e publikut dhe përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të përshkruar në Shtojcën II.

- **Konteksti**

Në dhjetor 2018, Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit të Mali-it të Zi iu adresua Sekretariatit të Konventës së Espoo-s rreth planeve të Shqipërisë për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël mbi lumin Cem

- **Historiku i konfliktit**

Si palë e Konventës për vlerësimin e ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkuftar që rregullon çështjet e njoftimit të vendeve fqinje dhe mundësitë për të marrë pjesë në shkëmbimin e informacionit në një kontekst ndërkuftar.

Në çështjet e mbrojtjes së mjedisit, Mali i Zi u informua nga media dhe organizatat joqeveritare malazeze në fund të shtatorit 2018 se Republika e Shqipërisë kishte filluar ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël në lumin Cijevna/Cem. Lumi Cem/Cijevna është një lumë ndërkuftar që kalon përmes Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Sipas këtij traktati ndërkombëtar të ratifikuar, nëse një zbatim i projektit

ka të ngjarë të shkaktojnë ndikim në mjedisin e një vendi tjetër, shkëmbimi i informacionit dhe konsultimet me vendin, mjedisi i të cilit mund të rrezikohet, do të zbatohen në përputhje me traktatin ndërkombëtar të lartpërmendur. Mali i Zi ose Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit nuk kanë marrë një njoftim nga autoriteti përkatës i Republikës së Shqipërisë në lidhje me synimin për të ndërtuar hidrocentrale të vegjël në lumin Cem.

- **Proceset e zgjidhjes së konfliktit**

Procesi i ndjekur nga palët e konfliktit ishte proceduara e këshillimit dhe negocimi i palëve duke përdorur sekretariatit e Espoo-s. Ministria e Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë i Malit të Zi adresoi letër për homologun e tij në 19.10.2018 ku i paraqitej çështja. Si rezultat janë përpiluar raporte përmblledhëse nga pala shqiptare dhe është mbajtur një takim teknik mes autoriteteve të menaxhimit të ujit në Shkodër në datën 5.02.2019. Një takim i dytë është mbajtur në Podgoricë në 19.09.2019 ku janë diskutuar aspekte e impaktit mjedisor të 5 hidrocentraleve të ndërtuara në lumin Cem.

Në Takimin e palëve të mbajtur në 2-5 shkurt 2021, përfaqësuesit e shteteve të kryesuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës së Shqipërisë, Agjencia e Burimeve Ujore, AKM dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit së bashku me homologët nga pala malazeze

- **Rezultatet emenaxhimit të konfliktit**

Procesi i ndjekur nga palët e konfliktit ishte proceduara e këshillimit dhe negocimi i palëve duke përdorur sekretariatit e Espoo-s. Ministria e Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë i Malit të Zi adresoi letër për homologun e tij në 19.10.2018 ku i paraqitej çështja. Si rezultat janë përpiluar raporte përmblledhëse nga pala shqiptare dhe është mbajtur një takim teknik mes autoriteteve të menaxhimit të ujit në Shkodër në datën 5.02.2019. Një takim i dytë është mbajtur në Podgoricë në 19.09.2019 ku janë diskutuar aspekte e impaktit mjedisor të 5 hidrocentraleve të ndërtuara në lumin Cem.

Në Takimin e palëve të mbajtur në 2-5 shkurt 2021, përfaqësuesit e shteteve të



kryesuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës së Shqipërisë, Agjencia e Burimeve Ujore, AKM dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit së bashku me homologët nga pala malazeze

- **Rezultatet e menaxhimit të konfliktit**

Shqipëria dhe Mali i Zi kanë rënë dakord të ngrenë një grup të përbashkët teknik pune mbi “Mbikëqyrjen & Vlerësimin” dhe të zhvillojnë dhe zbatojnë një protokoll shkëmbimi informacioni për të operacionalizuar bashkëpunimin e tyre në pellgun e përbashkët të lumit Cijevna / Cem. Këto janë rezultatet e konsultimeve të përbashkëta me këto dy vende të mbajtura nga Komiteti i Zbatimit në kuadrin e Konventës së UNECE mbi Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (Konventa e Ujit) më 5 shkurt 2021.²¹

- **Mësimet e nxjerra**

Procedura e Këshillimit të Konventës së Espoo-s, lehtëson zbatimin e Konventës së Ujit, në lidhje të veçantë me detyrimet për të zhvilluar konsultime, për të shkëmbyer informacion dhe të ofrojë të dhëna dhe për të kryer mbikëqyrjen dhe vlerësimin e përbashkët.

Komiteti i zbatueshmërisë është një mekanizëm efikas që shtetet mund ta përdorin për adresimin dhe zgjidhjen e konflikteve ndërkufitare që kanë të bëjnë me çështjet mjedisore.

Organizatat e Shoqërisë Civile ishin ato që iniciuan rastin pranë autoriteteve Malazeze duke shtyrë palët në negociata dhe marrëveshje për ndarje të informacionit cilësor për ndikimet e mundshme.

21 <https://unece.org/environment/press/water-conventions-implementation-committee-provides-advice-albania-and-montenegro>

5.4 RAST STUDIMOR 2: Ndërtimi i hidrocentralit të Pocemit, ne Rrjedhën e Vjosës 2016, çështja e parë gjyqësore mjedisore me paditës Komunitetin drejtuar Gjykatës Administrative

• Hyrje

Ndërtimi i hidrocentraleve, zhvillimi i projekteve infrastrukturore hidrike në vendin tonë që planifikohen të ndërtohen bien kryesisht në zona të veçanta natyrore e të mbrojtura ku potenciali hidrik është më i madh. Realizimi i këtyre projekteve mund të shkaktojë probleme të shumta mjedisore me dëmtime të imazhit natyror si dhe ndikime negative në florë dhe faunë, të cilat janë gjithmonë e më të rrezikuara. Probleme të mëdha këto projekte mund të kenë edhe në relacion me ndryshimet e rrjedhës së lumit, tharjes së tyre, erozionit, shpyllëzimit, kontaminimit të ujit dhe mos respektimi i minimumit biologjik i prurjes ujore veçanërisht gjatë sezonit të thatë.²² Shqipëria e prodhon të gjithë energjinë elektrike të saj nga hidrocentralet duke cilësuar nga viti 2017 numërohen 177 hidrocentrale të cilat janë në punë e janë licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE); 43 hidrocentrale janë në ndërtim e sipër dhe 364 të tjerë janë planifikuar nga Ministria e Energjisë.²³

Komisioni Evropian (KE) duhet të luajë një rol më të madh duke ndihmuar Shqipërinë, e cila po negocion dhe është pjesë e procesit integruar për tu bërë pjesë e BE-së. Mbështetja e KE ndihmon që vendi ynë të miratojë dhe zbatojë Direktivat Mjedisore të Bashkimit Evropian, si Direktivën Kuadër të BE-së për Ujin si dhe Direktivat për Shpendët dhe Habitatet me qëllim të përmirësimit të menaxhimit strategjik të lumenjve në nivel kombëtar dhe rajonal dhe të ndihmojë Shqipërinë të shmangi presionin e tepërt në basenet ujore e lumenj. Në përgjithësi, hidrocentralet e ndërtuara kanë nevojë, për rritjen e monitorimit të ndikimit në mjedis për të evidentuar e shkeljet flagrante.

• Analiza e konfliktit

Për të kuptuar më qartë këtë situatë do të analizojmë duke marrë si rast

²² <https://www.energy.gov/eere/water/how-hydropower-works>

²³ <https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/12/broken-rivers-AL.pdf>



studimor ``Ndërtimin e HEC Poçem-it, në grykëderdhjen e lumit Vjosë``.

“Ndërtimi i HEC Poçem-it, në grykëderdhjen e lumit Vjosë 2016”, identifikohet si rasti i pare i një çështje të mirëfilltë gjyqësore mjedisore, në historikun e çështjeve mjedisore ku komuniteti i drejtohet Gjykatës Administrative, duke ngritur padi institucioneve shtetërore dhe investitorit privat.

Në Gjykatën Administrative shkalla e parë, do të evidentohen qartazi përplasje e kuadrit kombëtar ligjor në dy drejtime atë të zhvillimit ekonomik duke rritur numrin e ndërtimit të HEC-ve dhe duke shfrytëzuar burimet hidrike për prodhimin e energjisë elektrike si dhe mbrojtjen e mjedisit njëkohësisht. Ky është procesi i parë gjyqësor ku Komuniteti fitoi në gjykatë në shkallë të parë

1- Komuniteti, e drejta e tij për t’iu drejtuar gjykatës në zbatim të Ligjit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ligjit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përafëruar me Direktivat e Be-së. Shteti shqiptar e ka ratifikuar Konventën e Aarhusit, me Ligjin 8972 date 26.10 2000 ``Për ratifikimin e Konventës për të drejtën e publikut për tu informuar, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar Gjykatës për çështjet mjedisore .

Komuniteti mund të ngre padi në lidhje me Mjedisin, në mbështetje të së drejtës që rrjedh nga Konventa e Aarhusit e ratifikuar me ligjin shqiptar, ka akses për t’iu drejtuar gjykatës si dhe mbështetur në dispozita dhe parashikime konkrete kushtetuese dhe ligjore u mbështet në nenin 116 të Kushtetutës së Rep. së Shqipërisë, ku aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë, Kushtetuta; marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; dhe ligjet.

Në përputhje me nenin 116(1)(b) të Kushtetutës së Rep. së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare, siç është konventa e Aarhusit janë akte normative që kanë fuqi në gjithë territorin shqiptar pra e drejta për t’iu drejtuar gjykatës kundër veprimeve të autoriteteve publike të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit kombëtar në lidhje me mjedisin dhe në nenin 9 pika (3)...`` të konventës së Aarhusit``, është bërë pjesë e legjislacionit shqiptar me

anë të nenit 48 pika (b) të Ligjit nr 10431 datë 09.06.2011 ``Për Mbrojtjen e Mjedisit `` i cili parashikon se publiku/ komuniteti ka të drejtën të ngre padi në gjykatë kundër autoritetit publik që ka sjellë dëme në mjedis ose rrezikon ta dëmtojë atë.

Pikërisht sa më lart, kjo analize ligjore sqaron qartazi legjitimitetin e palës paditëse në rastin tonë të ``Komunitetit `` në lidhje me çështje mjedisore.

Kjo theksohet dhe plotësohet dhe nga Ligji 10440 date 7.7.2011 ``Për Vlerësimin e ndikimit ne Mjedis, i cili në dispozitat e veta, flet për publikun e dhe e përkufizon këtë të fundit ``... Publik i prekur ose që mund ti preket , apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë dhe OJF-të mjedisore që shprehin interes``.

Pra çështja e ndërtimit të Hec Pocemit është një nga çështjet e para gjyqësore mjedisore në gjykatën administrative që u padit për herë të parë nga banorët dhe OJF-të e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në cilësinë e paditësit, Komuniteti në rastin tonë studimor, është përfaqësuar nga 38 banorë nga fshati Kutë, Mallakastër, dy organizatat ndërkombëtare(EuroNatur, River Watch) dhe qendra EcoAlbania depozituan në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Tiranë padinë me objekt ``Pavlefshmërinë absolute të Deklaratës Mjedisore miratuar në Prill të 2015 miratuar nga Ministri i Mjedisit, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ``duke paditur njëkohësisht Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Mjedisit. Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë turke që do të zhvillojë investimin për projektin infrastrukturor hidrik “Kovlu Energji”.

2- Ndërtimi i HEC Poçem në fshatin Pocem., komuna Kutë, Rrethi Mallakastër, Qarku Fier, të tipit digë me rezervuar të madh Fuqia instaluar: 102.2 MW

Në zbatim të kuadrit ligjor të koncesioneve , kompania turke në cilësinë e operatorit ekonomik në dhjetor të 2014 ka paraqitur një propozim të pa kërkuar për zbatimin e një projekti në sektorin e energjisë duke dorëzuar Raportin e fizibilitetit paraprak pranë Ministrisë se Energjisë dhe Industrisë ku do të



ndërtojë projektin e ndërtimit të HEC-i në rrjedhën e poshtme të Lumit Vjosa dhe pa ndikime në pjesën tjetër të lumit. Kompania turke përveç trajtimit të argumentimit ekonomik, në studimin e fizibilitetit duhet të përcaktojë ndikimin mjedisor dhe social të projektit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky studim identifikon efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë por që nuk kufizohen vetëm te: popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht. Ai duhet të tregojë, gjithashtu, edhe masat parandaluese që duhen ndërmarrë për të siguruar përputhjen me standardet e BE-së për mjedisin. Pas identifikimit të projektit të koncesionit për hidrocentrale zhvillohet analiza e rentabilitetit dhe e përshtatshmërisë financiare, për dhënien e koncesionit. Kontrata Konçensionare u nënshkrua për një kohë të shkurtër me kompaninë turke. Pyetja që lind këtu natyrshëm është:

Si zhvillohet procedura nga ana e institucioneve ligjzbatuese mjedisore për impaktin mjedisor të projektit për ndërtimin e HEC Poçem?

Mund të themi që këtu nis përplasja e kuadrit ligjor në mbrojtje të mjedisit e cila shikohet me mospërfillje nga institucionet shtetërore, ku zbatojnë vetëm ligjin e koncesioneve, ligjin e koncesionit për zhvillimin e sektorit të energjisë pa marrë parasysh procedurat dhe zbatimin e ligjeve mjedisore.

Këtu vlen të përmendet dhe nevoja për një VNM serioze dhe profesionale veçanërisht për Poçemin i cili është specifikuar dhe nënvizuar edhe në Rezolutën Parlamentit Europian më 14 Prill 2016 në lidhje me Progres Raportin e vitit 2015 për Shqipërinë (2015/2896(RSP) e cila në piken 23 të saj shprehinë se Parlamenti Evropian`` i bën thirrje qeverisë shqiptare për të kontrolluar zhvillimin e hidrocentraleve në zona të ndjeshme mjedisore të tilla si rreth lumit Vjosa dhe në zonat e mbrojtura dhe për të ruajtur integritetin e parqeve ekzistuese kombëtare, rekomandohet përmirësimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili do të lejojë mbështetjen në standarde të BE-së të përcaktuara me anë të Direktivave për Zogjtë dhe Habitatet dhe

Direktivën e Sistemit të ujërave ; inkurajon qeverinë shqiptare për të rritur transparencën përmes pjesëmarrjes publike dhe konsultimeve për projektet e planifikuara. Siç kemi shpjeguar dhe në kapitullin e mëparshëm mbi të drejtën evropiane mjedisore dhe më saktësisht mbi Direktivat Evropiane Mjedisore sqarojmë se referimi të Parlamentit Evropian nuk ka për qëllim të pretendojë ndonjë shkelje pasi këto nuk kanë fuqi detyruese , por i analizojmë për të përforcuar rëndësinë që i japin edhe strukturat e BE-së heshtjeve mjedisore dhe posaçërisht respektimit të procedurave ligjore në fuqi me vlerësimet mjedisore rreth lumit Vjosa, në një nga lumenjtë e egër të mbetur në Evropë cilësuar nga shkencëtarët.

Kompania turke aplikon më shkurt 2015 pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të zhvilluar konsultimit me publikun lidhur me aktivitetin e ri për ndërtimin e HEC Poçemit e përfaqësuar nga studio mjedisore Shqiptare, ku njoftohen të gjitha palët e interesuara për debatin e hapur për t'u konsultuar me publikun në lidhje me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit që do të kryejë kompania turke. Ky Njoftim sipas afateve të parashikuara në ligj sipas procedurës duhet të qëndrojë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM)për 20 ditë. AKM-ja shqyrton dokumentacionin para se të miratohet Deklarata nga Ministri e cila është dokumenti administrativ që kërkon të pajiset kompania turke për tu futur në prokurimin e koncesionit pranë Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë . AKM-ja, gjatë procedurës së VNM-së së thelluar, zhvillon seancë dëgjimore me publikun dhe OJF-të e interesuara, duke synuar tërheqjen e mendimit të tyre në vendimmarrjen përfundimtare për projektin. Seanca dëgjimore zhvillohet në bashkëpunim edhe me njësinë e qeverisjes vendore dhe me zhvilluesin e projektit.

Nga raportimi de facto i Konsultimit me publikun për hartimin e VNM-se që subjekti, kompania turke ka aplikuar tek QKL bashkë me setin e dokumentacionit në mbështetje të ligjit të VNM-së për miratimin e deklaratës mjedisore.



Realizimi i Dëgjësës Publike në mbështetje të njoftimit të publikuar më shkurt 2015 u zhvillua në qytetin e Fierit, me një pjesëmarrje prej 50 vetash nga sfera të ndryshme të palëve të interesit. Pjesëmarrje kishte nga institucioni i AKM-së dhe nga firma e interesuar për të ndjekur nga afër procesin e konsultimit dhe diskutimit.

- **Konkluzione**

- Procedura për konsultimin e publikut është bërë vetëm formalisht, pasi nuk është zhvilluar së pari në vendndodhjen gjeografike të komunës Kutë në fshatin Poçem ku do të zhvillohet investimi.
- Në listën e konsultimit me publikun zhvilluar në qytetin e Fierit nuk ka asnjë banorë të ftuar nga zona e investimit , pra ata as nuk janë në dijeni për asnjë ndërhyrje që do të bëhet në të ardhmen nga investitori nëpërmjet procedura që zhvillon shteti.
- Konsultimi me Publikun, nuk ka respektuar afatet ligjore mbi njoftimin 20 ditë të publikimit të njoftimit në faqen zyrtare të Web-it të AKM-së, pasi rezulton se konsultimi me publikun është zhvilluar brenda këtij afati jo në mbarim të kohës së njoftimit të caktuar, pra institucionet janë nxituar dhe janë mbledhur para afateve që parashikon ligji
- Kjo çështje gjyqësore mjedisore administrative është çështja e parë gjyqësore ku Komuniteti ka reaguar dhe i është drejtuar gjykatës, duke paditur pikërisht institucionet qendrore ligjzbatuese dhe duke kërkuar të pavlefshme kontratën konçensionare dhe pavlefshmërinë e deklaratës mjedisore. Pas shume seancave gjyqësore komuniteti fitoi kundër të paditurve si Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit, pasi Gjykata administrative i ka dhënë te drejte Komunitetit.
- Kjo situatë prodhon një Deklaratë Mjedisore të parregullt, ku nuk janë respektuar afatet dhe procedurat sipas legjislacioni mjedisor , jo vetëm është shkelur legjislacionin në fuqi në lidhje me vlerësimin

e ndikimit në mjedis ,por ka penguar dhe ushtrimin e të drejtave të publikut të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrje mjedisore, e drejtë kjo e dhënë me anë të dispozitave të ligjit 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit ne mjedis” dhe Vkm-së VKM-së Nr. 247, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e te procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

5.5 Përfundime

Organizimi i trajnimeve për të drejtën mjedisore ishin një hap pozitiv në rritjen e njohurive mjedisore. Gjatë organizimit të 6 trajnimeve rajonale të organizuara përmes platformës online më shumë se 53 pjesëmarrës aktiv nga grupe të ndryshme si organizata mjedisore, aktivistë, gazetarë, specialistë të bashkive dhe agjencive rajonale patën mundësi të njihen me paketën e së drejtës së mjedisit në nivel kombëtare dhe ndërkombëtare.

Rreth 70% e intervistuesve vlerësojnë që paketa e së drejtës së mjedisit është shumë e rëndësishme në aktivitetin e punës së tyre. Gjithashtu pjesëmarrësit shprehnin se trajnime të tilla duhet të vazhdojnë në vazhdimësi për përmirësimin e njohurive.

Në vlerësimet e intervistave 57% e intervistuesve janë shprehur që kuadri ligjorë ekzistues është jo efikas përkundrejt zgjidhjes së konflikteve të burimeve natyrore, duke nënvizuar edhe mungesën e njohurive akademike rreth legjisllacionit mjedisorë.

Kryesisht konfliktet mjedisore ndërmjet palëve trajtohen nëpërmjet akteve dhe dispozitave ligjore, ndërsa shkalla e gjurmës dhe impaktit të shkaktuar në mjedis kryhet nëpërmjet disa parametrave. Në studimin tonë janë përmbledhur në një vlerësim të përgjithshëm duke rezultuar që 45% e pjesëmarrësve kanë njohuri mesatare në parametrat e matjes së cilësisë për ajrin, ujin, Tokën.



Në vlerësimin paraprak rezultoi që rreth 91% e intervistuarve janë shprehur që ekzistojnë konflikte mjedisore në qarkun e tyre dhe sipas shkallës së vlerësimit, konfliktet mbi burimet ujore mbulojnë pjesën më të madhe të konflikteve ndërmjet palëve.

Ndërsa 66% e të intervistuarve shprehen që rastet konfliktuale ndërmjet palëve nuk trajtohen në mënyrë të duhur.

Si çështje mjedisore më shqetësuese rezultoi që 34% e intervistuesve shprehen që menaxhimi i mbetjeve (kryesisht me prejardhje urbane) zënë vendin e parë në dëmtimin e mjedisit. Gjatë trajnimeve pjesëmarrësit shprehen nevojën emergjente për ndërhyrjen në përmirësimin e gjendjes.

Pas përfundimit të trajnimeve 47% e kanë vlerësuar me shkallën maksimale njohuritë e marra mbi kuadrin ligjor të brendshëm për të drejtën e mjedisit në Shqipëri.

Shqiptaria si një vend kandidat është angazhuar në përafrimin e kuadrit ligjorë me atë të BE-së. Ndaj 51 % janë ndier pas trajnimit më të përgatitur në njohjen e legjislacionit të BE-së (direktivat).

Në përfundim të trajnimeve vërejmë se 40% e pjesëmarrësve ishin të bindur se njohuritë e tyre rreth Konventës së Aarhus-it ishin më të thella krahasuar me 12% gjatë vlerësimit të nevojave. 30% të pjesëmarrësve vlerësuar se njohuritë e tyre ishin shumë të mira krahasuar me 22% gjatë fazës së para vlerësimit.

Ndërsa lidhur me Konventën e Espoo-s, 25.4% e pjesëmarrësve vlerësuan se njohuritë e tyre ishin rritur maksimalisht përkundrejt 13% në fazën e para të vlerësimit. 43.6% i vlerësuan njohuritë e tyre me shumë krahasuar me vetëm 9% në fazën paravlerësuese. Vetëm 2% e pjesëmarrësve i vlerësuar njohuritë e marra si të dobëta.

36.3% e pjesëmarrësve vlerësuan se kishin njohuri të avancuara pas trajnimit për Konventën e Helsinkit përkundrejt vetëm 3% në fazën paravlerësuese. 38% e pjesëmarrësve vlerësuar se njohuritë tyre ishin të mira përkundrejt 22%

në fazën e parë. Vetëm 2% vlerësuar se njohuritë e tyre ishin të dobëta dhe pas trajnimit përkundrejt 19% në fazën paravlerësimit duke shënuar një rritje të njohurive me 17%.

23.6% e pjesëmarrësve vlerësuan se njohuritë e tyre në lidhje me parimet dhe instrumentet e Konventës së Bazelit ishin të avancuara përkundrejt 0% në fazën e parë. 40% njohuri të forta përkundrejt 9% në fazën e para vlerësimit. Vetë, 16.3% e pjesëmarrësve vlerësuan se njohuritë e marra ishin të dobëta në krahasim me 44% në fazën e parë

Ndërsa lidhur me Konventën e Bernës, pjesëmarrësit vlerësuar në 38.1% të rasteve se kishin marrë njohuri të avancuara përkundrejt vetëm 12% në fazën paravlerësuese. 5.4% e tyre vlerësuar se njohuritë e tyre ishin të dobëta në krahasim me 22% që ishte në fazën e parë duke shënuar një rritje prej 17% si rezultat i trajnimit.

47.2% e pjesëmarrësve e gjetën prezantimin rreth mekanizmave të zbatimit të konventave shumë të nevojshme dhe e vlerësuar me pikë maksimale. Së bashku me 38.1% të rasteve që e vlerësuar këtë komponent si shumë të mirë, që përbën 85.3% të pjesëmarrësve e kanë vlerësuar pozitivisht njohurinë e marrë për mekanizmat e zbatimit.



5.6 Rekomandime

- Njohja e legjislacionit mjedisor është një fushë më rëndësi të shtuar në politikën ditore në Shqipëri për shumë nga aktorët e shënjestruara në projekt. Në situatën kur legjislacioni mjedisor bëhet gjithmonë e më i avancuar dhe teknik dhe ka një zbatueshmëri të lartë në nivel vendor, është e rëndësishme që programe trajnimi, edukimi, rifreskimi të njohurive të jenë në mënyrë të vazhdueshme për aktorët.
- EcoAlbania e shikon me vlerë zhvillimin e trajnimeve të tilla në të ardhme, për legjislacionin mjedisor në Shqipëri.
- Institucionet kompetente për hartimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor me BE-në duhet të vazhdojnë aktivitetin e tyre duke punuar në përafrimin dhe përshtatjen e dispozitave ligjore në mënyrë që të jenë më praktike për tu shfrytëzuar nga aktorët lokal.

5.7 Referenca

1. <http://www.basel.int/>
2. <https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/12/broken-rivers-AL.pdf>
3. <https://ec.europa.eu/environment/eia/eia-legalcontext.htm>
4. <https://ec.europa.eu/environment/eia/sea-legalcontext.htm>
5. https://ec.europa.eu/environment/nature/legislation/birdsdirective/index_en.htm
6. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32004L0035>
7. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32004L0035>

8. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32008L0099>
9. <https://qbz.gov.al/preview/4f5278ca-6887-4bec-b9a8-178aff6855c4>
10. <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>
11. <https://unece.org/environment-policy/water/about-the-convention/introduction>
12. <https://unece.org/page404/conventions-Aarhus>
13. <https://unece.org/page404/conventions-Espoo>
14. <https://www.bernconvention40years.com/#40-Years-of-the-Bern-Convention>
15. <https://www.coe.int/en/%C3%ABeb/bern-convention/monitoring>
16. The Habitats Directive - Environment - European Commission (europa.eu)







KAPITULLI 6



KAPITULLI VI: SHTOJCAT



6.1 SHTOJCA 1: Formati i pyetësorit 1 për vlerësimin e njohurive, mbi paketën e së drejtës mjedisore.

PYETËSOR

Hyrje

Emri im është <emri i intervistuesit> nga Organizata EcoAlbania e cila po zbaton një nismë të mbështetur nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur. Po iu kontaktojmë për të kërkuar që të merrni pjesë në një studim kërkimor për të drejtën mjedisore. Si i tillë, të gjitha përgjigjet do të mbahen konfidenciale. Intervista do të zgjasë rreth 10 minuta.

SEKSIONI A.

PYETJE TË PËRGJITHSHME

A1. Emri dhe mbiemri

(Opsionale, në rast se doni të merrni përditësime mbi projektin dhe aktivitetet e ardhshme të trajnimit

- Vendbanimi tuaj

- Kontaktin tuaj

A2. Emri i institucionit/
Organizatës

A3. Institucioni që përfaqësoni

a. Institucion i Qeverisjes Qendrore (Ministri, Agjenci Kombëtare etj.)

b. Institucion i Qeverisjes Lokale (Bashki, Agjenci Rajonale etj.)

c. Ekspert i pavarur

d. Gazetarë

e. Bota Akademike/Student

SEKSIONI B.

NJOHURITË RRETH PROBLEMEVE MJEDISORE DHE TË DREJTËS MJEDISORE

B.1 Cili është opinionin tuaj mbi rëndësinë e së drejtës mjedisore në vend;

a. Shumë i rëndësishëm

b. I rëndësishëm

c. Pak i rëndësishëm

d. I parëndësishëm

B.2. Si e shihni gjendjen e mjedisit në rajonin tuaj?

a. Shumë e mirë

b. E mirë

c. Jo e mirë

d. E rrezikuar.

e. E degraduar

B.3. A mendoni se Shqipëria ka një legjislacion efikas në të drejtën mjedisore?

a. Po

b. Jo

a. Shumë efikas.

Nëse, është përgjigjja juaj , Po? Sa efikase është e drejta e mjedisit në Shqipëri?

b. Efikas

c. Jo i plotë.

d. I dobët

B4. Në përgjithësi, sa mendoni se dini për çështjet dhe problemet mjedisore?

(Shënoni nga 1 deri në 5, ku 1, asgjë dhe 5 njohuri të avancuara).

1) Ndotjen e ujit	1	2	3	4	5
2) Ndotjen e ajrit	1	2	3	4	5
3) Biodiversitetin	1	2	3	4	5
4) Burimet ujore dhe konfliktet për to	1	2	3	4	5
5) Ndotja e tokës nga aktivitetet njerëzore industriale	1	2	3	4	5
6) Problemet me mbetjet e rrezikshme dhe kimikatet	1	2	3	4	5
7) Problemet e shpyllëzimeve	1	2	3	4	5
8) Zonat e mbrojtura	1	2	3	4	5
9) Aktiviteti i industrive nxjerrëse	1	2	3	4	5
10) Aktiviteti i hidroenergjisë	1	2	3	4	5

SEKSIONI C.

E DREJTA MJEDISORE

Të drejtat tuaja mjedisore përcaktohen nga kushtetuta, ligjet mjedisore, vendimet e gjykatës, si dhe të drejtat e njeriut dhe traktatet e ratifikuara mjedisore nga Parlamenti. Në këtë seksion do t'ju bëhen disa pyetje në lidhje me ligjet dhe rregulloret mjedisore.

(Shënoni nga 1 deri në 5, ku 1, asgjë dhe 5 njohuri të avancuara).

C1. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë përcaktohet se “Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”. Sa mendoni që njihet ky parim nga qytetarët e rajonit ku ju jetoni?

1 2 3 4 5

C2. A i njihni mekanizmat e traktateve ndërkombëtare për mjedisin

a. Po

b. Jo

C3. Nëse, përgjigjja juaj ishte ‘Po’ vazhdoni më poshtë, në të kundërt kaloni në pyetjen



C4. Sa njohuri keni ju për Konventat më poshtë?

1) Konventën e Bazelit për mbetjet e rrezikshme	1	2	3	4	5
2) Konventën e Bazelit për mbetjet e rrezikshme	1	2	3	4	5
3) Konventën e Demokracisë Mjedisore të Aarhusit	1	2	3	4	5
4) Konventën e Espoos "Për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitarë"	1	2	3	4	5
5) Konventa e Bernës për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitaveve	1	2	3	4	5
6) Konventën e Helsinkit "Për mbrojtjen dhe përdorimin ujrave ndërkufitare"	1	2	3	4	5

- a. Njohuri të avancuara
b. Një sasi e madhe
c. Pak
d. Praktikisht asgjë

C4. Sa dijeni keni për Kapitullin 27 'Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike', si një nga kushtet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit?

C5. Specifikishtë, sa mendoni se dini për direktivat mjedisore të BE-së?

1) Direktiva për VNM dhe Direktiva e VSM	1	2	3	4	5
2) Direktivën Kuadër e Ujit	1	2	3	4	5
3) Direktiva e shpendëve dhe habitateve	1	2	3	4	5
4) Direktiva për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes	1	2	3	4	5
5) Direktivën e BE "Mbi përgjegjësinë mjedisore"	1	2	3	4	5
6) Direktiva e kimit mjedisor	1	2	3	4	5

C6. Sa njohuri keni për legjislacionin vendas sipas ligjeve të renditura më poshtë?

- Ligji "Për mbrojtjen e mjedisit"	1	2	3	4	5
- Ligji "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"	1	2	3	4	5
- Ligji "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	1	2	3	4	5
- Ligji "Për lejet e mjedisit"	1	2	3	4	5
- Ligji "Për mbrojtjen e Ajrit Urban"	1	2	3	4	5
- Ligji "Për Zonat e mbrojtura"	1	2	3	4	5
- Ligji "Për të drejtën e informimit"	1	2	3	4	5

C7. Sa njohuri keni mbi parametrat e matjes së cilësisë për ujin, ajrin dhe tokën?

C8. Sa herë ju ka ndodhur të konsultoheni me raportin e gjendjes së mjedisit?	1	2	3	4	5
---	---	---	---	---	---

SEKSIONI D. KONFLIKTET MJEDISORE

Pyetjet në vijim kanë të bëjnë me konfliktet mjedisore në zonën tuaj. Sipas opinionit tuaj, sa serioze janë këto konflikte dhe nëse paraqesin një kërcënim për zonën ku jetoni. Për secilin, ju lutem të vlerësoni nga 1 në 5 nivelin e kërcënimit ku me 1 nuk është një kërcënim dhe me 5 është një kërcënim shumë serioz, për cilësinë e mjedisit në zonën tuaj.

D.1 A ekzistojnë konflikte mjedisore në zonën tuaj? Ju lutem përshkruani me fjalë shkurtimisht konfliktin dhe mendimin tuaj?

D.2. Sipas gjykimit tuaj, sa serioze janë këto kërcënime?

(Për secilin, ju lutem të vlerësoni nga 1 në 5 nivelin e kërcënimit ku me 1 nuk është një kërcënim dhe me 5 është një kërcënim shumë serioz.)

- Humbja e ligatinave	1	2	3	4	5
- Ndotja e ujërave dhe tokave nga derdhja e naftës	1	2	3	4	5
- Shpyllëzimet e ndryshme	1	2	3	4	5
- Konfliktet e burimeve ujore	1	2	3	4	5
- Konfliktet për zaptimin e zonave të mbrojtura	1	2	3	4	5
- Ndotja e ujit, ajrit, tokës					
- Ndotja nga minierat	1	2	3	4	5
- Konfliktet për ndryshimet klimatike	1	2	3	4	5
- (Kaq) menaxhimi i mbetjeve	1	2	3	4	5
- Tjetër	1	2	3	4	5

- a) Gjithmonë
b) Shumicën e kohës
c) Nganjëherë
d) Asnjëherë

D.3. Kur njerëzit përfshihen për të zgjidhur probleme/konflikte mjedisore, sa mendoni se i bëjnë gjërat më mirë?

SEKSIONI E. NEVOJAT PËR TRAJNIM

Pyetjet në vijim kanë të bëjnë me njohuri mbi pjesëmarrjen tuaj në trajnime. Sipas opinionit tuaj, jepni kontributin tuaj nëpërmjet vlerësimit.

E1. Cili është niveli juaj i njohurive dhe përvojave në lidhje me të drejtën mjedisore?

Shënoni vetëm një prej alternativave.

Njohuritë:

Përvoja:

- Pa njohuri themelore
- Njohuri themelore
- Njohuri të hollësishme
- Pa përvojë
- Përvojë themelore
- Përvojë të gjerë

**E2. A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim mbi çështjet e mëposhtme?**

<i>Trajnim mbi njohuritë bazike</i>	<i>Trajnim në nivelin mesatar të njohurive</i>	<i>Trajnim në nivelin e avancuar njohurive</i>
---	--	--

Legjislacioni mjedisor i BE-së

Konventat ndërkombëtare mjedisore

E drejta mjedisore në Shqipëri

Tjetër (listo) _____

E3. Çfarë lloji të mësimi informal ju duket më i dobishëm?

Ju lutemi vlerësoni në një shkallë 1-5 (1 = më e larta, 5 = më e ulta)

<i>Të mësuarit gjatë punës</i>	1	2	3	4	5
<i>Duke punuar përkrah kolegëve me përvojë</i>	1	2	3	4	5
<i>Duke punuar si pjesë e një ekipi</i>	1	2	3	4	5
<i>Vetëanalizimi ose reflektimi</i>	1	2	3	4	5
<i>Rrjeti me të tjerët</i>	1	2	3	4	5
<i>Të ngjashme</i>	1	2	3	4	5

a) Trajnim në sallë

b) Trajnim të stilit të seminarit

c) Prezantime në Webinar

d) Trajnim në distancë që mund të përfundojë me ritmin tuaj (p.sh., kurse online ose të bazuara në internet)

e) Një kombinim i udhëzimeve në klasë dhe në distancë

f) Të tjera: _____

a) Leksion

b) Diskutim në grup

c) Studime rasti

d) Prezantim video

e) Simulimet e roleve

f) Manuale praktikë

g) Trajnim gjatë punës

h) Përdorimi i grupeve praktike të mjeteve

i) Tjetër

E4. Në cilin nga formatet e mëposhtme të trajnimit do të donit të merrni pjesë?**E5. Çfarë lloji të metodave (fillestare dhe të vazhdueshme) të trajnimit mendoni se përfitojnë më shumë praktikuesit?****E6. Dëshironi të shtoni diçka tjetër që nuk është përmendur më sipër.**

JU FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

6.2 SHTOJCA 2: Formati i pyetësorit II për vlerësimin e njohurive, të pjesëmarrjeve në trajnimet mbi rreth paketës së të drejtës mjedisore.

PYETËSOR

Hyrje

Emri im është <emri i intervistuesit> nga Organizata EcoAlbania e cila po zbaton një nismë të mbështetur nga Fonadacioni për Shogërinë e Hapur. Po iu kontaktojmë për të kërkuar që të merrni pjesë në një studim kërkimor për të drejtën mjedisore. Si i tillë, të gjitha përgjigjet do të mbahen konfidenciale.

Seksioni A. Pyetje të përgjithshme

- **Emri dhe mbiemri**

(Opsionale, në rast se doni të merrni përditësime mbi projektin dhe aktivitetet e ardhshme të trajnimit

- **Vendodhja Juaj:** _____

- **Sa e rëndësishme është përmbajtja e trajnimit për funksionin tuaj brenda organizatës/institucionit/punës tuaj?**

- a. I varfër
- a. Mjaftueshëm
- b. Ekspert i pavarur
- c. Mesatar
- d. I mirë
- e. Shumë i mirë

- **Si ishte balanca mes prezantimit të webinar, diskutimeve dhe rasteve studimore?**

- a) I varfër
- b) Mjaftueshëm
- c) Ekspert i pavarur
- d) Mesatar
- e) I mirë
- f) Shumë i mirë

- **Sa kompetent ishin trajnerët në tematikën përkatëse dhe si e prezantuan/lehtësuan diskutimin me pjesëmarrësit?**

- g) I varfër
- h) Mjaftueshëm
- i) Ekspert i pavarur
- j) Mesatar
- k) I mirë
- l) Shumë i mirë

- **Komente Shtese:** -----



**SEKSIONI 1.****E DREJTA MJEDISORE DHE AJO KUSHTETUESE**

(Ju lutem plotësoni çdo pyetje të kësaj forme duke përdorur shkallën nga 1 në 5
(1= minimumi; 5 = maksimumi)

• Si i vlerësoni njohuritë e marra në të drejtën mjedisore dhe kushtetuese në Shqipëri?	1	2	3	4	5
• Si e vlerësoni legjislacionin kombëtar në të drejtën mjedisore në Shqipëri?	1	2	3	4	5
• Sa efikase e vlerësoni përmbledhjen e legjislacionit vendas në këtë sesion trajnimi?	1	2	3	4	5
• Sa i qartë është legjislacioni i prezantuar në zbatimin e tij në praktikë ?	1	2	3	4	5
• Sa të dobishme e gjetët prezantimin për mekanizmat e zbatueshme risë së legjislacionit në Shqipëri?	1	2	3	4	5
• Si e vlerësoni garancinë kushtetuese për një mjedis të shëndetshëm në Shqipëri?	1	2	3	4	5

SESIONI 2.**DIREKTIVAT E BE-SË DHE E DREJTA EUROPIANE**

(Ju lutem plotësoni çdo pyetje të kësaj forme duke përdorur shkallën nga 1 në 5
(1= minimumi; 5 = maksimumi)

• A fituat njohuri të mjaftueshme gjatë prezantimit mbi Direktivat Mjedisore të BE-së ?	1	2	3	4	5
• Sa njohuri morët mbi Direktivën Kuadër të Ujit të BE-së ?	1	2	3	4	5
• A ndiheni më të përgatitur me njohuritë e marra mbi Direktivën e VSM_së dhe VNM_së ?	1	2	3	4	5
• Sa të dobishme ju dukën Direktiva e Shpendëve dhe Habitave për mbrojtjen e Natyrës?	1	2	3	4	5
• A ndiheni më të përgatitur mbi Direktivën e Parandalimit dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (IPCC) ?	1	2	3	4	5
• Sa njohuri keni për Direktivën e Përgjegjësisë Mjedisore bazuar në parimin "ndotësi pagan" ?	1	2	3	4	5
• Sa e dobishme ju duket Direktiva e Krimit Mjedisor ?	1	2	3	4	5
• A ndiheni më të përgatitur mbi rëndësinë e përafrimit të Direktivave të BE për Shqipërinë?	1	2	3	4	5

SESIONI 3.

KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MJEDISORE

(Ju lutem plotësoni çdo pyetje të kësaj forme duke përdorur shkallën nga 1 në 5
(1= minimumi; 5 = maksimumi)

- | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| • A ndiheni më të përgatitur për Konventën e Aarhus-it ? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| • A ndiheni më të përgatitur për Konventën e Espoo-s ? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| • Sa e dobishme ju duket Konventa e Helsinkit për ujrat ndërkufitare? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| • Sa njohuri keni për Konventën e Bazelit për mbetjet e rrezikshme ? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| • Sa u njohët me Konventën e Bernës për biodiversitetin dhe faunën ? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| • Sa të dobishme e gjetët prezantimin për mekanizmat e zbatueshmërisë së konventave në Shqipëri ? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

- **Si do ti përdorni njohuritë e marra në jetën tuaj profesionale?**

- **Do ja këshillonit këtë trajnim të njohurve dhe kolegëve ?**

A) PO
B) JO

- **A dëshironi të shtoni diçka tjetër?**

JU FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!





**Njohja dhe përdorimi
i së drejtës Mjedisore
nga aktorët lokal
në Shqipëri**

RAPORT VLERËSUES